



BEDER JOURNAL OF HUMANITIES

ISSUE:21

FALL 2024



About the Journal

Beder Journal of Humanities (BJH) is a peer-reviewed journal published by University College "Bedër" High Education Institution (HEI), Faculty of Humanities and Law. The main objective of BJH is provide international scholars an intellectual platform for the exchange of contemporary research

The journal publishes research papers in the fields of Humanities such as Law, Theology, Communications, Spirituality, Economy and Religion, Morality, History, International Relations, Political Science, Public Relation, Marketing, Human Rights and Sociology, Education and Literature.

From 2013, Beder Journal of Humanities (BJH) became a scholarly blind peer-reviewed publication, with an Editorial Board and International Advisory Board comprised of eminent scholars in Balkan, Europe and beyond.

EDITOR-IN-CHIEF

Assoc. Prof. Dr. Rahim Ombashi,
University College Bedër, Albania.

ASSOCIATE EDITORS

Assoc. Prof. Dr. Isa Erbaş, University College
Bedër, Albania

Assoc. Prof. Dr. Enriketa SOGUTLU, Tirana
University, Albania

Assoc. Prof. Dr. Erlis Çela, University College
Bedër Albania

Assoc. Prof. Dr. Genti KRUJA, University College
Bedër, Albania

DEPUTY EDITORS

Assoc. Prof. Dr. Ilirjana Kaceli, University
College Beder, Albania

Dr. Ada Güven, Epoka University, Albania

Dr. Ali Zaimi, University College Bedër, Albania

Dr. Edona Llučkaçaj, University College Bedër,
Albania

ASSISTANT EDITORS

Alban TUFJA

Email: altufa@beder.edu.al

EDITORIAL BOARD

Prof. Dr. Altin Shegani, Tirana University, Albania

Prof. Dr. Ferdinand Gjajana, Western Balkans
University, Albania

Prof. Dr. Gjergji Pendavinji, "Fan Noli" University,
Albania

Prof. Dr. Gjergj Sinani, University College Bedër,
Albania

Prof. Dr. Mark Marku, Tirana University, Albania

Prof. Dr. Nihada Delibegović Džanić, University of
Tuzla, Bosnia and Herzegovina

Assoc. Prof. Dr. Denard Veshi, University College
Bedër, Albania

Assoc. Prof. Dr. Enkelejda Koka, University
College Bedër, Albania

Assoc. Prof. Dr. Hasan Bello, Albanian Institute of
History, Tirana, Albania

Assoc. Prof. Dr. Irvin Faniko, The Security
Academy, Tirana, Albania

Assoc. Prof. Dr. Ramadan Cipuri, Tirana
University, Albania

Assoc. Prof. Dr. Vilhelmina Vaičiūnienė, Institute
of Humanities, Faculty of Human and Social Studies,
Mykolas Romeris University, Lithuania

PhD. Rukia Bakari, Head of Research, Goree
Institute, Center for Democracy, Development &
Culture in Africa, Senegal

Dr. Besa Ombashi, University College Bedër,
Albania

Dr. Bojana Hajdini, University College Bedër,
Albania

Dr. Brikena Smajli, University College Bedër,
Albania

Assoc. Prof. Dr. Erlis Çela, University College
Bedër, Albania

Dr. Ferdinand Xhaferraj, University College Bedër,
Albania

Dr. Gentjan Skara, Epoka University, Albania

Assoc. Prof. Dr. Ilirjana Kaceli, University College
Beder, Albania

Dr. Irena Shehu, Tirana University, Albania

Dr. Ndrriçim Ciroka, Western Balkans University,
Albania

Dr. Skender Bruçaj, University College Bedër,
Albania

Dr. Suela Musta, University College Bedër, Albania

Dr. Valmora Gogo, University College Bedër,
Albania

Dr. William Karl Martin, University College Bedër,
Albania, USA



BEDER JOURNAL OF HUMANITIES

ISSUE:21
Fall 2024

Publication Frequency: Biannual

ISSN: 2306-6083

ISSN Online: 2707-3041

Tirana, Albania

www.bjh.beder.edu.al

TABLE OF CONTENTS

Alban TUFA, Erlis CELA

Botëkuptimet Filozofike Në Kërkimin Shkencor Rreth Medias Dhe Komunikimit1

Evelina XHERIMEJA, Isa ERBAS

Technology and Education Policy: The Role of Digital Tools in English Language Acquisition in High Schools19

Gjergji PENDAVINJI

Filozofia Sokratike E Shekullit V (P.E.S.) – Kthesë Historike Në Filozofinë E Vlerave Njerëzore31

Gjergj SINANI

Parësia E Të Drejtës – Një Dëshirë E Hershme E Njerëzimit..... 40

Ilirjana KACELI, Sajmir BATA

The Right, Justice, And Freedom in The Legal -Philosophical Perspective and Interconnection..... 61

Irena SHEHU, Andeta AXHAMI

The Role of the Teacher in Shaping Students' Attitudes in The Language Learning Process: A Critical Analysis69

Kristaq BALLI

Sotir Peci – Patrioti E Publicisti Veteran, Arsimtari E Gjuhëtari, Politikani E Ministri Vizionar 86

Lirie KURTISHAJ-ADEMI

Viktimat E Dhunës Seksuale Si Strategji Sociale Dhe Politike Gjatë Luftës Në Kosovë (1998-1999)97

Rahim OMBASHI

Gjuha Shqipe Është Një E Mirë Kombëtare.....106

William K. MARTIN

Plato, Aristotle and The Arts 118

Alban TUFA¹
Erlis CELA²

Botëkuptimet Filozofike Në Kërkimin Shkencor Rreth Medias Dhe Komunikimit

Abstract

Philosophy and communication as two different fields in the humanities have their source, in most cases, in the same authors. Without claiming that communication scientists have been philosophers at the same time and vice versa, the place where these two fields clearly come together is the methods of scientific research in media and communication. Usually, before a scientific paper or article is published, regardless of the discipline or topic, it encounters several philosophical phases from the very beginning of its conception. In addition, when researchers conceive of conducting a study and then all the phases that follow until publication, they bring their philosophical worldviews to it. The greatest level of manifestation of these worldviews is what researchers have called research paradigms, or approaches to research. These worldviews during the work appear both in the form of prior knowledge and in the form of beliefs that researchers carry. This knowledge, values, and beliefs in many cases determine the way data is collected, analyzed, and published. Thus, this paper deals with the integration of philosophy with scientific research in the field of media and communication, with a main focus on philosophical worldviews and the role they play in the development of research from the first stages to the final publication. The paper also addresses how philosophical worldviews determine the selection of approaches to topics and how the papers will connect to the larger literary scene. Thus, by reviewing the existing literature on philosophical views and research methods in media and communication, it is concluded that philosophical views, knowledge, beliefs and values are determinants of how a paper will be developed, thus influencing the results of that paper.

Keywords: *philosophical worldview, belief, values, knowledge, research methods, media and communication*

1. Hyrje

¹ MSc. Alban TUFA Kolegji Universitar Bedër,
altufa@beder.edu.al

² Prof. Asoc. Dr. Erlis CELA Kolegji Universitar Bedër,
ecela@beder.edu.al

Ata që duan të zbulojnë sesi funksionojnë gjërat dhe pse funksionojnë pikërisht në atë formë, e bëjnë këtë për dy arsye kryesore: (a) për të mësuar për hir të dijes, (b) për të kuptuar sesi një problem ose çështje mund të trajtohet më mirë (CHIBUCOS & WEIS, 2005: 1-10) Arsyeja e parë lidhet me atë që quhet kuriozitet intelektual, ndërsa e dyta konsiderohet si nevojë praktike. Për ta arritur këtë, studiuesit (dhe, në të vërtetë, e gjithë ndërmarrja kërkimore) veprojnë në dy botë të dallueshme, por shumë të lidhura: *abstrakte* (bota e koncepteve/ideve) dhe *konkrete* (empirike/bota e vëzhgueshme). Studiuesit janë të idesë që këto dy botë lidhen nga teoritë dhe ofrojnë përshkrime, përmbledhje, integritime dhe shpjegime rreth asaj që dihet nga kërkimi, si dhe udhëzime për kërkime dhe praktikë shtesë, që do të rrisin kuptimin e mëtejshëm karshi një problematike apo fenomeni (CHIBUCOS & WEIS, 2005: 1-10). Ne i gjejmë teoritë në çdo pjesë të studimeve të komunikimit (ANDERSEN, 2009: 41-48). Në fakt, teoritë na paraqiten si bartëse të njohurive, ne i kuptojmë gjërat në mënyrë më të sintetizuar, kur ato teorizohen. Platoni sugjeron tre bartës të mundshëm të njohurive ose pretendimeve mbi dijen: (1) besimet si gjendje mendore, (2) fjalitë e gjuhëve të interpretuara dhe (3) propozimet e shprehura nga fjali të tilla. Ndërsa shkencë përpiqet për njohuri publike, filozofët e paraqesin teorinë në vetvete si *gjuhë*. Kjo ndodh për shkak se pretendimet e njohurive në shkencë shprehen me pohime pak a shumë hipotetike. Këto pohime hipotetike mund të formulohen me fjali të interpretuara në një gjuhë shkencore. Të gjitha dëshmitë që shpresohet të justifikojnë deklarata të tilla, dhe njohuritë përkatëse rreth këtyre dëshmimeve, supozohen të jenë të shprehura me fjali (Niiniluoto, 2007). Kësisoj, ajo çka duhet patur parasysh, është fakti se teoritë janë gjuhë, dhe gjuha është përfaqësim i ideve, të cilat kur janë komplekse shprehen nëpërmjet koncepteve. Përpjekja për të krijuar koncepte të reja, për të zbuluar lidhjet mes koncepteve dhe për të krijuar njohuri të reja, është në thelb proces kërkimor. Para se të vazhdojmë më tej, lë të shohim format kryesore të kryerjes së kërkimit.

Ekzistojnë tre forma kërkimi: *kërkim i shkencor*, *kërkimi pronësor* dhe *kërkimi personal* (Anderson, 2012). Se çfarë është kërkimi shkencor ne tashmë e dimë e prej kohësh. Kjo formë e kërkimit ndodh kryesisht në universitete dhe qendra kërkimore, për të cilat jepen bursa dhe fonde të shumta me qëllim, prodhimin e atyre që quhen *njohuri publike*. Këto kërkime konsiderohen si më të besueshmet dhe gëzojnë nivel të lartë pranimit në shoqëri. Mënyra e dytë e kërkimit është kërkimi që ndodh në treg (Anderson, 2012). Një kompani për shembull dëshiron të masë efektivitetin e një fushate reklamimi, ose të masë sasinë e përdorimit të internetit nga një target-grup i caktuar me qëllim shitjen e një produkti apo shërbimi. Ky kërkim është zakonisht *pronësor*,

që do të thotë se duhet të përdoret nga ata që e kryejnë (ose e paguajnë) dhe askush tjetër (Anderson, 2012; Adams, Khan, & Raeside, 2014). Ndërsa mënyra e tretë, është kërkimi personal. Kjo është një mënyrë kërkimi e cila iniciohet shpesh në *mënyrë individuale*, ngaqë njerëzit duan të zbulojnë gjëra të reja rreth fenomeneve. Jeta jonë individuale mund të ndikohet gjithashtu nga kërkimi. Karakteristikat që realizojnë kërkime të mira, të tilla si: *kurioziteti, skepticizmi, hetimi sistematik, ose njohja e mundësisë së gabimit*, mund t'i shërbejnë secilit prej nesh në përballimin e sfidave të jetës së përditshme (Anderson, 2012). Që të tri këto forma aplikohen në mënyrë e empirike. Qasja empirike ndaj dijes do të thotë se ajo bazohet në vëzhgim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ose me fjalë të tjera, në përvojë. Në njëfarë kuptimi, çdokush përdor qasje empirike në jetën e tij të përditshme (Creswell & Creswell, 2018); jeta jonë ndërtohet më së shumti bazuar në vëzhgime empirike. Studiuesit e përdorin qasjen empirike si një mënyrë për të shmangur rezultatet e gabuara dhe interpretimet e dobëta. Gjëja kryesore që bëjnë është planifikimi me kujdes i motiveve që i nxisin ata të bëjnë vëzhgime: si të vëzhgojnë, kur të vëzhgojnë dhe kë duan të vëzhgojnë specifikisht (Newhart & Patten, 2023). Të gjitha aplikohen në fushën e medias dhe komunikimit dhe janë të lidhura ngushtë me mënyra sesi besojmë dhe e shohim botën. Megjithatë, lidhur me njohjen e botës dhe mënyrave se si ajo funksionin, ne kemi tashmë përvojat tona të veçanta. Të gjitha këto përvoja e bëjnë procesin e kërkimit herë më të thjeshtë e herë tjera shumë më kompleks: duke nisur që nga idetë për kërkim dhe duke përfunduar te paradigmat dhe shkollat e kërkimit.

Në punim do të trajtohen qasjet e mëdha ndaj kërkimit, sasiore, cilësore dhe të përziera. Trajtimi i tyre do të bëhet duke i analizuar elementet e tyre përbërës njëri pas tjetrit. Punimi do të shohë sesi ndikojnë pikëpamjet filozofike në paradigmat e kërkimit, në qasjet e mëdha kërkimore, në modelet e kërkimit si dhe në përzgjedhjen e temës apo edhe të metodologjive të kërkimit. Në fokus të këtij punimi janë botëkuptimet filozofike dhe zhvillimi i punës kërkimore vetëm në fushën e medias dhe të komunikimit. Do të trajtohet se çfarë janë paradigmat e kërkimit, si ndërtohen ato dhe çfarë roli luajnë në procesin e një pune kërkimore.

2. Hapat nëpër të cilat kalon një ide kërkimore

Pavarësisht metodave apo procedurave që zgjedhim qoftë me vetëdije ose jo, pavarësisht llojit apo temës, ajo çka mbetet e njëjtë janë fazat nëpër të cilat kalon një ide kërkimore. Kur bëhet fjalë për fazat, nuk iu referohemi në mënyrë të drejtpërdrejtë etapave konkrete deri në përfundimin e

punimit, por fazave filozofike dhe konceptuale nëpër të cilat një punim do të kalojë. Në librin “The Illustrated Guide to the Mass Communication Research Project”, Patricia Swann, zhvillon një model të domosdoshëm për fazat mbi të cilat një kërkim shkencor duhet të kalojë. Ky model i paraqet fazat e kërimit:

- a) *Faza Ontologjike.* Ontologjia është një degë e filozofisë që merret me natyrën e realitetit - atë që realisht ekziston. Ontologjia pyet se çfarë është reale dhe e ditur në botën fizike dhe sociale (Swann, 2023). Kjo është faza e parë nëpër të cilën kalon një temë kërkimore. Në këtë fazë studiuesi njihet me fenomenet dhe problematikat e prekshme, me ato që duken qartë. Pra, me ato çka ai sheh, ndjen, prek, etj., në përditshmërinë e tij. Këto problematika ose fenomene, në rrafshin më të ulët, mundet se paku, të tërheqin vëmendjen e studiuesit për t’u bërë mandej tema studimi.
- b) *Faza epistemologjike.* Epistemologjia, një degë tjetër e filozofisë, që merret me studimin e njohurive. Mënyra se si ne bëjmë kërkime varet shumë nga mënyra se si prodhohet njohuria dhe çfarë përbën njohuri të besueshme. Njohuria përfshin nocionin e së vërtetës dhe mbështetjet në besimet tona rreth dijes (Si e dimë atë që dimë?). Kërkimi duhet të prodhojë njohuri të besueshme të bazuara në arsytim, prova dhe fakte të cilat mblidhen përmes vëzhgimit dhe eksperimentit (Swann, 2023). Kjo është faza e dytë nëpër të cilën kalon një kërkim shkencor. Kjo fazë, duket sikur vë në dyshim fazën e parë. Pra, ato ajo çka ne dimë rreth një fenomeni apo një problematike, mund të mos jetë realisht ashtu. Mundet, që nga një shkak apo një tjetër ne të jemi keq informuar, të kemi keqinterpretuar shenjat e marra nga vëzhgimet tona ontologjike. Faza epistemologjike, i vë në një peshore kritike ato çka ne dimë nga ontologjia.
- c) *Faza aksiologjike.* Në kërkime, aksiologjia, një degë tjetër e filozofisë, ka të bëjë me vlerat dhe etikën e studiuesit kur merret me pjesëmarrësit në kërkim. Dinamikat e pushtetit ndërmjet një studiuesi dhe subjekteve kërkimore, varion nga objektive dhe të largëta, deri te subjektive, të angazhuara. Cilado qoftë qasja, përdorimi i njerëzve në kërkim imponon konsiderata etike si respekti për pjesëmarrësit, pëlqimi i informuar, minimizimi i rreziqeve, dhe sjellja e duhur e studiuesit (Swann, 2023). Në këtë fazë të studimit, studiuesi përcakton pozitën e tij karshi temës dhe subjekteve të marra në konsideratë për t’u vëzhguar apo eksperimentuar.

d) *Faza metodologjike*. Metodologjia është një kornizë, që përmban besime, vlera, procese apo procedura, dhe që drejton strategjinë e kërkimit. Studiuesit e rinj shpesh mendojnë se “metodologjia” nënkupton metodën e mbledhjes së të dhënave. Të dyja janë të lidhura, por dukshëm të ndryshme. Metodologjia është një arsyetim (një grup arsyesh) për vendimet e kërkimit, duke përfshirë justifikimin për metodën e kërkimit (eksperiment, fokus grup, sondazh, etj.) që studiuesi zgjedh (Swann, 2023). Kjo është faza e fundit para se kërkimi të nisë realisht. Në këtë fazë studiuesi përcakton dhe justifikon mënyrën/at se si do t'i mbledhë dhe do t'i analizojë të dhënat në punën e tij kërkimore.

3. Tri qasje e mëdha ndaj kërkimit

Kërkimet ndahen kryesisht në dy llojesh: kërkime cilësore dhe kërkime sasiore. Jo rrallë herë dallimi midis kërkimit cilësor dhe kërkimit sasior është reduktuar në përdorimin e fjalëve (cilësore) dhe numrave (sasior), ose më mirë akoma, duke përdorur pyetje dhe përgjigje të mbyllura ose pyetje dhe përgjigje të hapura (Creswell & Creswell, 2018). Për të nxjerrë në pah dallimet kryesore të tyre, duhet të kuptojmë botëkuptimet filozofike që studiuesit sjellin në punim, llojet e strategjive kërkimore (metodologjitë) të përdorura në kërkim dhe metodat specifike të përdorura. Këto qasje kërkimore janë zhvilluar dhe ndryshuar me kalimin e viteve. Kërkimet sasiore dominuan format e kërkimit në shkencat sociale nga fundi i shekullit të 19-të deri në mesin e shekullit të 20-të. Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 20-të, interesi për kërkimin cilësor u rrit dhe së bashku me të u rrit edhe zhvillimi i kërkimit me metoda të përziera (Creswell & Creswell, 2018).

3.1. Qasja sasiore

Qasja sasiore ose kërkimi sasior na bën me dije se studiuesi është i prirur që të përdorë numra gjatë kërkimit. Kjo qasje i referohet llojit të kërkimit që bazohet në parimet metodologjike të pozitivizmit dhe post-pozitivizmit, dhe i përmbahet standardeve të një metodologjie të rreptë kërkimore. Kërkimi sasior fokusohet te sasia dhe për këtë arsye përdoret analiza statistikore (Adams, Khan, & Raeside, 2014). Qasja sasiore në kërkim kufizon ndikimin e studiuesit në mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Pra, studiuesi është objektiv dhe i distancuar nga të dhënat. Nuk përfshihet emocionalisht me to apo me pjesëmarrësit. Protokollet e kërkimit vendosen përpara se të mbledhen të dhënat. Pavarësisht se kush dhe sa do të jenë pjesëmarrësit në kërkim, studiuesi i ka dakordësuar më përpara instrumentet (anketë, eksperiment, apo sondazh), më të cilat do të

kryejë studimin. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente janë vetë matja e fenomenit apo e problematikës. Analiza e të dhënave mbështetet në masat numerike dhe statistikore dhe kjo bëhet duke u dhënë përgjigje pyetjeve që fillojnë me “Sa?”. Disa pyetje kërkimore në thelb i shërbejnë më shumë një qasje sasiore (Newhart & Patten, 2023) Për shembull: “Sa të informuar janë studentët shqiptarë lidhur me median dhe informacionin?”, që kërkon një qasje sasiore, sepse variablat e nivelit të formimit janë përgjithësisht numerike dhe pyetja përgjithësohet në një grup të madh studentësh. Të dhënat raportohen edhe në formë numerike (Swann, 2023). Qasja sasiore përdoret pothuajse në çdo sferë të jetës, si në kërkimet klinike, biologjike, epidemiologjike, sociologjike dhe në biznes (Adams, Khan, & Raeside, 2014). Studiuesit që angazhohen në këtë formë kërkimi duan të testojnë teoritë në mënyrë deduktive, prirjen të dalin kundër paragjytimeve, dhe kanë aftësinë për të përgjithësuar dhe përsëritur gjetjet (Creswell & Creswell, 2018). Megjithatë, kërkimet sasiore sugjerohen edhe kur pjesëmarrësit e mundshëm nuk janë të disponueshëm për ndërveprime ose vëzhgime në ambientet e tyre private. Për shembull, mund të jetë e vështirë të planifikohen intervista të thelluara me drejtuesit ekzekutivë të korporatave të mëdha. Megjithatë, ata mund të jenë të gatshëm t’i përgjigjen një pyetësi të shkurtër, i cili do të sigurojë të dhëna statistikore (Newhart & Patten, 2023). Në këto situata sugjerohet të zgjidhet një qasje sasiore. Në rastet kur koha dhe fondet janë shumë të kufizuara, mund t’i qasemi kërkimit sasior. Megjithëse kufizime të tilla janë kritere të diskutueshme për zgjedhjen midis qasjeve kërkimore, sugjerohet kërkimi sasior sepse mund të përdoret për të siguruar të dhëna të shpejta dhe pa kosto të mëdha. (Newhart & Patten, 2023)..

3.2. Qasja cilësore

Një qasje cilësore mbi kërkimin do të thotë që studiuesi nuk përdor numra dhe sasi për të mbledhur të dhëna, por fjalët dhe idetë e atyre që marrin pjesë në studim (Arnett, 2016). Kjo qasje kërkimore përdor një sërë strategjish metodologjike të bazuara në parime të ndryshme teorike, si: fenomenologjia, hermeneutika, ndërveprimi social, etj. (Stewart, 2009). Kjo qasje kërkimi, synon eksplorimin e marrëdhënieve shoqërore dhe përshkruan realitetin e përjetuar nga të intervistuarit (Mancino & Kearney, 2023). Qasja cilësore është përdorur prej kohësh në fushën e shkencave të komunikimit. Për shembull, qasja kryesore e përdorur nga antropologët për të studiuar zakonet dhe sjelljet e njerëzve, është cilësore. Kjo qasje aplikohet gjithashtu në fusha të ndryshme si sociologjia, psikologjia, arsimit, historia, media dhe komunikimi, si dhe studimet kulturore

(Adams, Khan, & Raeside, 2014). Një ndër tiparet themelore në këtë qasje kërkimore është fakti se studiuesi pranon ndikimin e tij në procesin e kërkimit si interpretues dhe bashkëkrijues i njohurive me pjesëmarrësit. Të dhënat mbledhen nga vëzhgimi dhe intervistat e pjesëmarrësve shpesh në mjedise natyrore. Analiza e të dhënave në kërkimin cilësor nuk është e paracaktuar dhe strikte, edhe pse parapëlqehet njohja e modelit me të cilin kryhet analiza (Swann, 2023; Creswell & Creswell, 2018). Kjo analizë e të dhënave kryhet duke u ndërtuar në mënyrë induktive (Creswell & Creswell, 2018). Në fund, të dhënat raportohen në formë fjalësh (Swann, 2023). Raporti përfundimtar me shkrim ka një strukturë fleksibël. Ata që angazhohen në këtë formë të kërkimit kanë në fokus kuptimin individual dhe rëndësinë e raportimit të kompleksitetit të një situatë (Creswell & Creswell, 2018).

Ekzistojnë disa situata specifike në kërkim kur aplikohet qasja cilësore. Në rastet *kur dihet pak për një temë*, zakonisht duhet të favorizohet kërkimi cilësor. Për temat e reja, shpesh ka pak, në mos aspak kërkime të publikuara më parë. Kërkuesit cilësorë mund të fillojnë me pyetje të gjera dhe t'i përsosin ato gjatë intervistave ndërsa shfaqen çështje të panjohura kërkimi. Teoritë mund të zhvillohen nga rezultatet cilësore dhe të çojnë në hipoteza që mund të nxirren dhe të testohen më pas me kërkime sasiorë (Newhart & Patten, 2023; Creswell & Creswell, 2018). Në rastet *kur pjesëmarrësit i përkasin një kulture* që është e mbyllur ose e fshehtë, zakonisht duhet të aplikohet kërkimi cilësor. Një studiues cilësor i aftë, i cili është i gatshëm të kalojë kohë të konsiderueshme për të thyer barrierat që ekzistojnë, ka më shumë gjasa të jetë më i suksesshëm sesa një studiues sasior që shpenzon shumë më pak kohë duke ndërvepruar me pjesëmarrësit (Newhart & Patten, 2023). Megjithatë, kërkimi cilësor është shumë kompleks krahasuar me kërkimin sasior. Në disa raste pozita teorike nga ku nisin studimet cilësore është e paqartë ose me disa kënde. Jo rrallë herë studiuesit cilësor janë parë si kundërshtarë të studiuesve sasiorë. Këta studiues preferojnë ta shohin kërkimin cilësor jo si një qasje të mirëfilltë kërkimore, por në vend të kësaj si një përgjigje teorike ndërdisiplinore ndaj, dhe një reagim kundër, kërkimit sasior të shkencave sociale (Brennen, 2022).

3.3. Qasja e përzierë


Qasja e përzierë i referohet përdorimit disa metodave në mbledhjen e të dhënave të cilat kryhen edhe me fjalë edhe me numra. Kjo qasje është një kombinim i të dyja qasjeve të diskutuara më parë. Për shembull, kjo qasje kërkimore mund të përfshijë një fokus grup dhe një eksperiment (Swann, 2023). Nëse një studiues zgjedh ta nis mbledhjen e të dhënave me metoda sasiorë dhe ta

përfundojë me metoda cilësore, apo anasjelltas, kjo është në dorë të studiuesit ose në varësi të temës. Metodatat sasiore dhe cilësore mund të përdoren në mënyrë të ndarë ose të integruar në faza të ndryshme ose të njëjta përgjatë projektit. Qasjet e metodave të përziera përdoren zakonisht për të eksploruar, kuptuar, vlerësuar dhe sjellë veprim kolektiv dhe zhvillim në shoqëri (Scharrer & Ramasubramanian, 2021). Ekzistojnë edhe disa raste të veçanta kur duhet përdorur qasja e përziera për të kryer një studim. Në mënyrë specifike kjo qasje përqafohet kur audienca kërkon të dhëna të vështira (të tilla si ligjvënësit ose agjencitë financuese), aplikohet një projekt me metoda të përziera. Duhet të kemi parasysh se historitë dhe rrëfimet personale kanë fuqi dhe emocion të ndryshëm nga statistikat, por të dyja mund të shërbejnë për të paraqitur më mirë një fenomen (Newhart & Patten, 2023).

4. Elementet e një qasjeje kërkimore

Qasja ndaj kërkimit është plani ose propozimi për të kryer studime. Një qasje kërkimore përfshin kryqëzimin e: filozofisë, metodologjive të kërkimit dhe metodave specifike.

Figura 1. Korniza e kërkimit shkencor



Korniza që përdoret për të shpjeguar ndërveprimin e këtyre tri komponenteve vizualizohet në figurën e mëposhtme (Creswell & Creswell, 2018).

4.1. Botëkuptimet filozofike

Creswell dhe Creswell (2018) identifikojnë katër botëkuptime. Edhe pse ata shprehen se nuk ekziston një ndarje ekzakte mes botëkuptimeve, bien dakord se këto që janë renditur në skemën e epërme, janë më të dakordësuara mes studiuesve:

- a) *Post-pozitivizmi*. Siç kemi prekur edhe më herët, pozitivizmi ose post-pozitivizmi është një botëkuptim shkencor dhe përqafon atë që quhet *shkencë e pastër (pure science)*. Ky botëkuptim sfidon nocionin e së vërtetës absolute, por thekson shkakun dhe pasojën, si dhe idetë që bota qeveriset nga ligje ose teori që mund të testohen ose verifikohen. Idetë e mëdha reduktohen në grupe të dhënash që lejojnë testimin e hipotezave. Teoria çon në mbledhjen e të dhënave dhe më pas në testimin e teorisë duke përdorur metoda sasiore. Theksi është në vëzhgimin dhe matjen objektive të fenomenit apo problematikës (Creswell & Creswell, 2018).
- b) *Konstruktivizmi*. Ndryshe nga post-pozitivizmi, ky botëkuptim na shpreh se individët kërkojnë të kuptojnë botën në të cilën jetojnë dhe ndërtojnë pikëpamjet e tyre rreth saj (Jupp, 2006). Për këtë arsye, studiuesit mbështeten në pikëpamjet subjektive të pjesëmarrësve mbi botën dhe përdorin metoda cilësore për t'i mbledhur këto pikëpamje (Gaus, 2017). Sipas këtij botëkuptimi, studimi është kryesisht interpretues dhe cilësor, duke nisur nga vëzhgimi i realitetit dhe duke arritur të zhvillimin i një teorie (Creswell & Creswell, 2018).
- c) *Transformizmi*. Edhe pse ky botëkuptim është i fokusuar te të dhënat cilësore, ndjek një lloj agjende apo qëllimi. Ky botëkuptim është i orientuar drejt ndryshimit dhe argumenton se mund të ekzistojnë përzierje mes kërkimit dhe politikës për të kundërshtuar shtypjen sociale dhe për të ndryshuar për mirë jetën e individëve pjesëmarrës në kërkim. Studiuesit që i përkasin këtij botëkuptimi kanë një interes të besnik për shtresat e marginalizuara (pakicat, racat, të dhunuarit, të shtypurit, etj.). Botëkuptimi përfshin një sërë interesash kërkimore, duke përfshirë nevojën për aksion dhe analizat kritike (Creswell & Creswell, 2018).
- d) *Pragmatizmi*. Ky botëkuptim fokusohet në zgjidhjet e problemeve, në atë se çfarë funksionon, gjithë duke përdorur çdo qasje të mundshme për të kuptuar këto probleme. Në këtë botëkuptim fokusi është te problemi dhe jo te metoda. Studiuesi në këtë rast nuk angazhohet në asnjë filozofi bazë dhe për këtë arsye përfshin kërkime me metoda të përziera (Jupp, 2006). Vendimet e kërkimit bazohen në atë që studiuesit duan të bëjnë me kërkimin e tyre, gjithë duke kuptuar arsyen pse po e bëjnë atë që po bëjnë. (Creswell & Creswell, 2018).

Në fushën e komunikimit janë zhvilluar edhe botëkuptime të tjera. Për t'i patur më të qarta idetë, kujtojmë konceptin e metateorisë së komunikimit të një familjeje konceptesh, që përqafon disa tradita të ndryshme të kërkimit të komunikimit (Craig, 1999). Studiuesit e komunikimi rendisin disa tradita teorike dhe metateorike mbi kërkimin në këtë fushë të tilla, si: retorike, semiotike, fenomenologjike, kibernetike, socio-psikologjike, socio-kulturore dhe kritike. Ata sugjerojnë perspektiva të tjera që mund të merren parasysh. Për shembull, komunikimi mund të studiohet edhe nga perspektiva feministe, estetike, ekonomike ose shpirtërore (Treadwell & Davis, 2020).

5. Metodologjitë e kërkimit

Studiuesi jo vetëm që zgjedh një studim cilësor, sasior ose të përzier, por ai vendos për metodologjinë dhe metodat specifike kërkimore (Creswell & Creswell, 2018). Metodologjitë e kërkimit janë lloje të kërkimit brenda metodave cilësore, sasiore dhe të përziera, që ofrojnë drejtim specifik për procedurat në një studim kërkimor. Disa studiues i kanë quajtur modele kërkimore, të tjerë i kanë quajtur strategji kërkimore (Denzin & Lincoln, 2011). Megjithatë, zhvillimi i teknologjive ka zhvilluar në të njëjtën kohë dhe metodologjitë e kërkimit (për shembull, etnografia digjitale).

Tabela 1. Llojet e metodologjive të kërkimit

Metodologjitë sasiore	Metodologjitë cilësore	Metodologjitë e përziera
Bazuar në eksperiment	Kërkim narrativ	Model konvergjent
Konceptim gjatësor	Kërkim fenomenologjik	Sekuencial shpjegues
Bazuar në anketë	Ndërtim teorie	Sekuencial eksplorues
	Kërkim etnografi	Model kompleks
	Rast studimi	

Elementi i tretë kryesor në kuadër të perspektivave të kërkimit shkencor janë metodat specifike të kërkimit që përfshijnë format e mbledhjes, analizës dhe interpretimit të të dhënave, të cilat kërkuesit propozojnë për studimet e tyre. Duke zgjedhur qasjen që ka një punim, në mënyrë automatike kemi zgjedhur edhe metodologjinë që do ndjekë punimi në tërësi. Megjithatë, edhe pse metodologjia përcakton në nivelin marko metodat, ne kemi mundësi të përcaktojmë se me çfarë instrumenti do t'i mbledhim këto të dhëna dhe pastaj sesi do t'i analizojmë ato. Dy mënyrat

kryesore për të mbledhur të dhëna janë me numra, ose me fjalë, por ekziston edhe një mënyrë audio-vizive, por kjo në instancën e vet më të fundit, lipset të shpërfaqet ose si numër ose si fjalë. Studiuesit mbledhin informacion dhe të dhëna me një instrument ose test (p.sh., një grup pyetjesh në lidhje me qëndrimet ndaj vetëvlerësimit të edukimit për median, thënë ndryshe anketë) ose mbledhin të dhënat me anë të një liste kontrolli të sjelljeve (p.sh., vëzhgimi i një punonjësi të medias të përfshirë në një aftësi komplekse). Nga ana tjetër, mbledhja e informacioneve dhe të dhënave mund të përfshijë vizitën në një vend kërkimi dhe vëzhgimin e sjelljes së individëve pa pyetje të paracaktuara ose kryerjen e një interviste ku pjesëmarrësve iu lejohej të flasin në formën e një rrëfimi për një temë të paracaktuar, kryesisht pa drejtimin e pyetjeve specifike (Creswell & Creswell, 2018). Secila prej metodave të zgjedhura ka tiparet dhe procedurat e saj të ndërtimit, implementimit si dhe të analizës apo interpretimit. Pikërisht këtë gjë e detajon tabela e mëposhtme, krijuar nga Creswell and Creswell (2018).

Tabela 2. Tiparet e metodave sasimore, cilësore dhe të përziera

Metodat sasimore	Metodat e përziera	Metodat cilësore
Të paracaktuara	Të paracaktuara dhe emergjente (të dyja)	Emergjente
Bazuar në pyetje instrumentale (të mbyllura)	Pyetje të hapura dhe pyetje të mbyllura	Pyetje të me fund të hapur
Të dhëna performative; Të dhëna rreth sjelljes; Të dhëna të vëzhgueshme; Të dhëna nga censusi	Forma të shumta për mbledhjen e të gjitha të dhënave të mundshme	Të dhëna nga intervistimi; Të dhëna nga vëzhgimi; Të dhëna arkivore; Të dhëna audio-vizuale
Analizë statistikore	Analizë statistikore dhe tekstuale	Analizë teksti dhe imazhi
Interpretim statistikor	Interpretim i kryqëzuar i të dhënave	Interpretim tematik dhe sipas modeleve

6. Paradigmat e kërkimit

Shumë gjerë në literaturë shpjegohet sesi vendi ku jemi rritur, njerëzit me të cilët jetojmë dhe me së shumti përvojat tona të mëparshme, përcaktojnë mënyrën e sesi imagjinojmë, kuptojmë dhe përgatitemi karshi situatave. Këto përvoja janë bërë bindje ontologjike dhe përcaktojnë

marrëdhënien tonë me të ardhmen, sidomos të ardhmen e afërt. Këto bindje apo përkatësi janë quajtur paradigma. Kështu, edhe studiuesit i qasen studimit të tyre nga pozicione ose paradigma të veçanta, të cilat janë botëkuptime, metodologji, metoda ose modele për të kryer kërkime, siç është paradigma interpretuese (Faulkner & Atkinson, 2024). Një paradigme kërkimore është botëkuptimi ynë në lidhje me procesin e kërkimit që ndërthur bindjet ontologjike, epistemologjike, aksiologjike dhe metodologjike. Një paradigme përfshin besime dhe parime abstrakte për të udhëhequr studiuesit në kryerjen e kërkimit në mënyrë efektive (Swann, 2023). Megjithatë, studiuesit, e shohin disi komplekse përkufizimin e paradigmeve. Fillimisht shprehen ata, një paradigme nënkupton gjithë morinë e besimeve dhe vlerave të përbashkëta nga anëtarët e një komuniteti të caktuar shkencor. Pra, në këtë kuptim, ata i referohen paradigmës si njëfarë shkolle, ose si emërues i përbashkët mes studiuesve (Gebremedhin & Tweeten, 1994). Nga ana tjetër, paradigma tregon një metodologji konkrete të përdorur si modele ose teori që mund të zëvendësojnë rregullat si bazë për zgjidhjen e të panjohurave të mbetura të shkencës (Gebremedhin & Tweeten, 1994).

Eksitojnë disa kategorizime të paradigmeve. Cuba dhe Lincoln (1994) shprehen se katër paradigmat e zakonshme, janë: pozitivizmi, i lidhur ngushtë me post-pozitivizmi, konstruktivizmi, interpretivizmi dhe teoria kritike (Guba & Lincoln, 1994). Autorë të tjerë diskutojnë tri objektiva të rëndësishme përmes të cilave mund të ekzaminohet praktika e kërkimit, duke i paraqitur paradigmat si metodologji. Sipas tyre paradigmat e kërkimit janë: (a) metodologjitë shkencore dhe pozitiviste; (b) metodologjitë natyraliste dhe interpretuese; (c) metodologjitë nga teoria kritike (Cohen, Manion, & Morrison, 2005).

Interesante është edhe pikëpamja e studiuesve të fushës së komunikimit mbi paradigmat. Ata identifikojnë katër paradigma kryesore, që informojnë fushën:

1. *Paradigma funksionaliste*. Kjo paradigme thekson kontributin e medias në funksionimin dhe ruajtjen e rendit ekzistues shoqëror dhe favorizon kërkimin sasior;
2. *Paradigma interpretuese*. Kjo paradigme mbështetet mbi metodat cilësore për përshkrimin dhe studimin e çështjeve kulturore të kuptimit dhe përmbajtjes në lidhje me proceset e komunikimit;
3. *Paradigma radikale-humaniste*. Ashtu si paradigma interpretuese, edhe kjo lloj paradigme mbështet metodat cilësore, por me një sens të qartë se qëllimi i kërkimit është të ekspozojë rolin 'hegjonist' (mbizotërues) të medias dhe të sjellë ndryshime rrënjësore në shoqëri;

4. *Paradigma radikale-strukture*. Ndryshe nga të tjerat, kjo paradigmë e shikon median si një forcë materiale, veçanërisht politiko-ekonomike, në shoqëri. Media sipas kësaj paradigme duhet të studiohet në manifestimet e saj konkrete (d.m.th. duke iu referuar modeleve të pronësisë, kontrollit, fuqisë së tregut dhe lidhjeve politike) dhe me metoda objektive të analizës të aplikuara për të dhëna të besueshme (Hansen & Machin, 2019).

Në të njëjtën linjë qëndrojnë edhe studiues të tjerë (Alston & Bowles, 2003). Edhe pse me emërtime të tjera, ata paraqesin thujtë të njëjtat paradigma mbi kërkimin: (1) kërkim i sasior; (2) kërkim cilësor; (3) qasje emancipuese; (4) kërkim feminist; (5) kërkim post-modern (ALSTON & BOWLES, 2003).

Në mënyrë të strukturuara, me qëllim qartësimin dhe lidhjen mes njëra-tjetrës, do t'i paraqesim këto paradigma në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3. *Paradigmat e kërkimit*

Autorët	Sasiore	Cilësore	E përzierë
(Guba & Lincoln, 1994)	Post-pozitivizmi	Konstruktivizmi Teoria kritike Interpretivizmi	
(Cohen, Manion, & Morrison, 2005)	Metodologjitë shkencore dhe pozitiviste	Metodologjitë nga teoria kritike	Metodologjitë natyraliste dhe interpretuese
(Hansen & Machin, 2019)	<i>Paradigma funksionaliste</i>	Paradigma interpretuese Paradigma radikale-humaniste Paradigma radikale-strukture	
(Alston & Boëles, 2003)	Kërkim i sasior	Kërkim cilësor Qasje emancipuese Kërkim feminist	Kërkim postmodern
(Cresëell & Cresëell, 2018)	Post-pozitivizmi	Konstruktivizmi Transformizmi	Pragmatizmi

7. Si përzgjedhet një qasje apo metodologji kërkimore?

Duke pasur parasysh mundësinë e qasjeve cilësore, sasiore ose të përziera, janë disa faktorë që ndikojnë në zgjedhjen e një qasjeje mbi një tjetër lidhur me kryerjen e një studimi. Botëkuptimit, metodologjisë dhe metodave specifike, do t'u shtohen tashmë edhe problemi i kërkimit, përvojat personale të studiuesit dhe audienca(at) për të cilët do të shkruhet punimi. Po ashtu edhe metodat ose metodologjia, nuk mund të përcaktohet pa ndonjë arsyetim apo mbështetje në përzgjedhje paraprake. Studiuesit na paraqesin katër elementë që ndikojnë në përzgjedhjen e metodologjisë, të tilla si: paradigma e kërkimit, qëllimet e kërkimit, aftësitë e kërkuesit, dhe llojit të të dhënave që ekzistojnë. Le t'i marrim me radhë.

- a) *Paradigma e kërkimit.* Siç e dimë, paradigmat e kërkimit janë shkolla të mëdha të kërkimit ose të studimit të një fushe. Këto shkolla, shpesh paraqiten si komunitete të mëdha studiuesish ku ne, si studiues të rinj përpiqemi ta atashojmë veten tonë. Thënë ndryshe, janë teori, apo mendime të mëdha të autorëve që ne duam, që ne pranojmë dhe që shpesh i ndjekim. Këto paradigma, na shfaqen si qasje kërkimore, pra mënyra se si ne i përafrohemi një teme apo fenomeni për ta studiuar. Ndër të tjera, këto paradigma na shfaqen e dhe si botëkuptime, pra si grupe besimesh që na orientojnë veprimin. Nëse ne parapëlqejmë studimet sasiore, nëse lexojmë dhe pëlqejmë studiues që merren me studime të kësaj natyre, dhe nëse besojmë se e vërteta është sasiore dhe realiteti është objektiv, atëherë prirja jonë është të zgjedhim metoda sasiore.
- b) *Qëllimet e kërkimit.* Nuk ka askund kërkime pa qëllime ose pa objektiva. Pavarësisht nëse janë të deklaruara ose jo, pavarësisht mënyrës sesi ato parashtrohen, sërish mbeten të qenësishme dhe të rëndësishme. Disa nga qëllimet e studimeve mund të jenë matja e një ose disa variablave (sa të edukuar janë shqiptarët lidhur me median dhe informacionin), gjetja e disa shkaqeve të një fenomeni, matja e një pasoje, sa një variabël ndikon në një tjetër dhe shumë objektiva të tjera (analizimi, krahasimi, evidentimi, eksplorimi, etj.) Nëse ne kemi si qëllim kryesor matjen sesa..., atëherë metodat do të jenë sasiore dhe konkretisht matje me anketim.
- c) *Aftësitë e kërkuesit (përvojat).* Si kërkues, sado të rinj të jemi, kemi përvojën tonë të mëparshme. Së paku, e dimë se cila lëndë na ka pëlqyer më së shumti kur kemi qenë në universitet. Duke e ditur këtë, e kemi të qartë nëse parapëlqejmë metodat sasiore apo cilësore. Ndërsa një përvojë më shumë mund të përcaktojë se çfarë metode specifike mund apo duhet të zgjedhim.

- d) *Llojit të të dhënave që ekzistojnë.* Në botë ekzistojnë pafundësisht të dhëna për gjithçka. Megjithatë, ka disa raste, kur këto të dhëna janë më të dukshme. Nga ana tjetër, të njëjtat të dhëna mund të maten ndryshe (ose më lehtë) më njëren apo tjetren metodë. Se sa shpesh i përdorin studentët rrjetet sociale, mund të matet me anketë dhe me eksperiment. Ndërsa, si janë përvojat e tyre me këto rrjete, mund të matet edhe me intervista, apo me fokus-grupe.

Megjithatë, përzgjedhja e metodave të kërkimit mund të përcaktohet edhe nga tema e përzgjedhur, nga pyetjet kërkimore apo hipoteza e ngritur, dhe nga elementë të ngjashëm gjatë punimit.

8. Përfundimet

Ajo çka vihet re nga kërkimi në literaturë është fakti që kërkimi në media dhe komunikim, ndodh thuajse si në çdo fushë apo disiplinë tjetër. Kërkimi në media dhe komunikim konceptualisht dhe praktikisht mund të zhvillohet në qasje të ndryshme duke u bazuar në tre qasjet më të mëdha të tilla si sasiore, cilësore dhe e përzierë. Duke u bazuar në pohimin e mësipërm si dhe në literaturën ekzistueses, paradigma të ndryshme, aplikojnë qasje të ndryshme mbi të njëjtën temë kërkimore në fushën e medias dhe të komunikimit. Këto qasje orientohen nga botëkuptimet filozofike që studiuesit mbartin kur nisin të studiojnë një temë. Mandej këto botëkuptime reflektojnë punimin që para procesit, gjatë procesit, ashtu dhe pas përfundimit të procesit kërkimor. Këto botëkuptime filozofike formësohen nga mënyrat se si dhe nga kush i kemi marrë dijet. Kjo nis që tek librat e parë që kemi lexuar dhe na kanë pëlqyer dhe përfundon te teoritë specifike të komunikimi me të cilat i shpjegojmë fenomenet dhe i adaptojmë ato në kërkimet tona. Në këtë situatë, dukeq duket qartë se botëkuptimet filozofike janë në gjendje të përcaktojnë temën, teorinë, rishikimin e literaturës, metodologjinë dhe mënyrën se si do të analizohen të dhënat, apo sesi do të dalin përfundimet. Kështu pikëpamjet filozofike janë thelbësore për punën kërkimore jo vetëm në media dhe komunikim, por sidomos në këtë fushë. Kjo për arsyen themelore se komunikimi është çështje e mendjes dhe ideve, të cilat janë përherë në ndryshim dhe përherë në përpjekje për t'i lidhur konceptet dhe fenomenet, me koncepte dhe fenomene të tjera.

BIBLIOGRAFI & Referencat

Adams, J., Khan, H. T., & Raeside, R. (2014). *Research Methods for Business and Social Science Students*. New Delhi : Sage Publications.

- Alston, M., & Bowles, W. (2003). *Research for Social Workers An introduction to methods*. Australia: Allen & Unwin.
- Anderson, J. A. (2009). Philosophical Approaches to Communication. *21st Century Communication: A Reference Handbook*, 2(1), 41-48. doi:<https://doi.org/10.4135/9781412964005.n5>
- Anderson, J. A. (2012). *Media Research Methods: Understanding Metric and Interpretative Approaches*. London: Sage PUB.
- Arnett, R. C. (2016). Philosophy of Communication: Qualitative Research, Questions in Action. *Qualitative Research Reports in Communication*, 17(1), 1-6. doi:<https://doi.org/10.1080/17459435.2016.1194313>
- Brennen, B. S. (2022). *Qualitative Research Methods for Media Studies*. New York: Routledge Publications. doi:<https://doi.org/10.4324/9781315435978>
- Chibucos, T. R., Leite, R. W., & Weis, D. L. (2005). Theory: What It Is and Why It Is Important. In T. R. Chibucos, R. W. Leite, & D. L. Weis, *Readings in Family Theory* (pp. 1-10). London: Sage PUB.
- Cohen, L., Manion, L., & Morrison, K. (2005). *Research Methods in Education*. New York: Taylor & Francis Publications.
- Craig, R. T. (1999). Metadiscourse, Theory, and Practice. *Research on Language and Social Interaction*, Volume 32, 1999 - Issue 1-2, 21-29. doi:<https://doi.org/10.1080/08351813.1999.9683604>
- Creswell, J., & Creswell, D. (2018). *Research Design: Qualitative, Quantitative, and Mixed Research Approaches*. London: Sage PUB.
- Denzin, N. K., & Lincoln, Y. S. (2011). *The SAGE Handbook of Qualitative Research*. London: Sage Publications.
- Faulkner, S. L., & Atkinson, J. D. (2024). *Qualitative Methods in Communication and Media*. New York: Oxford University Press. doi: 10.1093/oso/9780190944056.001.0001
- Gaus, N. (2017). Selecting research approaches and research designs: a reflective essay. *Qualitative Research Journal*, 99-112. doi:<https://doi.org/10.1108/QRJ-07-2016-0041>
- Gebremedhin, T. G., & Tweeten, L. G. (1994). *Research Methods and Communication in the Social Sciences*. Westport: Praeger Publishers.
- Guba, E. S., & Lincoln, Y. S. (1994). Competing Paradigms in Qualitative Research. In & Y. N. K. Denzin, *Handbook of qualitative research* (pp. 105-117). New York: SAGE Publishing.
- Hansen, A., & Machin, D. (2019). *Media and Communication Research Methods*. London: RED GLOBE PRESS.
- Jupp, V. (2006). *The Sage Dictionary of Social Research Methods*. California: SAGE Publications

- Mancino, S., & Kearney, M. R. (2023). Philosophy of communication within the narrative of interpretive research. *Qualitative Research Reports in Communication* , 25(1), 127-135 . doi:<https://doi.org/10.1080/17459435.2023.2291011>
- Newhart, M. & Patten, M. L. (2023). *Understanding Research Methods: An Overview of the Essentials*. London: Routledge Publications.
- Niiniluoto, I. (2007). Evaluation of Theories. *General Philosophy of Science, Focal Issues*, 175-217. doi:<https://doi.org/10.1016/B978-044451548-3/50005-7>
- Scharrer, E., & Ramasubramanian, S. (2021). *Quantitative Research Methods in Communication: The Power of Numbers for Social Justice*. New York: Routledge Publications.
- Stewart, J. (2009). Philosophy of qualitative inquiry: Hermeneutic phenomenology and communication research. *Quarterly Journal of Speech* , 67(1), 109-121 . doi:<https://doi.org/10.1080/00335638109383555>
- Swann, P. (2023). *The Illustrated Guide to the Mass Communication Research Project*. London: Routledge.
- Treadwell, D., & Davis, A. (2020). *Introducing Communication Research*. Los Angeles: Sage Publications.

Evelina XHERIMEJA¹
Assoc. Prof. Dr. Isa ERBAS²

Technology And Education Policy: The Role Of Digital Tools In English Language Acquisition In High Schools

Abstract

This study explores the impact of technology on English language acquisition in high schools, emphasizing its role in enhancing learning outcomes and student engagement. As digital tools increasingly integrate into education, their influence on language proficiency, communication, and collaboration has become a critical area of research. The study examines various technological tools, including language learning applications, multimedia resources, virtual simulations, and online collaboration platforms, assessing their effectiveness in facilitating language learning. Additionally, it investigates the relationship between teacher-student interactions and technology integration, arguing that a supportive learning environment significantly contributes to language acquisition. This research focuses on the comparative analysis of technology-enabled language learning versus traditional classroom methods, highlighting the benefits and challenges associated with each approach. Findings indicate that while technology enhances access to authentic language materials, fosters autonomy, and promotes interactive learning experiences, disparities in digital access and the need for teacher training remain significant challenges. The study also discusses the broader educational and policy implications of digital learning in high schools, emphasizing the importance of teacher preparedness, equitable access to digital tools, and strategic implementation of technology in language education.

Keywords: *English language acquisition, technology in education, digital learning, high school education, teacher-student relationships.*

¹ MA Evelina XHERIMEJA
² Assoc. Prof. Dr. Isa ERBAS
University College Bedër

1. INTRODUCTION

1.1. Background of Study

English language acquisition in high school is a critical component of students' education, considering its importance in academic, professional, and social contexts. With the increasing integration of technology in educational settings, there is growing interest in understanding its impact on language learning outcomes among high school students.

The rapid integration of technology in high schools has raised concerns about its potential impact on English language acquisition. This study aims to identify the challenges and benefits of technology use in language learning and explore how it affects students' language proficiency and overall language acquisition process, including all the difficulties that students and teachers face and the benefits from this impact that technology has.

This study examines how technology integration in high schools affects the acquisition of the English language, exploring its influence on students' language skills, engagement, and overall learning experience.

The importance of studying the impact of technology on English language acquisition in high schools is wide. With the increasing integration of technology in education, understanding how it affects language learning is crucial. This study will provide valuable insights into the effectiveness of technology in enhancing language skills, identifying potential challenges, and informing educators on how to optimise its use. By exploring this impact, we can ensure that high school students have the best opportunities to acquire English language proficiency in a digital age.

We believe that “Technology integration in high schools boost English language acquisition through interactive learning, access to authentic materials, student communication, and collaboration.”

1.2 Research Questions

1. How does the integration of technology in high schools affect students' language proficiency and fluency in English?
2. What are the potential benefits and challenges of using technology in English language acquisition?

3. What is the role of technology in providing access to authentic language materials and resources for English language learners?
4. How does technology facilitate communication and collaboration among students for language learning purposes?
5. What strategies and best practices can be implemented to optimize the use of technology in English language acquisition?

2. LITERATURE REVIEW

Technology integration into high school education has transformed the landscape of English language acquisition. This work review aims to synthesise existing research on the impact of technology on the process of learning English in high school settings. It seeks to elucidate the multifaceted relationship between technology and English language acquisition by examining empirical studies, theoretical frameworks, and pedagogical approaches.

These tools facilitate skill development in reading, writing, speaking, and listening, catering to diverse learning styles and abilities. Moreover, technology-enhanced language-learning environments promote autonomy and self-directed learning, empowering students to take ownership of their language-learning journey (Warschauer M. &, 1998, pp. 57-71). Technology supports teaching English, enabling teachers to improve their instructional methods (İsa Erbas, 2021).

2.1 Digital Communication and Collaboration in English Learning

The emergence of digital communication platforms has heralded a transformative shift in how high school students interact with and navigate the complexities of the English language, both within and beyond the confines of the classroom. As underscored by (Thorne, 2008), the pervasive presence of social media channels, instant messaging platforms, and online forums has democratised the language acquisition process, providing students with immersive opportunities for authentic language practice and cultural exchange. Through these digital avenues, students can seamlessly engage in real-time conversations with peers from diverse linguistic backgrounds, enriching their understanding of English as a living, dynamic entity embedded within broader cultural contexts.

The integration of digital collaboration tools in language learning facilitates collaborative experiences beyond traditional classrooms, enhancing language proficiency and intercultural competence (Kern, 2006), and raises concerns about maintaining formal language standards and

responsible online communication practices due to the informal nature and anonymity of digital platforms.

2.2 Authentic Language Exposure

Such exposure to authentic materials serves to augment students' language learning journey by bolstering their comprehension skills, expanding their vocabulary repertoire, and fostering a deeper appreciation for cultural diversity, as elucidated by (Blake, 2013).

Digital platforms provide immersive language learning experiences such as virtual reality simulations and online communities, enriching linguistic skills and fostering cultural empathy. However, educators must critically select and evaluate content to ensure appropriateness and accuracy while teaching students digital literacy skills for responsible engagement with online resources.

2.2.1 Rise of Digital Technologies in English Learning

The integration of digital technologies in education has witnessed significant growth in recent years, reshaping teaching and learning practices. This literature review explores the rise of digital technologies in education, examining key trends, challenges, and opportunities identified in scholarly research.

Examining the connection between competence, confidence, and other factors in using digital resources in education is crucial. Merely offering technological tools may not be enough to motivate teachers to adopt a student-centred approach in the classroom. This highlights the importance of teachers' perspectives on digital technologies and emphasises the need for further research on how pedagogical beliefs can help address external challenges in specific contexts (Bui, 2022).

2.3 Importance of Technology in English Language Acquisition

As such, individuals with strong English language skills are better equipped to navigate diverse contexts and capitalise on opportunities for personal and professional growth. English proficiency is indispensable for academic success at both the secondary and tertiary levels. High school students, in particular, are expected to develop advanced language competencies encompassing reading, writing, speaking, and listening to meet rigorous academic standards and prepare for higher education or entry into the workforce (Cummins, 2008). Proficient English language skills enable students to comprehend complex texts, articulate their thoughts

effectively, participate in class discussions, and communicate their ideas persuasively – all of which are integral to achieving academic excellence and realising their full potential.

Furthermore, English proficiency is pivotal in facilitating social integration and cultural exchange in multicultural societies. In diverse communities where individuals from various linguistic backgrounds coexist, proficiency in a common language such as English fosters communication, mutual understanding, and collaboration across cultural divides (Cummins, 2008). It serves as a bridge that connects people from different backgrounds, enabling them to forge meaningful relationships, participate in shared activities, and engage in cross-cultural dialogue. Moreover, proficiency in English empowers individuals to access a wealth of information, ideas, and opportunities available in the globalized digital age, thereby enriching their social experiences and broadening their horizons.

Beyond its educational and social dimensions, English language proficiency holds significant implications for individuals' future career prospects and economic mobility. In an increasingly interconnected and competitive job market, proficiency in English is often a prerequisite for employment in various sectors, particularly those with international reach or requiring interaction with diverse stakeholders (Cummins, 2008). Employers value candidates who can communicate fluently and effectively in English, as it enhances their ability to collaborate with colleagues, serve clients or customers, and navigate global business environments. Moreover, English proficiency opens doors to a broader range of career opportunities, including roles in multinational corporations, international organisations, and global industries, enhancing individuals' earning potential and socioeconomic status.

Understanding the factors influencing language learning outcomes is paramount for educators, policymakers, and researchers alike in light of the multifaceted significance of English language acquisition. While traditional pedagogical approaches have long been employed to teach English as a second language (ESL) or English as a foreign language (EFL), the role of technology in enhancing language learning experiences has garnered increasing attention in recent years (Cummins, 2008). Digital tools and resources, from interactive language learning apps and software programs to online courses and virtual language exchanges, offer learners unprecedented opportunities for personalised, self-directed language practice and skill development. Enhancing students' motivation, engagement, and English language proficiency.

In conclusion, English language proficiency is not merely a desirable skill but a necessity in today's interconnected world, with far-reaching implications for academic achievement, social integration, and professional success. Mastery of the English language empowers individuals to communicate effectively, engage meaningfully with others, and pursue diverse opportunities for

personal and professional growth. As such, educators, policymakers, and researchers must continue exploring innovative approaches to English language instruction, including technology integration, to ensure that learners are equipped with the skills and competencies needed to thrive in an increasingly globalised and interconnected society.

2.3.2 The Role of Technology Implementation in English Language Acquisition among High School Students

In the contemporary educational landscape, technology implementation plays a crucial role in facilitating English language acquisition among high school students. This literature review examines the impact of technology integration, specifically online dictionaries, on the English learning process.

Technology tools enhance accessibility and individual motivation, showing noticeable improvements in these aspects (Ahmad, 2018).

The fast-paced evolution of technology often results in innovations being quickly deemed superior, only to be rapidly surpassed by even more advanced ones. However, technological progress in education should not follow the same relentless speed as industrial development. Instead, it is suggested that existing technologies can be creatively integrated to develop effective learning models (Imtiaz Hassan Taj, 2017).

2.3.3 Creating a Supportive Classroom Environment and its impact on technology in English language acquisition.

Demonstrating care for students can boost their motivation to engage in learning activities. Additionally, teachers should acknowledge student participation with positive reinforcement, such as saying, “That is a great point,” mainly when a student's input might be embarrassing. Likewise, potentially awkward comments can be temporarily set aside and later used as valuable learning opportunities (Zulfiqar Ali, 2020).

Additionally, (Hernandez, 2019) suggests that integrating culturally relevant content via technology can boost student motivation and engagement in language learning, thereby contributing to a supportive classroom environment.

2.3.4 Innovations in Learning Technologies that Impact English Language Learning.

Motteram's edited volume, *Innovations in Learning Technologies for English Language Teaching*, extensively examines technology's transformative influence on English language education. Through a meticulously curated selection of chapters contributed by prominent

experts, the book provides valuable insights into harnessing learning technologies for effective language instruction. Encompassing diverse themes ranging from augmented reality to mobile applications, the volume thoroughly explores various technological innovations and their real-world applications within language learning contexts (Motteram, 2022, pp. 48-78).

Technology has significantly impacted the English language. While it has enhanced communication and language learning, it has also introduced challenges and changed how English is used and understood. The continuous evolution of the language due to technological advancements remains a topic of interest, but technology will continue to play a crucial role in shaping its future (Ilkhamovna, 2023).

3. DISCUSSION

In today's digital age, high school students have unparalleled access to many technological resources that aid in English language acquisition. Among these resources, online dictionaries stand out as indispensable tools providing instant access to definitions, synonyms, and pronunciation guides. This literature review explores the impact of online dictionaries on the English language learning process among high school students.

Online dictionaries offer unparalleled accessibility and convenience to high school students. With just a few clicks, students can access a vast repository of words and their meanings, eliminating the need for bulky printed dictionaries. This accessibility facilitates a seamless learning experience, enabling students to engage with English language resources anytime, anywhere (Smith J. &, 2019).

One of the most significant advantages of online dictionaries is the provision of instant feedback and support. Students can quickly look up definitions, synonyms, and even pronunciation guides when encountering unfamiliar words in texts or assignments. This immediate access to information enhances comprehension and promotes independent learning (Jones L. e., 2020).

Studies suggest that regular use of online dictionaries correlates with enhanced vocabulary acquisition among high school students. Students deepen their understanding of word usage and context by exploring synonyms, antonyms, and example sentences. Furthermore, the interactive nature of online dictionaries fosters active engagement, leading to more profound retention of vocabulary (Garcia S. &, 2018).

Online dictionaries empower high school students to take ownership of their language-learning journey. These tools promote autonomous learning and problem-solving skills by providing self-directed access to linguistic resources. Students learn to navigate complex texts independently, gradually building confidence and proficiency in English (Brown A. &, 2017).

In conclusion, online dictionaries facilitate English language acquisition among high school students. Their accessibility, instant feedback, vocabulary enrichment features, and promotion of autonomous learning contribute significantly to student success in language learning endeavours. As technology continues to evolve, educators should harness the potential of online dictionaries to maximise student engagement and achievement in English language education. Teachers play a crucial role in shaping students' attitudes towards learning English. Teachers empower students to challenge themselves and strive for improvement by providing support, understanding, and encouragement. When students feel trusted and valued by their teacher, they are more likely to take risks in their language learning journey, leading to greater development of their English skills. Productive language skills, such as speaking and writing, are often used to assess students' understanding of English. However, these skills can be compromised if students harbour negative feelings towards their teacher. Fear of making mistakes or lack of recognition for their efforts can inhibit students' willingness to participate actively in the classroom, hindering their productivity and overall learning experience.

According to the results of the research questions, starting with the first question on *How does the integration of technology in high schools affect students' language proficiency and fluency in English?* Technology integration in high schools positively impacts students' language proficiency and fluency in English by providing interactive and engaging learning experiences. Technology facilitates regular practice through language apps, multimedia resources, and virtual simulations, which enhance listening, speaking, reading, and writing skills. It also promotes self-paced learning and personalized feedback, thereby improving overall language competence and confidence among students.

According to the second research question: *What are the potential benefits and challenges of using technology in English language acquisition?* Using technology in English language acquisition offers several benefits, including enhanced access to authentic language materials, interactive exercises that promote engagement and motivation, personalized learning experiences through adaptive technologies, and opportunities for global collaboration among learners. However, these advantages are accompanied by challenges such as unequal access to technology, potential distractions that can hinder focused learning, varying quality of online resources necessitating careful selection by educators, and the risk of over-reliance on technology at the expense of developing essential language skills like face-to-face communication and critical thinking. Balancing these benefits and challenges requires thoughtful technology integration into language learning environments to maximise its potential while addressing its limitations.

Also, the results of the third research question: *What is the role of technology in providing access to authentic language materials and resources for English language learners?* Technology is crucial in providing English language learners access to authentic language materials and resources by offering a vast array of digital content such as articles, videos, podcasts, and literature from native speakers and diverse cultures. Online platforms and digital libraries allow learners to explore current and culturally relevant materials often inaccessible through traditional means. This exposure helps learners develop authentic language skills, cultural awareness, and a deeper understanding of language usage in real-world contexts, enhancing their overall English proficiency.

According to the fourth research question: *How does technology facilitate communication and collaboration among students for language learning purposes?* Technology facilitates communication and collaboration among students for language learning by providing various tools such as instant messaging, video conferencing, and collaborative platforms. These tools enable students to interact in real-time regardless of geographic location, fostering language practice and cultural exchange. Online forums, discussion boards, and shared document editing features allow students to collaborate on projects, provide feedback on language tasks, and engage in peer-to-peer learning. Additionally, social media and language learning apps provide informal communication and community-building spaces among learners, enhancing their language acquisition experience through authentic interactions.

According to the last research questions: *What strategies and best practices can be implemented to optimise the use of technology in English language acquisition?* To optimise the use of technology in English language acquisition, educators can implement several strategies and best practices. First, ensure access to reliable internet and appropriate devices for all learners to minimise disparities. Encourage active engagement by incorporating interactive activities, multimedia content, and gamified learning platforms that enhance motivation and retention. Provide opportunities for collaborative learning through online forums, virtual group projects, and peer feedback mechanisms. Lastly, the effectiveness of technology integration should be regularly assessed through student feedback and data analysis to refine instructional strategies and improve learning outcomes.

In response to the first question, what level of importance does the good or relationship between teachers and students have in high school?

In high school, the quality of teacher-student relationships plays a pivotal role in shaping students' academic success and overall well-being. Hattie's research underscores that positive teacher-student relationships are not merely incidental but are foundational to creating a

conducive learning environment (Hattie, 2021). Beyond their direct impact on academic achievement, these relationships foster a sense of belonging and emotional support among students, which is crucial for their socio-emotional development. When students feel valued and respected by their teachers, they are more likely to actively engage in learning, participate in classroom discussions, and persevere through academic challenges.

According to the second question: What are the disparities between a positive teacher-student relationship class and a negative one in the context of learning English in high school? There have been a number of suggestions given.

In high school English classes, positive teacher-student relationships significantly boost student engagement, motivation, and academic achievement (Roorda, 2022). Conversely, negative relationships often lead to decreased engagement and hindered language learning progress. Therefore, fostering positive teacher-student relationships is crucial for creating an enriching learning environment.

Also, the result related to the third question: “Does technology implementation play a crucial role in English learning acquisition?”

Technology implementation plays a crucial role in English learning acquisition. Recent research (Smith J. , 2023) highlights the significant impact of technology on language learning outcomes. Digital tools such as language learning apps, online dictionaries, and interactive platforms provide students with access to diverse learning resources, personalized practice opportunities, and immediate feedback, all of which are essential for language acquisition. Moreover, technology facilitates immersive language experiences through access to authentic materials and interactive multimedia content. Additionally, technology enables collaborative learning environments, connecting students with peers and language experts worldwide. Overall, the integration of technology enhances the effectiveness and accessibility of English language learning, making it a vital component of language acquisition in contemporary education.

The fourth and last question is: “How can teachers effectively integrate technology into the classroom to enhance students' English language learning?”

Teachers can effectively integrate technology into the classroom to enhance English language learning for students by adopting a multifaceted approach that leverages digital tools and resources to support various aspects of language acquisition. Recent research by (Brown A. &, 2022) offers valuable insights into effective strategies for technology integration in language classrooms. Firstly, teachers can utilize language learning apps and online platforms to provide supplemental practice opportunities for vocabulary acquisition, grammar comprehension, and language skills development. These resources offer interactive exercises, quizzes, and games

that engage students and reinforce learning in a fun and accessible manner. Secondly, teachers can incorporate multimedia content, such as videos, podcasts, and digital simulations, to provide authentic language experiences and cultural immersion. These materials expose students to real-world language contexts and help improve listening comprehension, pronunciation, and cultural understanding. Additionally, teachers can utilize collaborative tools, such as virtual classrooms, discussion forums, and video conferencing platforms, to facilitate peer interaction, language exchange, and collaborative projects. By fostering a dynamic and interactive learning environment that integrates technology, teachers can enhance students' engagement, motivation, and language proficiency in English learning.

By incorporating these strategies, teachers can harness technology's potential to enrich English language learning experiences and better meet their students' diverse needs.

Based on the literature gathered during the, we conclude that a good teacher-student relationship has positive effects and motivates students to learn the English language. We also conclude that technology plays a crucial role in integrating students. What both sides, students and teachers, should do is create that chain of good relationships and use them for the learning process.

4. CONCLUSION

This study aimed to analyze the impact of technology on English language acquisition in high school by placing a special emphasis on the significant influence it has and the fact that English learning could not be effective without a good relationship. The research questions of the study were: 1. What level of importance does the good relationship between teachers and students have in high school? 2. What are the disparities between a positive teacher-student relationship class and a negative one in the context of learning English in high school? 3. Does technology implementation play a crucial role in English learning acquisition? 4. How can teachers effectively integrate technology into the classroom to enhance English language learning for students?

The second chapter focuses mainly on the social part of the relationships and the importance of technology's impact on high school English language acquisition. It emphasises English learning and the importance of strategies for teachers and students to build a good relationship that influences the learning process with the help of technology. Lastly, it gives the scholars statements of the impact of technology on learning skills and having a good relationship with each other, arguing how crucial they are to have effective English teaching and learning.

The literature of the study shows that the technology-teacher-student relationship in learning English is considered indispensable and a key element in effective learning. A good teacher-

student relationship is also considered important by the students. Based on this study, technology implementation plays a crucial role in English learning acquisition. All teachers should remember the most effective way to build a good relationship and integrate with technology, which will also improve how their students learn. It would be valuable to investigate “teachers and students” views and opinions on the impact of technology on English language acquisition in high schools.

Recommendations

Considering that the impact of technology on English language acquisition is crucial for students’ achievement, much more attention should be given to it. However, relying on the research, the following recommendations can be made:

1. Teachers should prioritise implementing technology in class so that students can improve and be more eager to learn English.
2. Teachers must undergo training to update their teaching skills with technology. This ensures they can effectively utilise new tools to improve their teaching methods, benefiting students by creating engaging learning environments and preparing them for success in a digital world.

BIBLIOGRAPHY

- Ahmad, M. R. (2018). The Use of Technology in English Language Learning: A Literature Review. *International Journal of Research in English Education*, 115-125. Retrieved from <http://ijreeonline.com/article-1-120-en.pdf>
- Blake, R. (2013). Technology and Foreign Language Learning. *Brave New Digital Classroom*.
- Brown, A. &. (2017). Empowering High School Students through Online Dictionaries:. *Journal of Language Education Technology*, 15(2), 45-58.
- Brown, A. &. (2022). Strategies for Effective Implementation. *Integrating Technology into the English Language Classroom*, 211-228.
- Bui, T. H. (2022). English teachers’ integration of digital technologies in the classroom. *International Journal of Educational Research Open*, 1-15. Retrieved from <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S2666374022000802>
- Cummins, J. (2008). *Challenging the two solitudes assumption in bilingual education*.
- Garcia, S. &. (2018). Exploring the Impact of Online Dictionaries on Vocabulary Acquisition in High School English Language Learners. *Language Learning Journal*, 321-335.
- Hattie, J. (2021). *Visible Learning: A Synthesis of Over 800 Meta-Analyses Relating to Achievement*. Routledge.

- Hernandez, L. &. (2019). Promoting Cultural Competence in High School English Language Acquisition. 89-102.
- Ilkhamovna, B. M. (2023). The Impact of Technology on the English Language. *Между народный научный журнал No5(100), часть I «Научный импульс»*, 1843-1847.
- Imtiaz Hassan Taj, F. A. (2017). Effect of Technology Enhanced Language Learning on Vocabulary Acquisition of EFL Learners. *International Journal of Applied Linguistics & English Literature*, 262-272. Retrieved from <https://journals.aiac.org.au/index.php/IJALEL/article/view/3104>
- İsa Erbas, R. Ç. (2021). The Impact of Technology on Teaching and Teaching English to Elementary School Students. *Linguistics and Culture Review*, 1316-1337. Retrieved from <https://lingcure.org/index.php/journal/article/view/1815>
- Jones, L. e. (2020). The Role of Online Dictionaries in Supporting English Language Learning: 1769-1785.
- Kern, R. (2006). *Perspectives on technology in learning and teaching languages*, 83-210.
- Motteram, G. (2022). *Innovations in Learning Technologies for English Language Teaching*. London: British Council.
- Roorda, D. L. (2022). The Influence of Affective Teacher–Student Relationships on Students’ School Engagement and Achievement: . *A Meta-Analytic Approach*, 93–120.
- Smith, J. (2023). The Role of Technology in Language Learning:.. 123-140.
- Thorne. (2008). Transcultural communication in open Internet environments and CALL research. *A sociological view*, 528-546.
- Warschauer, M. (n.d.). *echnology and equity in schooling: Deconstructing the digital divide*. 2019: Routledge.
- Zulfiqar Ali, F. M. (2020). Creating Positive Classroom Environment For Learners’ Motivation Towards Communicative Competence In The English Language. *Journal of the Research Society of Pakistan* , 317-328.

Gjergji PENDAVINJI¹

**Filozofia Sokratike E Shekullit V (P.E.S.) - Kthesë
Historike Në Filozofinë E Vlerave Njerëzore**

Abstract

In ancient philosophy, the 5th century is considered the "golden age" because science and philosophy took an unprecedented leap. Socrates also belongs to this century as a powerful philosopher and genius thinker who, with the power of reason and reflection, became the "soul of Athens". Philosophers before Socrates were mainly thinkers who directed reflection to nature and its study. They were mainly considered physicists. Socrates, unlike the tradition of physicists, changed the direction of this philosophy. He oriented philosophy to the study of man, of his inner self. For this reason, Socrates constitutes a turning point in philosophy, that is, the point where the direction of philosophizing changes from nature to man and human values. This innovation divides philosophers into pre-Socratics (philosophers who were not under the influence of Socrates' philosophy) and Socratics (philosophers who were under the influence of Socrates' philosophy). Socratic philosophy opened a new page in the theory of recognizing the inner values of man through introspection. The foundation on which this philosophy rests is the Socratic maxim: "Man knows himself!" Knowing himself, the interest in the inner man, aims at discovering and externalizing the principles and values of good behavior, which direct human activity towards morality and virtue. Socratic aretology would become a way of life for the Athenians of his century. Socrates proved this feature of philosophy with his life and death. The influence of Socratic philosophy on the life and biography of philosophers would become an important feature of Western philosophy. This philosophy permeated the entire political life and government of Athens in the 5th century (BC). This is best evidenced by the epitaph of Pericles, the emperor of Athens, in which the highest moral values bestowed on heroes are evoked.

Keywords: *diote, introspection, Socratic aretology, turning point in the history of philosophical thought, human values, aretology and virtues, Epitaph of Pericles.*

¹ Prof. Dr. Gjergji PENDAVINJI
Universiteti "Fan S. Noli",
Korçë,
ALBANIA

Kthesa historike që shënoi Sokrati në filozofi, për më tepër, ishte një nevojë e ndërgjegjësimit moral të shoqërisë antike greke në momentet kur mendimi, besimi dhe zakonet e vjetra ishin tronditur (JACOBY, 2001: 22-27). Sokrati e përqëndroi vëmendjen tek ai element thelbësor për qytetërimin e epokës së tij që kishte të bënte me etikën, politikën, dhe njëkohësisht dijen shkencore. Ai në dallim nga sofistët kërkonte një të vërtetë përtej opinioneve personale që mund të shfaqte çdo njeri, pra ai kërkonte të vërtetën më të lartë, të vërtetën e qëndrueshme (stabël).

E vërteta si proces kërkimi

Sokrati besonte se

“E vërteta nuk mund të ndahet nga ai që e shpreh dhe nga çasti kur ajo shprehet.” (ZHANË, 1993: 16-32).

Akoma më tej ai shpjegon se

“Të vërtetat nuk janë si sendet, ato janë filozofike.” (ZHANË, 1993: 16)

pra që duhen arsyetuar. Një e vërtetë e tillë nuk është thjesht një shprehje që lidhet në mënyrë direkte me realitetin apo me një gjëndje faktike, objektive të pavarur nga ai që flet apo që shkruan. Përkundrazi, e vërteta për Sokratin është një gjykim nëpërmjet të cilit njeriu i lirë përvetëson një të vërtetë, e bën atë të tijën, e bën “të vërtetë” me anën e mënyrës sesi priret drejt saj. Në këtë kuptim, një e vërtetë e tillë e quajtur teorike është gjithmonë në të njëjtën kohë edhe një e vërtetë praktike përderisa varet nga ai që e përvetëson, përderisa varet nga veprimi që ajo ushtron mbi të apo nga fakti se çbën ajo me të. (ZHANË, 1993: 17).

Sokrati, me anën e këtij përcaktimi për të vërtetën, synonte të inspironte tek nxënësit e tij shpirtin e së vërtetës të pandarë nga njeriu, një të vërtetë që është proces i një kërkimi të pandalur nga ana e njeriut, një të vërtetë teorike të arsyetuar prej tij dhe në të njëjtën kohë edhe praktike, sepse ajo varet nga ai që e përvehtëson të vërtetën. Njerëzit shpesh mbajnë dhe pranojnë disa ide për të vërteta, mirëpo kjo nuk mjafton për t’u konsideruar e saktë, sepse ajo nuk është bërë ende e vërtetë.

Njohja e së vërtetës u bë misioni filozofik i Sokratit, të cilit do t'i përkushtohej me gjithë forcën e jetën e tij. Ky mision do të mbështetej tek kërkimi si proces dhe gjithashtu te edukimi i vetvetes si dhe i bashkëqytetarëve të tij, drejt vetnjohjes dhe vetkontrollit. Nga dëshmitë e Platonit, veçanërisht tek “Apologjia” (PLATONI, 2021: 3-63) zbulohet synimi emblemantik i Sokratit në formulën: “Njeri njih vetveten!”, e cila njihet në filozofi si diota e tij. Diota sokratike përqëndrohet në të diturit mbi bazën e njohjes të vetvetes dhe në lidhje me këtë Sokrati formuloi idenë: “Unë di se nuk di asgjë!”, ide e cila përbën një tjetër argument të kësaj diote. Kjo thënie e famshme kishte kuptimin se:

“Unë e kam mprehtësinë, e kam nuhatjen time për të vërtetën deri në atë pikë që kërkesa ime për të vërtetën nuk mjaftohet më me dukjet e së vërtetës që herë herë unë i mbaj për të vlefshme. Por ajo që zotëroj unë është kërkesa për një të vërtetë më të lartë, jo e vërteta në vetvete.”

Tek Sokrati ne gjejmë një prirje të rëndësishme drejt dijes krijuese si proces (ZHANË, 1993: 19) një zbulim të mosdijes që shkakton tek njeriu kërkesën për të vërtetat në tërë vërtetësinë e tyre. Pra, në këtë konceptim, njeriu e kërkon të vërtetën. Ndërgjegjja ime reflekton mbi veten e saj domethënë unë reflektoj mbi vetëdijen time mbi vetë mendimet e mia dhe zbuloj se dija ime në një shkallë të gjerë është një mosdije, sapo kërkesa ime për të vërtetën nis të bëhet pak a shumë e fortë.

Në filozofinë sokratike një vend mjaft të rëndësishëm zë veprimtaria e tij duke përdorur metodën dialektike në filozofi (JAN, ERRIT, JELLE, 1992: 32). Kjo metodë bazohet tek bashkëbisedimi me të tjerët duke i ftuar ata në dialog, duke i nxitur ata të bëjnë pyetje dhe të japin opinionet e tyre lidhur me to. Sokrati i drejtonte bashkëbiseduesit e vet drejt të kuptuarit për paditurinë e tyre, si hap i domosdoshëm për fillimin e kërkimit të çdo diturie. Ndryshimi midis njeriut të ditur dhe njeriut të paditur qëndron pikërisht në faktin se i dituri njeh mangësitë e dijeve të tij dhe për këtë arsye ai dëshiron të mësojë, ndërsa i padituri kujton se i di të gjitha dhe e konsideron vetveten të aftë të japë opinionin e tij për gjithshka. Metoda dialektike, ajo përmes dialogut, kishte si qëllim largimin e paditurisë duke përdorur një qëndrim të durueshëm dhe plot modesti me bashkëbiseduesit me synimin, që ata t'i braktisnin opinionet e rreme përballë saktësisë të së vërtetës.

Vlera vendimtare e filozofisë së Sokratit qëndron tek sfera etike e jetës. Dinjiteti i individit, sipas tij gjendet tek dija e tij. Dija është themeli i të gjitha virtuteve dhe vetnjohja është mënyra

se si duhen njohur këto vlera etike. Në aretologjinë sokratike virtuti konsiderohet si dituria e të mirës ndërsa gabimi është mungesa e kësaj diturie. Me anën e metodës së tij dialektike ai vërtetoi se jeta morale është në fakt një përpjekje e pandalur e njeriut për përmirësimin e tij etik dhe pjesëmarrja e tij tek gjithshka e mirë dhe e bukur është e vetmja mënyrë për të arritur mirësinë e vazhdueshme, “edhemoninë”. Sokrati e bashkoi edhemoninë me virtutin ai besonte se njeriu mund të arrijë virtutin me anën e filozofisë duke testuar vetveten dhe të tjerët me anën e introspeksionit dhe empatisë. Në aretologjinë sokratike çmohet shumë virtuti i vetpërmbytjes, virtut të cilin ai e manifestoi gjatë gjithë jetës së tij.

Në historinë e mendimit filozofik Sokrati konsiderohet si një pikë infleksioni (JAN, ERRIT, JELLE, 1992: 28). për arsye sepse e ndryshoi kurbën e filozofimit nga natyra tek njeriu. Themelet e palëvizshme të botës Sokrati i vendosi tek bota e brendshme e njeriut, tek shpirti si kapacitet për inteligjencë dhe karakter. Shpirti është personaliteti i vetëdijshëm i njeriut, shpirti është struktura e personalitetit. (PLATONI, 2021: 16) Me këtë strukturë ne shohim të shpaloset një armaturë konceptuale e aretologjisë në themel të së cilës vihet karakteri, nderi dhe dinjiteti i njeriut. Ndërsa filozofia është një lloj “mamije intelektuale” që e ndihmon njeriun për lindjen e karakterit. Vetëvëzhgimi pra kujdesi për të brendshmen dhe virtutet ishin ftesë për dinjitet dhe lumturi.

Simpatia për Sokratin ishte shumë e madhe, ai ishte bërë “shpirti i Athinës” aq sa me vdekjen e tij athinasit humbën shpirtin e tyre. Për Sokratin egzistojnë situata ku dija në vetvete nuk është e mjaftueshme për të na udhëhequr në vendimet e drejta. ajo ka nevojë për “demonin” që ndodhet brenda vetes, demon i cili është një zë këshillues për vetëkontroll duke çmuar durimin dhe vetëpërmbytjen. (PLATONI, 2021: 3-63) Këtë aspekt e shfaqti edhe në gjyqin e tij. Ai ishte i bindur se është më mirë të të bëjnë një padrejtësi se sa të bësh padrejtësi ti vetë. Por fundi i jetës së tij ishte konfirmimi i filozofisë së tij. Kundërshtarët e tij e akuzuan Sokratin për blasfemi, sepse i përbuste perënditë dhe korruptonte të rinjtë dhe për këtë akuzë ai u dënua me vdekje. Mbrojtja e tij në gjyq ishte një model i paarritshëm i shpalosjes së dinjitetit, i cili buronte nga mençuria e tij dhe qëndresa heroike duke qenë i bindur jo vetëm për pafajësinë e tij, por edhe për vlerën e madhe të jetës dinjitoze dhe mësimet e tij, të cilat ia kushtoi Athinës.

Fryma sokratike në Athinën e shekullit V (p.e.s.)

Sokrati me filozofinë e tij jo vetëm fitoi simpatinë e qytetshtetit të tij, por rrezatoi me një shkëlqim të paparë në mendjet e zemrat e bashkëkohësve të tij. Ky rrezatim përfshiu të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore si filozofinë dhe shkencën, letërsinë dhe kulturën por veçanërisht ai ndikoi fuqishëm edhe tek jeta politike tek politikanët, tek udhëheqësit e tyre. Ne shohim një ndikim të fuqishëm të filozofisë dhe aretologjisë sokratike tek Perikliu (TUQIDIDI, 2002: 10) që qeverisi, udhëhoqi dhe sundoi Athinën rreth viteve 480 deri 430 (p.e.s.), vite në të cilat ky “polis” (qytetshtet) shkëlqeu nën sundimin e tij. Nga mjaft dëshmi shohim një ndikim të madh të mendimit sokratik tek mendimi politik i Perikliut sidomos tek mbështetja e fuqishme e tij për vlerat morale të bashkëqytetarëve të tij, vlera të cilat ai i inspiroi me një forcë të jashtëzakonshme.

Për këtë qëllim ne kemi zgjedhur ti referohemi një fjalimi të famshëm të tij që njihet si “Epitafi i Perikliut” i mbajtur nga fundi i vitit 431 (p.e.s.), viti i invazionit të spartanëve mbi Atikë dhe tërheqjes së Athinës sipas planit të Perikliut pas mureve të qytetit. Ky fjalim u kushtojë të rënëve në luftë gjatë ceremonisë së tyre të varrimit për t’i mbuluar ata me nder e lavdi për veprën e lartë që ata kryen ndaj atdheut, për trimërinë e vetmohimin e treguar në luftë. Epitafi i Perikliut është shkruar nga historiani i famshëm grek Tuqididi, (TUQIDIDI, 2002:9) bashkëkohës i periudhës së Perikliut, i cili është përpjekur ta shkruajë me objektivitet dhe përpikëri fjalën e udhëheqësit të Athinës, Perikliut.

Kriteri i parë dhe vendimtar për qytetarin e parë, politikanin qeverisës është virtuti. Pikërisht Perikliu mbartte këto virtute themelore: ai dinte të dallonte se çfarë ishte e domosdoshme që të bëhej dhe gjithashtu dinte tja shpjegonte këtë popullit të vet. Perikliu ishte patriot, ai e donte fort atdheun e tij, por gjithashtu ai ishte i pakorruptueshëm nga paraja. Perikliu ishte politikan me autoritet dhe aftësi të mëdha dhe ishte superior ndaj parasë. Gjithashtu ai ishte i aftë ta përmbante popullin pa ja kufizuar atij lirinë, ai nuk i shkonte pas popullit por e udhëhiqte atë dhe nuk synonte të rriste influencën e tij me mjete të paligjshme:

“Një burrë i tillë, - shkruan Tuqididi, - do të arrinte të ruante avantazhet e demokracisë pa lejuar shfaqjen e rreziqeve të saj.” (TUQIDIDI, 2002:14-15)

Fryma e filozofisë sokratike përshkon gjithë mendimin e veprimtarinë politike të Perikliut. Ai inspironte frymën e qytetarisë tek athinasit. Ai e shikonte qytetarin si një njeri që pranon dhe ka nevojë për debatin, që respekton tjetrin dhe njëkohësisht respekton edhe veten prandaj dhe

ai nuk e shkel ligjin. Atë pra qytetarin, e sundon një vetëdije e lartësuar, frika për të mos shkelur ligjin, një nënshtrim i vullnetshëm ndaj ligjit. Perikliu mendonte se e vetmja gjë që nuk plakët tek njeriu është ndjenja e nderit. Në këtë kuptim qytetari i Athinës zotëroi hapsirën dhe kohën nëpërmjet barazisë, meritokracisë dhe lirisë së shprehjes e të veprimit në jetën publike dhe private. (TUQIDIDI, 2002:17)

Ne shohim se epitafi i Perikliut ka një karakter të theksuar diakronik. Ai përfaqëson një traktat të kondensuar filozofik që jo vetëm i ka shërbyer epokës së tij por ka ndriçuar gjithë etapat e historisë njerëzore. Ky karakter diakronik buron nga fakti se ai mbështetet në një filozofi vlerash mbi një aritologji të pastër siç e themeloi Sokrati dhe mbështetësit e tij. Në vijim po ndalemi tek disa nga këto vlera që i përmban epitafi.

Në këtë fjalim të përmortshëm Perikliu vlerëson lavdinë e heronjve të rënë në luftë, por nga ana tjetër ai i përmbahet edhe nocionit filozofik të masës. Kjo lavdi nuk duhet të jetë e egzagjeruar ajo duhet të jetë e matur dhe e merituar me qëllim që të jetë edhe e besueshme, sepse sipas tij

“Është e vështirë të flasë dikush në masën e duhur në situata në të cilat edhe vetë paraqitja e së vërtetës me zor bëhet e besueshme” (TUQIDIDI, 2002:26)

Lavdia, gjithashtu ju takon të parëve tanë prej të cilëve i trashëguam këto troje, falë trimërisë së tyre. Vlera e atdhedashurisë dhe vetmohimit për mbrojtjen e tij vendosen në qëndër të jetës morale dhe inspirimit të kësaj fryme tek gjeneratat. Të rënë në luftë për atdheun, thekson Perikliu, këta burra u treguan të denjë për qytetin dhe ju të mbijetuarit duhet ta konsideroni detyrën tuaj guximor ndaj armiqve. Dobinë e saj duhet ta vlerësoni jo thjesht në bazë të fjalëve të oratorit por të veprës tuaj, vigjilencës ndaj fuqisë së qytetit derisa të bëheni admirues të tij (Epitafi..., fq. 27). Akti vetmohues i heronjve të rënë për atdheun është vlera me ndikim të fuqishëm për edukimin e qytetarëve me këtë virtut. Akti i heronjve të rënë në luftë është nder e krenari për prindrit e familjet e tyre. Ky vlerësim arsyetohet në një mënyrë shëmbëllore tek epitafi: “Prindrit e të rënëve që varrosim sot do të përpiqem ti ngushëlloj, por edhe tju tregoj se sa fatlumë ishin ata, bijtë tuaj, që fati u fali vdekje kaq nderuese ose zi kaq nderuese si e juaja, për ata bij që caku i lumturisë përkoji me çastin e vdekjes.” (TUQIDIDI, 2002: 37)

Perikliu, në këtë epitaf, vlerëson edhe sistemin politik të demokracisë athinase si modelin më të mirë të qeverisjes, sepse sic argumenton ai,

“... ne jetojmë realisht në një sistem politik i cili nuk përpiqet që të kopjojë ligjet e të tjerëve, por madje jemi në që përbëjmë shembull për të tjerët.” (TUQIDIDI, 2002: 28)

Tërheq vemendjen një konceptim me karakter tepër diakronik, idenë e së cilës e kishte trajtuar e përpunuar Sokrati lidhur me ndryshimin thelbësor midis modeleve të “Shoqërisë së mbyllur” dhe “Shoqërisë së hapur” në një sistem politik demokratik. Sipas këtij konceptimi shoqëria e mbyllur nuk e konkuron dot shoqërinë e hapur, përkundrazi modeli i “shoqërisë së hapur” është superior dhe më efikas në raport me modelin e “Shoqërisë së mbyllur”. Përvoja e shoqatave (Eterive) të Pitagorës e provon këtë ide. Këto shoqata u formuan nga pitagorasit bazuar në principin e konspiracionit dhe në vetvete ishin modeluar si “shoqëri të mbyllura”. Këto shoqata u shpërbënë sepse nuk i rezistuan dot modelit të “shoqërisë së hapur”. Kjo ide u rimor nga filozofi i madh modern Karl Popperi i cili argumentoi ligjësinë historike të modelit të organizimit politik “te shoqërisë së hapur” në një sistem demokratik. Në epitafin e Perikliut kjo ide formulohet si vijon: “Jemi superiorë ndaj kundërshtarëve tanë edhe nga mënyra e ushtrimit të çështjeve ushtarake. Portat e qytetit tonë i kemi të hapura për të gjithë dhe kurrë nuk pengojmë askënd të huaj që do të përfitojë duke parë e mësuar diçka nga frika se mos duhet të ruajmë fshehtësinë me qëllim që të mos përfitojnë armiqtë.” (TUQIDIDI, 2002: 29)

Ideja e cituar më lart është shprehja më e qartë e karakterit diakronik të këtij epitafi mbajtur nga Perikliu dhe sigurisht një provë e qartë e ndikimit të frymës sokratike tek ky udhëheqës.

Filozofia sokratike si mënyrë jetese

Jeta dhe filozofia e Sokratit janë të pandara sepse kjo e fundit ndriçonte jetën e filozofit. Sokrati u bë tendencë në jetën e bashkeqytetarëve të tij të cilët pëlqenin të ishin në jetën e tyre njëlloj Sokrati me plot dinjitet. Kjo veçori e bashkimit të filozofisë me jetën e filozofit do të transmetohet në të gjitha epokat e historisë së filozofisë dhe të filozofëve (JACOBY, 2001: 25). Për këtë arsye në botën perëndimore filozofia është konsideruar si një “modus viventi”. Ndryshimi midis kërkimit në shkencë dhe kërkimit në filozofi qëndron në faktin se problemi shkencor përgjithësisht studjohet në mënyrë objektive, të pavarur, ndërsa çështja filozofike nuk është krejt e ndarë nga filozofi për faktin se ajo ka të bëjë kryesisht me esencën e njeriut; por në të njëjtën kohë ndërsa problemi shkencor ka një zgjidhje çështja filozofike ka marrje të një pozicioni.

Filozofia është kuptuar shumë herët si një mënyrë jetese dhe jo vetëm si një refleksion teorik. Thuhet ndryshe; të jesh filozof, kjo do të thotë të jetosh e të veprosh në një mënyrë të caktuar dhe jo vetëm të konfrontohesh me çështjet abstrakte. Etimologjia e termit “filozofi”:

“Tregon qartë se filozofi është ai që shkon drejt diturisë, që kërkon të jetojë siç duhet dhe akoma më tepër që kërkon nderin dhe lumturinë. (GRIGORIU, 2003: 69).

Filozofia duke qënë një mënyrë e jetës e vë theksin tek vënia në aplikim në jetë të rezultateve të refleksionit filozofik. Ideja që filozofia është një mënyrë e të jetuarit ka mundur ti çojë disa filozofë të imagjinojnë dhe për këtë arsye ata janë bërë udhëhëqes të të tjerëve duke i ndihmuar ata të drejtojnë me korektësi egzistencën e tyre. Që prej para sokratikëve por mbi të gjitha nisur nga Sokrati gjithë tradita ka mbrojtur këtë konceptim të filozofisë si një mënyrë jete. Përmendim këtu ndërmjet të tjerash Stoikët, Platonin, Aristotelin, Epikurin dhe më vonë në kohët e reja Dekartin, Spinozën, Sartrin apo Rasellin. Por këta të fundit veçanërisht janë larg nxjerrjes së idesë se filozofia interesohet për problemet teorike. Mençuria (dituria), ose më saktë Sofia që mund të zotërojë filozofi është gjithashtu një dije dhe një njohje njëherazi.

Filozofi, në linjën e traditës të themeluar nga Sokrati, e di se si ai duhet të jetojë; ai mund të justifikojë zgjedhjet e tij dhe mënyrën e tij të jetesës. Një ndër tiparet e fuqishme të filozofisë perëndimore ka qënë integrimi i “filozofimit” me jetën e filozofit. Ky tipar i evidentuar që nga Sokrati do të pranohet e do të përhapet në gjithë perëndimin si një veçori thelbësore e filozofisë perëndimore. Soren Kierkegard ashtu si edhe Fridrih Niçe e përpunuan idenë se filozofimi si refleksion dhe njëheresh përgjigje ndaj sfidave të kohës duhet domosdoshmërisht të bashkëjetojë me gjendjen e brendshme të shpirtit të filozofit.

Ky tipar i filozofisë moderne në Perëndim e kishte bazën tek tradita filozofike e themeluar nga Sokrati. Kësisoj arsyetimi filozofik nuk mund të shihet i ndarë nga biografia e filozofëve prandaj dhe themi plot siguri se filozofët perëndimorë e kanë përjetuar filozofinë e tyre dhe filozofia e tyre ka dalë nga jeta që ata kanë bërë. Këtë veçori të filozofisë perëndimore e gjejmë të shtjelluar përgjithësisht në veprat e shumë filozofëve, ku produktet filozofike janë të pandara me jetën e filozofëve, këtyre heronjve të mendimit.

BIBLIOGRAFIA

- ARISTOTELI (2011) *Etika e Nikomakut*, (përktheu Albion Kolndreu), Kristalina-XP, Tiranë.
- BOR Jan, Petersma Errit, Kingma Jelle: *Histoire universelle de la Philosophie et des Philosophes*, Flammarion, Paris 1992, p. 26-44.
- GRIGORIU, Theodhor (2003) *Apologjia e Sokratit*, Bisedë para vdekjes, Kotti, Korçë, fq. 3-65.
- GRIGORIU, Theodhor (2003) *Kriton Sipas Platonit*, Kotti, Korçë, fq. 66-95.
- HERSH, Zhanë (1993) *Habia filozofike*, Dituria, Tiranë, fq. 16-32.
- JACOBY, Edmund (2001) *Filozofët. Filozofët më mëdhenj të kohërave*, Max, Tiranë, (përktheu Nasi Lera), fq. 22-27.
- PLATONI (1999) *Republika*, Phoenix, Tiranë, Libri i dytë, fq. 53-90 (përktheu Gjerg Zheji).
- PLATONI (2021) *Apologjia e Sokratit*. (Bisedë para vdekjes), fq. 3-63.
- SAMUEL E. Stumpf (2001) *Filozofia, historia dhe problemet*, Toena, Tiranë, fq. 28-43.
- TUQIDIDI (2002) *Epitafi i Perikliut*, Toena, Tiranë, (përktheu nga greqishtja Vangjel Dule).

Gjergj SINANI¹

Parësia E Të Drejtës – Një Dëshirë E Hershme E Njerëzimit
(*Refleksion mbi poemat e Hesiodit “Teogonia” dhe “Punët dhe Ditët”*)

Abstrakt

Objektivi im është të shpjegoj se në botën e miteve, të treguara nga Hesiodi, ekzistonte një rend normativ në kundërshtim me kaosin, anarkinë apo forcën brutale, ruajtja e të cilit nënkuptonte domosdoshmërisht legjitimitet politik, drejtësi, maturi dhe moderim. Për këtë arsye, këto mite përmbanin idetë themelore dhe përbërësit e koncepteve kryesore të epërsisë së ligjit, të cilat kanë karakterizuar traditën juridike dhe politike perëndimore që nga Platoni, qoftë në antikitet, në mesjetë dhe deri në bashkëkohësi. Pyetja e lashtë sesi mund të jetohej me dinjitet, i ka shtyrë filozofët t’u paraprijnë zgjidhjeve juridike, politike dhe shoqërore. Dëshira e njeriut, që në fëmëninë e vet, ka qenë sesi të ndërtohet shoqëria mbi bazën e drejtësisë, ashtu siç e gjejmë këtë dëshirë në poemën e Hesiodit “Teogonia”. Vepra poetike së bashku me “Iliadën” dhe “Odisenë” e Homerit janë konsideruar si krijimet më të hershme të shpirtit njerëzor. Mendoj se ky parashtrim do të tregonte, nga njëra anë, se origjina e parimit të shtetit të së drejtës i paraprin filozofisë greke dhe, nga ana tjetër, se kuptimi i saj mund të ishte shumë më i ndërlikuar nga ajo çfarë nënkuptojnë përgjithësisht juristët bashkëkohorë.

Fjalë kyçe: *mitet, Hesiodi, e drejta, legjitimitet politik, shteti, moderim, filozofi*

¹ Prof. Dr. Gjergj SINANI
Kolegji Universitar Bedër
Email: gjsinani@beder.edu.al

Pyetja që shtrojnë të gjitha gjeneratat njerëzore është: Si të jetoj në mënyrë dinjitoze? Nga përgjigjja që i kanë dhënë kësaj pyetjeje kanë rrjedhur edhe zgjidhjet juridike, politike dhe shoqërore. Dëshira e njeriut, që në fëmëminë e vet ka qenë sesi të ndërtohet shoqëria mbi bazën e drejtësisë. Si e gjejmë këtë dëshirë në poemën e Hesiodit “Teogonia”? Së bashku me “Iljadën” dhe “Odisenë” e Homerit ato vepra artistike janë konsideruar si krijimet më të hershme të shpirtit njerëzor.

Në traditën kushtetuese perëndimore, ideja e epërsisë së ligjit në ekzistencën dhe ruajtjen e një rendi normativ e merr burimin nga teoria politike e Tomas Hobsit. Në veprën e tij “Leviathan” (1651), ai argumentoi se siguria personale e jetës së tyre përbën interesin më themelor dhe se vetëm paqja, e vendosur brenda një rendi civil dhe e ruajtur nga autoriteti efektiv i pushtetit absolut, mund ta ruajë atë. Nga ana tjetër, nëse individët do të jetonin në gjendjen natyrore, do të ishte gjendja e luftës së të gjithëve kundër të gjithëve. Për këtë arsye, në gjendjen natyrore, individët, si qenie racionale, do të binin dakort ndërmjet tyre që t’i transferonin të gjitha pushtetet dhe liritë e tyre individuale te një sovran absolut, atë që Hobsi e quan shtet ose *Leviatan*, dhe t’i nënshtroheshin autoritetit të tij. Një marrëveshje e tillë përbënte një ‘kontratë’ domosdoshmërisht të detyrueshme, përndryshe individët do të qëndronin ose do të ktheheshin në gjendjen natyrore, domethënë në gjendjen e luftës.

Duhet të kthehemi shumë shekuj përpara Hobsit për të identifikuar origjinën e parimit të epërsisë së të drejtës që lidhet me ruajtjen e një rendi normativ. Autorët e vendosin origjinën e këtij parimi në shkrimet e Platonit dhe Aristotelit në shekullin IV (p. e. s.) si dhe në shkrimet e mëvonshme deri në vitin 49 (e. j.). Kjo vërtetohet edhe në shkrimet të cilat kanë formuar bazën e reflektimeve filozofike mbi përparësinë e të drejtës që nga mesjeta. Ato ishin pjesë e një konteksti, u krijuan si një alternativë racionale ndaj shpjegimeve mitike të botës, por disa nga postulatet dhe problemet e tyre erdhën drejtpërdrejt nga mitet greke. Filozofët parashtuan ekzistencën e një rendi objektiv dhe koherent në univers, ashtu si poetët para tyre. Ky postulat kishte udhëhequr kërkimin e ‘filozofëve të parë’ parasokratikë, si dhe atë të filozofëve të mëvonshëm nga Platoni te stoikët, siç ilustron në mënyrë madhështore në fragmentin e një prej dialogëve të Platonit të “Filebius”, mbi kënaqësinë dhe mirësinë:

SOKRATI - A duhet të themi, Protark, se një fuqi pa arsye, e pamatur dhe që vepron në mënyrë të rastësishme, qeveris të gjitha gjërat dhe atë që ne e quajmë univers? Apo përkundrazi, siç thanë ata që na paraprinë, se një inteligjencë, një urtësi e admirueshme formoi botën dhe e qeveris atë?

PROTARKU - Çfarë ndryshimi midis këtyre dy ndjenjave, Sokrat hyjnor! Nuk mund të mbështesim të parën pa kryer një krim. Nga ana tjetër, të thuash se inteligjenca qeveris gjithëka

është një ndjenjë e denjë për aspektin e këtij universi, për diellin, hënën, yjet dhe të gjitha lëvizjet qiellore. Nuk mund të flisja dhe as të mendoja në ndonjë mënyrë tjetër.

SOKRATI. - A doni, pra, që të pohojmë se është kështu dhe të bashkohemi me ata që kanë argumentuar të njëjtën gjë para nesh? Nëse po, atëherë a dëshironi që [ne] të marrim pjesë në të njëjtën përbuzje, kur një njeri i zgjuar pretendon se rrëmuja mbretëron në univers?

PROTARKU. - Pse nuk do ta dëshiroja këtë?

SOKRATI. - Kështu, [...] do të bënim më mirë të themi, duke ndjekur të njëjtat parime, se ka [...] në këtë univers shumë pafundësi dhe një sasi të mjaftueshme të fundme, mbi të cilën kryeson një shkak i respektueshëm, i cili rregullon dhe rendit vitet, stinët, muajt dhe që me shumë të drejtë meriton emrin e mençurisë dhe inteligjencës.

PROTARKU.- Me të drejtë, sigurisht.

SOKRATI. - Por nuk mund të ketë mençuri dhe inteligjencë atje ku nuk ka shpirt.

PROTARKU. - Jo, sigurisht.

SOKRATI. Kështu, ju do të thoni se ka në natyrën e Zeusit, si shkak, një shpirt mbretëror, një inteligjencë mbretërore dhe në perënditë e tjera, cilësi të tjera të bukura, pavarësisht nga emri me të cilin ai do t'i caktojë.

PROTARKU. Pa dyshim.

SOKRATI. - Mos beso, Protark, se e kemi bërë këtë fjalim kot: [...] mbështet në ndjenjën e atyre që dikur argumentonin se inteligjenca ende kryeson mbi këtë univers". (PLATO, 2018: 28, 29, 30)

Idenë e parimit hyjnor (*logos*) që qeveris botën, të cilin do ta zhvillojë filozofia dhe monoteizmi më vonë, e gjejmë në filozofinë e Platonit.

Dy fjalë për mitin

Fjalë për fjalë "mit" (greqisht *mythos*) do të thotë "diçka që thotë dikush". Poetët rrëfenin jetën e perëndive dhe heronjve të të kaluarës, ndërsa grekëve u siguronin një matricë të përbashkët, nga e cila ata iu përgjigjën pyetjeve të mëdha ekzistenciale. Rreth shekullit VIII (p. e. s.), poetët mbështetën mitet themeluese të qytetërimit grek. Grekët në përgjithësi i konsideronin ata si autorët më të vjetër të ideve 'parafilozofike' të botës. Herodoti, për shembull, i cili jetoi në shekullin V (p. e. s.) shkroi:

"Unë në fakt mendoj se Homeri dhe Hesiodi jetuan vetëm katërqind vjet para meje. Tani ishin ata të parët që përshkruanin teogoninë në vargje, folën për pseudonimet e perëndive, adhurimin e tyre, funksionet e tyre dhe që gjurmuan figurat e tyre. Poetët e tjerë, që thuhet se u kanë paraprirë, erdhën, të paktën për mendimin tim, vetëm pas tyre." (HERODOTE, 1963-1970: 53)

Hesiodi lindi në shekullin VIII (p. e. s.) në Askra, Boeti, rrëzë malit Helikon. Ai ishte nga origjina ndoshta fshatar, megjithëse poezia e tij duket të jetë ajo e një aristokrati. Atij i atribuohen disa vepra, duke përfshirë ato më kryesoret: "Teogonia" dhe "Punët dhe Ditët". *Teogonia* është një poemë e gjatë, e cila vendosi rregull në mitet e ndryshme në lidhje me

perënditë, në mënyrë që njerëzit të kuptojnë vendin e tyre në univers dhe vlerat që duhet të udhëheqin jetën e tyre, shpjegoi rendin e botës me lindjen e perëndive, legjitimitetin politik dhe drejtësinë. Fjala ‘teogoni’ do të thotë "krijim i perëndive" (*theo* do të thotë "zot" dhe *goni* "krijim" ose "prodhim"). *Punët dhe ditët* është një krijim që vlerëson drejtësinë dhe punën për t'i dhënë fund mjerimit njerëzor, ndërsa jep këshilla morale të vlefshme si për mbretërit, aq edhe për fshatarët më modestë. Në këtë poemë ai pohoi që do të drejtohej me filozofinë e së drejtës: "Drejtësia është më e çmuara nga të gjitha të mirat".

Funksionet e miteve greke

Mitet greke kishin funksione të rëndësishme, ato iu përgjigjën disa pyetjeve të mëdha ekzistenciale: Si u bë bota kjo që është? Cila është struktura e universit? A është jeta e organizuar? Cili është burimi i vlerave? A kemi një fat? Dhe kështu me radhë. Mitet nuk deklaruan një teori racionale të universit: ato nuk ishin një "kozologji". Ato propozuan një "kozogoni" (greqisht *kozmos* "botë" ose "univers" dhe *gonie*, që do të thotë "krijim" ose "prodhim"). Shpjeguan krijimin e universit përmes tregimeve jo filozofike. Mitet iu transmetuan grekëve një bagazh rimesh fetare, kujtime, vlera dhe ideale që i jepnin kuptim fesë së tyre, historisë dhe jetës së tyre. Ato përbënin themelin e asaj që grekët e quanin *paideia*, domethënë kultura e bazuar në vlerat e përbashkëta të transmetuara përmes edukimit. Mitet nuk formuan teori racionale, fetare, historike dhe etike; ato ofruan modele sjelljeje që formuan kode morale. Qytetet kishin mitet e tyre themeluese. Qyteti i Athinës e lidhi identitetin e tij me perëndeshën Athina, kurse themelimin e tij me heroin Tezeu, i cili ishte një nga mbretërit e parë të Athinës dhe besohej se rridhte nga një perëndi. Origjina e tij lidhej me mitin e “autoktonisë”, që tregon se njerëzit kanë lindur direkt nga toka. Ishte e njëjta gjë për shumicën e familjeve aristokrate të lidhura me politikën e qytetit: ata i lidhnin paraardhësit e tyre me perëndi ose heronj historikë, gjë që u dha atyre prestigj dhe legjitimitet politik.

Priremi t'i konceptojmë mitet si fraksione, diskurse simbolike ose koncepte të thjeshtuara të botës, të papajtueshme me të vërtetën shkencore. Për grekët, mitet e përshkruanin realitetin ashtu siç ishte, pavarësisht nëse ishte bota natyrore apo e kaluara e tyre, prandaj poemat nuk ishin thjesht “krijime” letrare. Poetët nuk ishin “artistë”, ata ishin mbartës të dijes për shkak të frymëzimit hyjnor. Njohuritë e tyre u “vinin” nga muzat (greqisht: *mousai*), kurse poetët ua transmetonin drejtpërdrejt dëgjuesve të tyre. Prandaj poezitë shpesh hapeshin me një thirrje për muzat, të cilat ishin nëntë vajzat e Zeusit dhe perëndeshës Mnemosine, që personifikonin kujtesën dhe ishin hyjni kolektive. Meqenëse Zeusi ishte i ati, dijet e tyre kishin autoritet

hyjnor, që vërtetonte fjalët e poetëve dhe u jepte shpesh atyre autoritet më të lartë, madje edhe nga ai i mbretërve. Nëntë muzat jetonin në male: në malin Parnas (afër Delfit) dhe në malin Helikon (në Boetia) në një vend të shenjtë të quajtur "Muséion". Këndonin bukur, kërcenin të gëzuara dhe muzika e tyre ishte joshëse, sidomos në festivalet në malin Olimp, siç shihet te vargjet e "Teogonisë":

“Le ta fillojmë këngën tonë përmes muzave, banorë të Helikonit të lartë e hyjnor, të cilat pranë një shatërvani të zi, përpara altarit të të fuqishmit [Zeusit], udhëheqin valle drite; të cilat, pasi lajnë trupat e tyre të bukur në ujërat e [tre lumenjve të malit Helikon], kurorëzojnë me kore të hijshme, magjepsëse, majat e malit të shenjtë dhe i shkelin nën këmbët e tyre të shkathëta. Prej andej zbresin, kur natën, në një re, shkojnë të bredhin tokën, duke bërë që zëri i tyre harmonik të kumbojë larg. [...]” (HÉSIODE, 1981: 53)

Zeusi, për nëntë net, kishte vizituar nënën e tyre [*Mnemosine*], duke u ngjitur, larg vështrimit të të pavdekshmëve, në shtratin e saj të shenjtë. Kur viti iu afrua fundit, kur u plotësuan muajt, kur erdhën ditët e shënuara, ajo lindi virgjëreshat, të cilat i njëjti shpirt i gjallëron, jetojnë pa kujdes tjetër veçse të këndojnë. Nuk ishte shumë larg majës dhe borës së Olimp, ku janë pallatet e shkëlqyera, teatri i lojërave të tyre, ku pranë tyre kanë vendbanimin Hiret dhe Dëshirat. Atje, në gëzimin e festave, zëri i tyre magjepsës këndon ligjet e universit dhe jetën hyjnore të të pavdekshmëve. Nga këto vende ato ngrihen në majën e Olimp me zërat e tyre melodioze dhe këngët e tyre qiellore. Rreth e rrotull përsërisin jehonat e dheut të zi dhe nën hapat e tyre ritmike lind një harmoni e këndshme, ndërsa ato përparojnë drejt babait.

Kur muzat bashkonin zërat e tyre, ato mund të thoshin "çfarë është, çfarë ishte dhe çfarë do të jetë nga zërat e tyre në unison." (HÉSIODE, 1981: 55) Prandaj poetët që ato frymëzuan folën të vërtetën. Në *Teogoni*, Hesiodi pohon se një ditë, ndërsa ruante qengjat e tij, muzat i mësuan të vërtetat në lidhje me origjinën dhe jetën e perëndive të pavdekshme dhe i frymëzuan një gjuhë hyjnore në mënyrë që ai të mund t'ua këndonte njerëzve të tjerë. Ai shtoi se muzat i kishin dhënë një skeptër (një degë ulliri), duke zyrtarizuar kështu autoritetin hyjnor të fjalës së tij. Prandaj të ngjashmit e tij, pastorët e trashë dhe të poshtë, ishin të detyruar ta besonin atë. [Muzat] ia mësuan këngët e tyre të bukura Hesiodit, ndërsa ai kulloste kopenë e tij në këmbët e Helikonit hyjnor; 'kështu më folën këto muza të Olimp, këto bija të Zeusit:

“Barinj që flemë në fusha, racë e vrazhdë e brutale, nuk dimë të tregojmë histori të rreme që i ngjajnë të vërtetës; ne gjithashtu mund të tregojmë histori të vërteta rreth tyre, kur të kemi dëshirë.” (HÉSIODE, 1981: 55)

dhe më vendosën në duart e mia një skeptër (HÉSIODE, 1981: 157; Shënim) të mrekullueshëm, një degë ulliri të gjelbëruar. Ato më pëshpëritën për të shpallur atë që duhet të jetë, çfarë ishte

dhe më urdhëruan të kremtojnë racën e të pavdekshmëve'. Ky funksion i poetit u përshkrua nga Homeri në një skenë nga *Odisea*.

Skena zhvillohet në një banket ku merr pjesë Uliksi i panjohur. Poeti Demodocos rrëfen episodin e famshëm të kalit të Trojës, që u dha fitoren akejve [grekët] gjatë Luftës së Trojës, nxitësi i së cilës kishte qenë Uliksi. Demodocos është i verbër dhe përshkruhet si "kantori melodioz i nderuar nga njerëzit", ai "i dashur nga një muzë". Ajo, shkruan Homeri, e kishte privuar nga drita, por i kishte dhënë "zërin më melodioz". Forca e një "poeti të verbër", sipas traditës, qëndronte në dritat e tij të brendshme: ai mund t'i shihte gjërat drejtpërdrejt ashtu siç ia pëshpëritnin muzat. Ja pse zëri i poetëve dhe i muzave ishte kaq i bukur, kaq simpatik, kaq melodioz, kaq i këndshëm dhe kaq i ëmbël; ajo tha gjëra të vërteta. Kështu ishte edhe me mbretërit që ndiqnin drejtësinë. Muzat derdhën "verë të ëmbël" në gjuhën dhe fjalimet e tyre si mjaltë. Konfliktet u zgjidhën me mençuri dhe palët pranuan vendimet e tyre.

Le të dëgjojmë Hesiodin në "Teogoni":

"Le të fillojmë me muzat, të cilat në Olimp magjepsin inteligjencën sublime të babait të tyre, kur bashkojnë zërat, flasin për të tashmen, të ardhmen dhe të shkuarën. Nga buzët e tyre rrjedhin me ëmbëlsi të pafundme këngë të pashtershme: kënaqen me pallatin e Zeusit, mjeshtrit të vetëtimës, ku përhapen me thekse harmonike dhe rrezojnë në majat me dëborë të Olimp, në shtëpinë e të pavdekshmëve. [...] Sepse nëse ka mbretër, mbretër plot urtësi, kjo është kështu që, për njerëzit të cilët ne kerkojmë t'i dëmtojmë, në një vend publik, ata përfundimisht do t'i kthejnë këto akte kundër autorëve të tyre dhe kjo pa vështirësi, duke fituar zemrat me fjalë pa ashpërsi. Njerëzit e shikojnë atë kur ai vendos drejtësinë me drejtësi. Ai flet me autoritet dhe para fjalimeve të tij bie menjëherë përçarja më e mprehtë. Sepse këtu tregohet mençuria e një mbreti: popujve të shtypur, gjykimet e tij të dhëna në sheshin publik sigurojnë dëmshpërblime të drejta dhe njerëzit lehtë dorëzohen para fjalëve të tij bindëse. Ndërsa ecën nëpër qytet, ai adhurohet si një zot, me respekt dhe dashuri; ai shfaqet i pari në mes të turmës që e rrethon. [...] Lum ai i vdekshëm i dashur nga Muzat! Një zë i ëmbël i rrjedh nga goja." (HÉSIODE, 1981: 61)

Prandaj bukuria e eposit grek qëndronte në forcën evokuese të fjalëve të afta për të treguar drejtpërdrejt realitetin e gjërave. Kuptimit, saktësimin të fjalëve Platoni do t'i kushtonte një nga dialogët e tij të famshëm, *Kratilin*, që konsiderohet si pararendës i filozofisë së gjuhës.

Mitet dhe feja

Mitet ishin një aspekt qëndror i fesë greke, ndonëse nocioni i hyjnore ishte shumë i ndryshëm nga i hebrenjve, krishterëve apo islamëve, sepse grekët nuk kishin tekste të shenjta të ngjashme me *Torën*, *Biblën* apo *Kuranin*. Poezia e Homerit dhe Hesiodit ishin gjëja më e afërt me ta, por ato nuk parashtronin asnjë besim apo doktrinë zyrtare. Nuk kishte klerikë profesionistë që shërbenin si rabinë, priftërinj apo imamë; feja greke ishte politeiste dhe jo monoteiste.

Perënditë greke nuk ishin të përjetshëm, patën një lindje dhe ishin të pavdekshëm. Gjithashtu, ndryshe nga Zoti i feve monoteiste, perënditë greke nuk ishin të gjithëfuqishëm: ato mund të humbnin betejat, të burgoseshin përgjithmonë apo të mashtroheshin nga perënditë e tjera. Zeusi ishte perëndia që i ngjante më shumë një qenieje supreme, por ai nuk ishte as i gjithëfuqishëm dhe as i gjithëdijshëm. Së fundi, ndryshe nga Zoti i feve monoteiste, perënditë greke nuk kërkuan nga njerëzit që të adhuroheshin ose të nderoheshin ekskluzivisht. Për më tepër, perënditë greke u ngjanin njerëzve, debatonin, bënë bankete, luftonin për prestigj dhe pushtet, kishin marrëdhënie seksuale të të gjitha llojeve dhe manipulonin qeniet njerëzore. Ato mund të qenë mizorë, të vegjël, të zemëruar dhe xhelozë. Struktura e tyre shoqërore korrespondonte me atë të njerëzve: familja e tyre ishte patriarkale dhe shoqëria e tyre aristokratike. Të gjitha perënditë ishin të afërm ndërmjet tyre dhe Zeusi ishte zotëria i tyre; ai ishte "babai i perëndive", duke mishëruar fuqinë e babait në klane. Kryesonte këshillat e perëndive ashtu si një mbret këshillin e tij dhe kërkonte që vendimet të respektoheshin rreptësisht. Zotat dalloheshin nga njerëzit për bukurinë, fuqinë mbinjerëzore, pavdekësinë dhe rininë e tyre të përjetshme, të garantuar nga ajo që hanin dhe pinin: "ambrosia" dhe "nektari". Fuqia e tyre mbinjerëzore tregonte se ato zinin një vend më të lartë se njerëzit në univers, ndonëse jetonin mes njerëzve. Kësisoj perënditë olimpike jetonin në malin Olimp. Tempujt grekë, si Partenoni në Athinë, ishin vende ku perënditë mund të banonin vërtet. Kjo është arsyeja pse, ndryshe nga fetë monoteiste, grekët nuk mblidheshin brenda tempujve. Për më tepër, perënditë ndërhynin drejtpërdrejt në jetën e njerëzve, herë duke marrë formën dhe fytyrën e duhur njerëzore, herë duke mishëruar forcat e natyrës. Ata i këshillonin, ndonjëherë i udhëhiqnin përkundër vetes, shpesh i ndëshkonin dhe madje bënë marrëdhënie seksuale me ta. Me kohë perënditë u tërhoqën në malin Olimp dhe ndërhynin vetëm nëpërmjet orakujve, ëndrrave ose shenjave të tjera të veçanta, si fluturimi i zogjve ose të brendshmet e kafshëve.

Origjina e botës: kaos, anarki dhe beteja të pandërprera

Mitet greke janë shumë të ndryshme nga historitë abrahimike. Ato e shpjegojnë origjinën e botës me një "teogoni", domethënë me lindjen e perëndive. Çdo fazë e procesit karakterizohet nga dhuna e paprecedentë, përfshirë kanibalizmin, hakmarrjen e shfrenuar, luftën dhe shkatërrimin. Bota përfundimisht do të vijë në rregull, por jo përpara se Zeusi të mund të imponojë autoritetin e tij përmes forcës, legjitimitetit politik dhe drejtësisë. *Teogonia* është si mit fetar, ashtu edhe një poezi për paqen, rendin dhe qeverisjen e mirë. Është ndoshta burimi më i vjetër i shkruar i ideve dhe idealeve, që qëndrojnë në themel të shtetit të të drejtës. Ajo që

mund të duket si një histori fantastike, anekdotike, e parëndësishme, e thatë apo edhe e mërzitshme, befas bëhet plot kuptim. Miti na mëson gjëra për veten me kusht që të shijojmë fuqinë e tij poetike.

Kjo është intriguese. Pse kaosi lidhej me anarkinë, dhunën apo luftën, etj., dhe jo me hyjnitë paqësore apo të dëshirueshme? Hesiodi nuk e thotë këtë. *Kaos* fjalë për fjalë do të thotë një çarje e hapur dhe në përgjithësi kështu kuptohet. Ky konceptim na lejon të kuptojmë pse hyjnitë që lindën nga Kaosi personifikuan anarkinë, dhunën dhe mjerimin në një formë ose në një tjetër. Imazhi ishte i fortë. Aty ku ka kaos në një shoqëri, aty kemi beteja të pandërprera midis klaneve dhe klasave shoqërore. Poeti Ovid e jep origjinën e botës:

“Para formimit të detit, tokës dhe të qiellit që e mbështjell, natyra në Univers ofronte vetëm një aspekt; quhej kaos, një masë stërmadhe, pa formë, që kishte vetëm peshë, pa veprim dhe pa jetë, përzjerje konfuze elementesh që luftonin ndërmjet tyre. Asnjë diell nuk e lëshonte ende dritën e saj në botë; hëna nuk e bënte aspak të shkëlqente harkun e saj të argjëndtë; toka nuk ishte e varur, e balancuar përmes peshave të saj, në mes të ajrit; oqeani, pa brigje, nuk i kapte gjiret e gjëra të globit. Ajri, toka dhe ujërat ishin të përziera: toka pa fortësi, valët jo fluide, ajri i privuar nga drita. Elementet ishin armiq; asnjë prej tyre nuk kishte formën aktuale. Në të njëjtin trup, të ftohtit luftonte të ngrohtit, thatësira sulmonte lagështirën; trupat e fortë dhe ata që ishin pa rezistencë, trupat më të rëndë dhe trupat më të lehtë ndesheshin ndërmjet tyre pa rreshtur, të kundërt dhe kundërshtarë.” (OVIDE, 2007: 8)

Pastaj erdhi *Gaia* (Toka), e cila lindi atëherë pa e ditur ne me të vërtetë sesi. Ajo është hyjnia e parë e individualizuar. Gaia është jashtëzakonisht e rëndësishme në *Teogoni*: ajo është edhe "toka" dhe e para nga të gjitha "nënat". Ajo është burimi i botës fizike në atë që krijoi disa hyjni që përbëjnë universin. Për më tepër, Gaia "me gjirin e saj të gjerë" është një "mbështetje e të gjitha gjërave", domethënë një ndenjese e fortë, ku të gjithë mund të mbështeten. Do të luajë një rol qëndror në zgjedhjen e zotave të universit, qofshin Kronosi apo Zeusi. Pastaj vjen Tartari (Errësirë), që është pjesa më e thellë e nëntokës, vendosur “në thellësitë e tokës së gjerë”. Tartari, thotë Hesiodi, është aq larg nëntokë sa toka është larg qiellit, "sepse e njëjta hapësirë që ndan qiellin nga toka ndan edhe tokën nga Tartari." (HÉSIODE, 1981: 127) Tartari është vendi më i tmerrshëm nga të gjitha vendet, një humnerë e madhe, e thellë, e tmerrshme, e errët, e lagësht, e ndyrë, e shkretë dhe e vendosur në skajet e botës. Të gjithë kanë frikë nga Tartari, përfshirë perënditë. Më mirë të mos kaloje atje. Dhe më në fund Erosi (Dashuria), më i bukuri i perëndive. Ai personifikoi forcën e tërheqjes midis gjërave që bëri të mundur krijimin e gjërave të reja, dëshirën seksuale që lejonte perënditë, heronjtë dhe njerëzit të përjetësonin veten. Ai thyen dhe zbut të gjitha qeniet, zbut zemrat e secilit dhe triumfon mbi urtësinë dhe vullnetin e tyre! Megjithatë, Erosi nuk do të ketë pasardhës.

Lindja dhe fëmijëria e Zeusit. Kronosi u martua me një nga motrat e tij, Rhea. Nga bashkimi incestues, lindën gjashtë "zota të mëdha", tri perëndeshat: Hera, Demetra dhe Hestia dhe tri perëndi të mëdha: Poseidoni, Hades dhe Zeusi. Hyjnitë banonin në malin Olimp dhe formonin brezin e parë të dymbëdhjetë "olimpëve": Athinaja, Apolloni, Artemida, Hermesi, Aresi, Hefesti dhe Dionisi, që qëndronin atje.

Betimi fillestar. Në fillim të konfliktit, Zeusi u premtoi perëndive që do të pranonin të luftonin përkrah tij se kurrë nuk do t'ua hate gradën, nderet dhe privilegjet e tyre. U premtoi grada me të cilat nuk i kishte nderuar Kronosi dhe që do t'u kthente nderimet dhe shpërblimet në përputhje me drejtësinë. Prandaj, Zeusi u angazhua paraprakisht për të promovuar drejtësinë dhe për të ruajtur një rend të caktuar: nën mbretërimin e tij, perënditë do të gëzonin statusin dhe titujt që me të drejtë u përkisnin. Ky betim fillestar do të jetë themelor në ardhjen e mbretërimit të Zeusit, siç do të shohim më poshtë. Ditën kur, në majat e Olimp, Zoti i Olimp, perëndia e vetëtimave flakëruese, thirri të gjithë të pavdekshmit, ai tha:

“Ai që vjen të luftojë me mua kundër Titanëve, nuk do të humbasë asgjë nga atributet e tij hyjnore; të gjithë do të ruajnë nderimet që gëzonin më parë midis perëndive dhe nëse dikush, gjatë mbretërimit të Kronit, nuk kishte marrë as nder e as shpërblim, ai do t'i marrë të dyja siç kërkon zakoni i drejtë.” (HÉSIODE, 1981: 93)

Hyjnia e parë që u bashkua me të në malin Olimp ishte Styx, që personifikon një lumë, si motrat e veta. Ndoshta për shkak të mbështetjes së saj të hershme, ajo ishte më e respektuara: "nimfa Styx [është] e para ndër të gjitha motrat e saj". Styx solli katër fëmijët në Olimp: Zélos ("Zelli" ose "Ardor"), Nikè ("Fitorja"), Kratos ("Fuqia" ose "Sovraniteti") dhe Biè ("forca"). Ky tubim ishte jashtëzakonisht domethënës. Nga njëra anë, ajo donte që fëmijët e saj të bëheshin të pandarë nga Zeusi, të jetonin gjithmonë me të dhe ta ndiqnin kudo që ai shkonte. Nga ana tjetër, Zeusi nuk mund të vendoste një mbretërim të drejtë dhe të rregullt pa zell, forcë, fuqi dhe fitore.

“Kështu ai pranoi kërkesën e Styx-it. Pastaj erdhi e para në Olimp, me këshillën e babait të saj, nimfa e pavdekshme Styx me fëmijët e saj të jashtëzakonshëm [...] Zélos ("Zelli") dhe Nike ("Fitorja"), Kratos ("Fuqia") dhe Biè ("Forca") [...] Nuk janë larg nga Zeusi në janë pallatet dhe fronet e tyre; rrinë gjithmonë pranë tij, kudo ecin në vazhden e zotit që bën bubullima të gjëmojnë. Kështu u përmbush këshilla e kujdesshme e Styx-it, Oqeanidi i pavdekshëm.” (HÉSIODE, 1981: 91-93)

Festa e fundit. Lufta ishte e gjatë, rraskapitëse. Pas dhjetë vjet betejash në fund të të cilave asnjë palë nuk dukej në gjendje të fitonte, Zeusi organizoi një festë gjatë së cilës ai ofroi nektar dhe *ambrozi* për të gjithë aleatët e tij. Në fund mbajti një fjalim, i cili tregoi se Zeusi e imponoi autoritetin e tij jo me forcë si Kronos, por me fjalë plot urtësi dhe mirënjohje.

Mbretërimi i Zeusit. Zeusi nga ana e vet u bë "zot i universit", fuqia e tij ishte absolute: vajzat e Styx, Zeal (Zelos), Fuqia (Kratos), Forca (Biè) dhe Fitorja (Nikè) e shoqëronin kudo. Por cili do të jetë mbretërimi i tij? Një manifestim i ri i ligjit të më të fortëve apo një qeveri legjitime? Një tirani apo një mbretërim drejtësie? Një pushtet i ushtruar në mënyrë arbitrare apo në përputhje me një rend të vendosur? Ndryshe nga mbretërimi i Kronosit, fuqia e Zeusit ishte legjitime, përgjithësisht e drejtë dhe e rregullt. Mbretërimi i Zeusit do të shënonte kulturën politike të qytetërimit perëndimor. Legjitimiteti politik, a nuk nënkupton elementet e mësipërme? Mbretërimi i Zeusit u imponua pas betejave me anë të një "pëlqimi", "marrëveshjeje" ose "kontrate" unanime midis të gjithë perëndive. Ishin vetë perënditë që i kërkuan Zeusit të qeverisë, prandaj e sollën në pushtet. Nga ky këndvështrim, Zeusi nuk ishte uzurpator, por autoriteti i bazohej në një formë të pëlqimit unanim dhe jo në forcë. Prandaj mund të qeveriste botën fizike dhe realitetin moral, shoqërinë e perëndive dhe atë të njerëzve, me legjitimitet të plotë. Kur perënditë mbaruan punën e tyre dhe pushtuan nderet e parajsës nga Titanët, ato sollën, me këshillën e Gaia, në komandën e perandorisë së të pavdekshmëve, Zeusin, shikimi i të cilit përqafoi gjithçka që ekziston. Këtu shihen rrënjët e parimit, sipas të cilit legjitimiteti politik duhet të mbështetet në pëlqimin e të qeverisurve. Por mund të pyesim veten për çfarë arsye perënditë ranë dakord t'i jepnin Zeusit të drejtën për t'i komanduar ata? A kishin ndonjë arsye? Përgjigja është po. Para së gjithash, Zeusi ishte më i zgjuari dhe më i mençuri, ndoshta edhe më i forti. Siç shkroi Hesiodi, vështrimi i tij "përqafoi gjithçka që ekziston": ai kishte një "vizion" superior të gjërave në botë dhe kjo e justifikonte dhënien e magjistraturës supreme. Por kjo nuk është e gjitha: ka qenë edhe betimi fillestar. Zeusi, kujtojmë, kishte fituar besnikërinë e perëndive të tjera pasi u angazhua të respektonte gradën dhe nderet e secilit në rast fitoreje. Megjithatë, vlera e betimit fillestar qëndronte sa në formën ashtu edhe në përmbajtjen e tij. Nga pikëpamja formale, meqenëse Zeusi ishte zotuar të vepronte në një mënyrë të caktuar pas fitores, perënditë e tjera i dinin paraprakisht pasojat e angazhimit të tyre. Betimi përbënte një mburojë kundër arbitraritetit dhe bëri të mundur parashikimin e natyrës së vendimeve që do të merrte Zeusi. Nga pikëpamja thelbësore, duke qenë se Zeusi kishte marrë përsipër të respektonte dhe rivendoste gradat, nderimet dhe privilegjet që ishin në të drejtën të tyre, ky betim bazohej në drejtësinë. Prandaj, a nuk ishte e arsyeshme të pranohet që ai të ishte zotëruesi i universit?

Drejtësia. Zeusi e ndau botën dhe shpërndau nderet, gradat, fuqinë dhe privilegjet midis të gjitha perëndive në përputhje me drejtësinë, i përmbushi premtimet e tij ndaj të gjithëve, duke e veshur veten me fuqi të pakufishme dhe një perandori sovrane. Ai rregullonte në mënyrë të

pavarur gradat dhe nderet e të pavdekshmëve, ndante nderet hyjnore mes tyre. Zeusi përmbushi premtimet e tij ndaj perëndive të tjera. Meqenëse Styx, që ishte një lumë, mbërriti i pari në Olimp, u nderua në përputhje me rrethanat. Zeusi i dha dhurata të çmuara dhe e siguroi se fëmijët e saj do të jetonin përgjithmonë me të. Në veçanti, Zeusi e nderoi atë me privilegjin më të lavdishëm: "betimin e madh të perëndive". (HÉSIODE, 1981: 93, 133, 135) Sipas Hesiodit, Zeusi donte që "betimi për ujërat e tij të ishte për perënditë betimi më i frikshëm". Prandaj, betimi i madh i perëndive ishte uji i Stiksit. Ky ujë bëri të mundur zbulimin e perëndive që gënjen veten ose nuk respektuan premtimet e tyre. Ajo ishte tmerri i perëndive, sepse nëse një zotë derdhte ujë në tokë për të mbështetur një betim të rremë, ajo meritonte dënimin: ai ndaloi frymën dhe u privua nga nektari dhe ambrosia për një vit, në fund të të cilit u ndoq nga Olimpi për nëntë vjet. Por pse Styx duhej të ishte betimi i madh i perëndive? Këtu është arsyeja, Styx nuk ishte thjesht një lumë, ishte lumi i ferrit. Ajo kishte një karakteristikë të veçantë: rryma kthehej në vetvete, prandaj nuk kishte asnjë mënyrë për t'i shpëtuar, përveçse me çmimin e një dënimi shumë të rëndë. [Në nëntokë] banon një hyjni e urryer për të pavdekshmit; është nimfa e frikshme Styx, vajza e madhe e Oqeanit, rryma e të cilit kthehet në vetvete. Ajo qëndron atje, larg perëndive, në një pallat të mrekullueshëm, prej të cilit shkëmbinj të lartë formojnë majën dhe që ngrehin kolona argjendi drejt qiellit. Ndonjëherë vajza e Thaumasi (Çudi), Irisa e shpejtë (Ylberi), arrin në këto vende, pasi ka krehur në rrjedhën e saj pjesën e pasme të fushës së lëngshme, e ngarkuar me një mesazh nga Zeusi. E tillë është fuqia e dhënë nga perënditë për këtë zotim të betimit të tyre, për këto ujëra të lashta dhe të pashtershme të Stiksit, që vërtitet nëpër një vend të ashpër. Stiksi shprehu rëndësinë e respektimit të betimeve dhe të të folurit të së vërtetës. Ndoshta ishte i vetmi kufizim "moral" i aftë për të lidhur perënditë. Një rrymë që kthehet në vetvete ilustron forcën e një angazhimi të njëanshëm nga i cili nuk mund të çlirohemi pa kosto. Fakti që ajo ishte hyjnia e parë që iu bashkua Zeusit, ndoshta shprehte edhe forcën e detyrueshme të betimit fillestar, domethënë përkushtimin e saj për të vepruar në përputhje me drejtësinë. (HÉSIODE, 1981: 131-135)

Hekati dhe gjërat njerëzore

Zeusi i bëri lavde Hekatës (GRANT & HAZEL, 1975: 166-167), pasardhëse e titanëve, të cilën tashmë të gjithë perënditë e respektonin. I la asaj të gjitha privilegjet dhe nderimet e mëparshme, i dha një pjesë në pushtetin mbi tokë dhe det, kurse fuqitë e saj mbi gjërat njerëzore ishin shumë të gjera: politike, juridike, ekonomike, fetare, familjare, etj. Njerëzve që ofronin një sakrificë shlyese sipas riteve të shenjta, ajo mund t'u jepte pasuri dhe madhësi. Ajo, siç dëshiron, mund t'u japë ndihmën e saj të fuqishme njerëzve: sipas gjykimit të saj, ajo u jep

atyre perandori në kuvendet e popujve; kur ata nxitojnë në mes të përlëshjes vrastare, ajo është aty, e cila u shpërndan fitoren dhe famën si të dojë. Në gjykime, ajo ulet pranë mbretërve, në gjykimet e tyre. Është ajo që kryeson lojërat e atletëve dhe i vdekshmi që ajo favorizon, fitues ndaj rivalëve të tij me forcë dhe guxim, fiton lehtësisht çmimin e betejës dhe, me një zemër plot gëzim, kurorëzon ata me lavdinë e saj. Ajo kryeson garat me qerre, drejton marinarët në det të stuhishëm dhe ata e thërrasin si perëndinë që tund tokën me zhurmë të madhe. Ajo, me dëshirën e saj, mund t'i dërgojë gjahtarit një pre të pasur ose t'ia vjedhë atë. Është ajo që në stalla kryeson, me Hermesin, mbi mbarësinë e tufave; nga ajo, me vullnetin e saj, shumëzohen ose vdesin qetë, dhitë dhe dhëntë. Kështu, edhe pse e vetme nga raca e saj, ndonëse fryti i vetëm i dashurive të nënës, ajo ndan të gjitha nderimet e perëndive. Biri i Kronosit i besoi asaj edhe kujdesin në vitet e para të të gjithë njerëzve, që pas saj do të hapnin sytë në dritën e Agimit verbues. Në fillim ajo duhet të ketë qenë infermierja dhe nëna e tyre. Këto funksione të lavdishme iu ngarkuan asaj.

Rendi botëror. Ndarja dhe shpërndarja e niveleve dhe nderimeve rregulloi botën. Që tani e tutje, secila qenie kishte një vend të veçantë në botë dhe secila mund të ushtronte fuqitë dhe privilegjet sipas vendit të tyre të merituar. Kjo prodhoi një rend harmonik, një rend që filozofët grekë më vonë do ta quanin *kozmos*. Kjo fjalë vjen nga greqishtja *kosmos*, që do të thotë "botë e rregulluar" ose "univers". Hesiodi nuk e kishte përdorur vetë. Përdorimi i fjalës *kosmos* për të përcaktuar një univers të rregulluar shfaqet për herë të parë në shkrimet e parasokratikëve (shek. VII-V p.e.s.), por mund ta përdorim për të përshkruar rendin botëror të vendosur nga Zeusi. Si do të realizohej stabiliteti i mbretërimit të Zeusit? Fakti i thjeshtë i vendosjes së rendit në botë, megjithatë, nuk garantonte stabilitetin e saj, sepse ai mund të kërcënohej vazhdimisht nga ajo që grekët e quanin *hubris*, përkthehet si "tepricë". Ndjenja e teprimit është ajo që i shtyn perënditë dhe njerëzit të shkelin rregullat që kufizojnë fuqitë ose privilegjet që u janë caktuar. Me fjalë të tjera, mendjemadhësia është ajo që i shtyn perënditë dhe njerëzit të duan më shumë sesa pjesa e tyre e drejtë. Ajo i bën ata të besojnë se mund të ngrihen mbi gjendjen e tyre dhe, në rastin e njerëzve, mbi perënditë. Në përgjithësi shkaktohet nga krenaria, arroganca, etja e pashtershme për sukses, pasuri apo pushtet. Sipas Hesiodit, mendjemadhësia ishte shkaku themelor i kaosit, prandaj rendi kozmik nuk siguronte që të mos kishte më kurrë luftë, dhunë, rivalitete apo luftëra për pushtet. Titanët mund të dalin nga ferri i tyre, perënditë mund të duan më shumë se sa u takon dhe njerëzit mund të thyejnë ligjet. Vetë Zeusi mund të tregonte teprim ndaj perëndive dhe njerëzve të tjerë. Te *Punët dhe Ditët*, Hesiodi i kërkon Zeusit t'i përputhë gjykimet e njerëzve me atë të drejtësisë (Diké). Zeusi mundi të ruante rendin

kozmetik dhe stabilitetin me anë dy grave të tij *Metis* dhe *Themis*. Metis nënkupton urtësi dhe maturi hyjnore. Ajo personifikoi mençurinë dhe inteligjencën praktike (arsyen praktike do të thoshte Kanti), si dhe maturinë dhe moderimin. Ishte në gjendje të dallonte të drejtën nga e gabuara dhe të vepronte në përputhje me rrethanat. Martesa e parë e Zeusit vulosi bashkimin midis fuqisë hyjnore, mençurisë praktike dhe maturisë.

Megjithatë, Gaia dhe Ouranos e kishin informuar Zeusin se një nga fëmijët e tij mund të ishte mjaft i fortë për ta rrëzuar atë. Prandaj, në një lëvizje që të kujton kanibalizmin e babait të tij Kronos, Zeusi vendosi të gëlltiste Metisin ndërsa ajo ishte shtatzënë duke përdorur mashtrime (duke "mashtuar zemrën e saj me fjalë të ëmbla"). Kështu, Zeusi përvetësoi gjithë urtësinë e saj dhe gjithë maturinë e saj, të gjitha njohuritë praktike dhe inteligjencën e saj. Asimilimi i Metis ishte i tillë që vetë Zeusi mbeti shtatzënë dhe, në fund të shtatzënisë, lindi një vajzë. Dhe sikur të mos mjaftonte kjo, Hesiodi thotë se fëmija erdhi në botë përmes kokës së Zeusit!

Ishte Athinaja, perëndesha me sy 'persianë', një grua udhëheqëse! Athinaja kishte trashëguar cilësitë e babait dhe të nënës së saj. Zeusi, mbreti i perëndive, fillimisht mori për grua Metisin (Diturinë), e cila dinte më shumë se perënditë dhe njerëzit. Ndërsa ishte gati të nxirrte në dritë perëndeshën me sy të errët Athina, Zeusi, duke e mashtuar me fjalë të ëmbla, e mbylli në zorrët e tij, sipas këshillës së Gaias dhe Uranit. Ata e kishin këshilluar kësisoj nga frika se mos ndonjë nga perënditë e tjera të pavdekshme do të pushtonte perandorinë. Nga Metisi erdhën fëmijë me inteligjencë të thellë: së pari vajza me sy të ndritur, Tritogjene, e cila barazohej me të atin në forcë dhe mençuri; pastaj djali me zemër madhështore, që do të mbretëronte mbi perënditë dhe njerëzit. Duke parandaluar këtë rrezik, Zeusi e mbylli gruan e tij të re në barkun e tij, në mënyrë që, e fshehur brenda vetes, t'i zbulonte atij njohjen e së mirës dhe të së keqes. Ai nxori nga koka virgjëreshën sykthjellët, hyjninë e gushtit, të tmerrshme, të paepur, që gjallëron luftën, që drejton ushtritë, që magjepset nga klithmat dhe rrëmujat e luftimeve. Athinaja do të bëhet një nga dymbëdhjetë perënditë e Olimpikut dhe do të jetë perëndeshë e preferuar e Zeusit, perëndesha e mençurisë, guximit dhe forcës që mbron një rend të qytetëruar. Athinaja personifikoi fitoren në luftë, strategjinë inteligjente dhe planet e zgjuara. Ndryshe nga perëndia e luftës Ares, i cili personifikonte dhunën brutale dhe teprimin në betejë – ajo ishte një zot 'shkatërrues i qyteteve'. Aresi dhe Athinaja përfaqësonin kundërshtinë midis forcës brutale të bazuar në epërsinë e trupit dhe forcës të kontrolluar nga parësia e mendjes. Athinaja sintetizoi trupin dhe mendjen; shprehte bashkimin e përsosur midis forcës dhe inteligjencës. Nga njëra anë, ajo kishte fuqi: ajo mund t'i çonte ushtritë drejt fitores përmes strategjive dhe planeve të zgjuara. Nga ana tjetër, ajo kishte inteligjencën që e lejonte të qeveriste me mençuri. Kështu, Athinaja e këshilloi të atin, që ai të mbronte pushtetin e tij pa u zhytur në teprim duke riprodhuar arbitraritetin dhe

shtypjen e paraardhësve të tij. Lindja e veçantë e Athinasë nënkuptonte se mençuria politike ishte çështje e kokës, jo e forcës brutale dhe se vlera e saj ishte shumë afër hyjnore. Përveç kësaj, ajo përfaqësonte një pjekuri të caktuar të Zeusi: para mbretërimit të tij, ai ishte mbi të gjitha një luftëtar. Edhe pas fitores së olimpistëve, ai ndonjëherë vepronte në mënyrë të tepruar, siç dëshmohet nga vendimi i tij për të gllabëruar Metisin. Megjithatë, asimilimi i Metis e bëri atë të kuptonte vlerën e mençurisë praktike dhe dallimin midis së mirës dhe së keqes. Në këtë kuptim, Métis mund të përfaqësojë zërin e brendshëm, “ndërgjegjen” do të thoshim, që këshillon liderin politik.

Themis ishte një Titanide që nuk ishte dënuar të jetonte në Tartar dhe që do të jetonte në malin Olimp, personifikon drejtësinë hyjnore, megjithëse funksioni i saj i saktë është i kontestuar nga specialistët. Zeusi dhe Themis krijuan dy grupe hyjnish kolektive: Orët (*Hôrai*), që mishërojnë ligjet e mira, drejtësinë dhe paqen, dhe Moirai (*Moîrai*, i quajtur edhe Fatet), që mishërojnë fatin e qenieve. Kjo martesë e dytë vulosi bashkimin midis fuqisë hyjnore dhe drejtësisë. Gruaja e tij e dytë ishte Themis brilante. Ai kishte Orët, këto perëndesha që kryesojnë ligjet e mira (Eunomia), mbi drejtësinë (Dikè), mbi paqen (Eiréné) dhe nëpërmjet të cilave zbukurohen veprat e të vdekshmëve. Kishte edhe Fatet, të nderuar nga perëndia më e mençur me atributet më të lavdishme, Clotho, Lachesis dhe Atropos, të ngarkuar prej tij për shpërndarjen e të mirave dhe të këqijave të njerëzimit.

Orët (*Hôrai*) ishin tri motra: Eunomia, që personifikonte “Ligjet e mira”, “Legjislacioni i mirë” apo edhe “Rendi i Mirë”; Dikè, duke personifikuar "Drejtësinë"; dhe Eiréné, duke personifikuar "Paqen". Ato ishin të pandashme. Në fakt, a nuk janë ligjet e mira që shoqërojnë gjithmonë drejtësinë dhe paqen? Fakti që Zeusi ishte babai tregonte përgjegjësinë e tij në vendosjen e ligjeve të mira, drejtësisë dhe paqes midis qenieve njerëzore.

Fatet (*Moîrai*), ishin tri motra: Clotho, Lachesis dhe Atropos. Ato personifikojnë fatin njerëzor. Fjala "moire" vjen nga greqishtja *moira* që do të thotë "pjesë", ose "ndarje". Fatet u kujdesën për “pjesën” e fatit që i takonte çdo njeriu, “fatin” e tyre, të konceptuar si një “fije” që motrat e endnin, e shpërndanin dhe e prisnin: Clotho aty “thuri” fillin, ishte tjerrësi; Lachesis "ndante" fillin, ajo ishte dispeçerja; Atropos "e preu fillin", ishte i paepur. Ato kujdeseshin për “fillin e jetës”.

Fëmijët e Zeusit që zëvendësuan botën anarkike të Titanëve mishëruan ose përfaqësonin vlerat më të larta të qytetërimit grek, si guximi, forca, nderi, bukuria apo drejtësia. Nëntë muzat i frymëzuan poetët; tri Hiret mishëronin bukurinë dhe sharmin; orët garantonin harmoninë kozmike; e kështu me radhë. Fëmijët e perëndive apo perëndeshave të tjera "duke pushuar në krahët e të vdekshmëve" ishin superiorë ndaj të vdekshmëve të tjerë. Kjo është arsyeja pse, për

më tepër familjet e mëdha aristokrate, i lidhën paraardhësit e tyre me njërin ose tjetrin nga heronjtë ose perënditë. Prandaj, drejtësia e mbretërimit të Zeusit u personifikua nga dy hyjnitë: Themis, gruaja e dytë e Zeusit dhe Diké, vajza e tyre. Perëndesha Themis përmendet si e lindur tri herë në Teogoni dhe ajo nuk shfaqet në *Punët dhe Ditët*. Nga ana e saj, perëndesha Diké përmendet vetëm një herë në Teogoni, megjithëse ajo është në qendër të poemës së dytë. Marrëdhënia midis dy hyjnive është komplekse dhe nuk është objekt konsensusi midis specialistëve. Nga Hesiodi, Platoni e deri te John Rawls i bashkon pohimi se “drejtësia është virtyti i parë institucioneve sociale” (RAWLS, 2005: 3)

Diké, e bija e Zeusit, është veçanërisht subjekti i poemës *Punët dhe Ditët*. Hesiodi denoncoi korrupsionin dhe arbitraritetin e më të fuqishmëve, mbretërve dhe gjykatësve. Diké, është e bija e Zeusit, e shquar, e nderuar për perënditë që banojnë në Olimp; me fjalë të tjera, të gjithë perënditë e donin drejtësinë. Sa herë që dikush i bënte keq ose e fyente, ajo vraponte në Olimp dhe ulej pranë Zeusit në fronin e tij. Ajo raportonte për padrejtësitë dhe gjykimet e padrejta të mbretërve, në mënyrë që të gjithë njerëzit të mund të ndëshkoheshin. Sigurisht, nëse dikush e lëndon dhe e fyen, menjëherë, duke u ulur pranë Atit të saj Zeus, ajo akuzon shpirtin e pabesë të njerëzve, në mënyrë që njerëzit të ndëshkohen për fajin e mbretërve, të cilët, me një plan të keq, devijojnë nga drejtësia e drejtë dhe refuzojnë të shqiptojnë gjykime të paqortueshme. Gjatë poezisë *Diké* i kundërvihet "teprimi", të shkaktuar nga dhuna, gënjeshtria ose fyerja. Megjithëse njerëzit mund të ndiqnin njërin nga rrugët, në fund, *Diké* fitonte gjithmonë, sepse mendjemadhësia është një shkelje e rendit të gjërave. Hubris çon në kaos dhe për këtë arsye shkatërron veten. Sipas Hesiodit, kur një mbret i korruptuar shqiptonte një gjykim të shtrembëruar, ai devijonte automatikisht nga betimi i tij dhe e “përzuri” Diken nga qyteti i tij. Dike u zemërua dhe, e veshur me ajër, ajo udhëtoi nëpër qytete duke qarë, duke u sjellë fatkeqësi njerëzve që nuk e kishin ndjekur. Kur një person kryente një fyerje (shkelje të nderit të të tjerëve), dënimi mund të ishte i pamëshirshëm: një qytet i tërë mund të vuante për shkak të një personi të vetëm. Zeusi "i cili shikon larg" mund të dërgonte atje urinë, murtajën ose sterilitetin, gjë që bëri që njerëzit të zhdukeshin dhe të shkatërronin ushtrinë e tyre, muret dhe anijet e tyre. Prandaj njerëzit duhej të kishin frikë nga drejtësia e Zeusit. Ai pa gjithçka dhe kuptoi gjithçka: tridhjetë mijë perëndi të veshur me ajër vëzhguan veprimet dhe gjykimet e të vdekshmëve, të drejta ose të shtrembëruara. Dëshmitari i Zotit, i betimeve [Styx] hiqet nga gjykimet e shtrembëruara (të padrejta). *Diké* acarohet kudo ku njerëzit marrin dhurata dhe që shkelin ligjet me gjykime të shtrembëruara. E veshur me ajër, ajo udhëton duke qarë nëpër qytetet dhe shtëpitë e njerëzve, duke u sjellë fatkeqësi njerëzve që e ndoqën dhe që nuk gjykuan me drejtësi:

“[...]Kroniôn (Zeus), nga maja e Ouranos, dërgon një fatkeqësi të madhe: uri dhe ngjitje në të njëjtën kohë dhe njerëzit humbasin. Gratë nuk lindin më dhe familjet bien, me vullnetin e Zeusit Olimpik; ose përsëri, Kroniôn shkatërron ushtrinë e tyre të madhe ose muret e tyre, ose gëlltit anijet e tyre në det. O mbretër, konsideroni vetë këtë ndëshkim, sepse perënditë, të përziera mes njerëzve, shohin të gjithë ata që, pa asnjë shqetësim për perënditë, ndjekin gjykime të padrejta! Tridhjetë mijë Daimone (perëndi/demonë) të Zeusit, në tokën amë, janë kujdestarët e njerëzve të vdekshëm të panumërt; dhe, të veshur me ajër, vrapojnë andej-këtej në tokë, duke respektuar gjykimet e drejta dhe veprat e liga [...] Merreni parasysht këtë, o mbretër që gllabëroni dhuratat! Korrigjoni fjalitë tuaja dhe harroni paudhësinë (gjykimet e shtrembëruara). Njeriu që dëmton të tjerët i bën dëm vetes; një qëllim i keq është më i keq për atë që e ka projektuar. Syri i Zeusit sheh dhe kupton gjithçka.” (HÉSIODE, 2017:10)

Mbretërit që ndoqën drejtësinë dhe dhanë gjykime të drejta lidhur me të huajt apo bashkëqytetarët e vet, bënë që *polisi* të përparonte, Zeusi nuk u dërgoi atyre luftë, uri apo dhunë. Aty mbretëronte paqja, delet ishin të “ngarkuara me lesh”. Drejtësia lejon kohezionin social dhe begatimin. Paqja është në tokën e tyre dhe Zeusi, që shikon larg, nuk u dërgon kurrë vajtime. Uria apo fyerja nuk i godet kurrë njerëzit e drejtë dhe ata gëzojnë pasuritë e tyre në gosti. Toka u jep atyre ushqim të bollshëm dhe gratë e tyre lindin djem si etërit e vet. Ata nuk lundrojnë në anije, sepse toka pjellore u dhuron frytet e saj. (HÉSIODE, 2017:10) Natyrisht, nëse drejtësia do të shkaktonte fatkeqësinë e qenieve njerëzore dhe nëse njerëzit e padrejtë do të merrnin më shumë të drejta sesa të drejtët, atëherë Hesiodi do ta vlerësonte padrejtësi. Por ai nuk besonte se ky ishte vullneti i Zeusit. Hesiodi formuloi një propozicion që do të shënonte përgjithmonë filozofinë e së drejtës: drejtësia është “më e mira e gjërave”, ajo është “e para nga të gjitha të mirat”. “Drejtësia, shkruante Hesiodi, fyhet dhe dridhet kudo ku ajo shihet e realizuar nga këta njerëz, gëlltitës dhuratash, që japin vendime kriminale.” (HÉSIODE, 2017:11) Disa rreshta më poshtë ai ndoshta i parapriu devizës së moralit të krishterë:

“Njeriu që i bën keq tjetrit i bën keq gjithashtu vetvetes; një gjykim i keq është gjithmonë i tmerrshëm për gjyqtarin.” (HÉSIODE, 2017:11)

Këshilla që i jep të vëllait merr një vlerë universale dhe mjaft aktuale kur e porosit t’i ruajë këshillat e tij në mendje, të dëgjojë zërin e drejtësisë [Dikë, Gj.S.] dhe të heqë dorë përgjithmonë nga dhuna [Bia, Gj.S.], sepse i tillë ishte ligji që djali i Saturnit u ka imponuar të vdekshmëve. Ai ka lejuar peshqit, kafshët e egra, zogjtë e shpejtë të shqyejnë njeri tjetrin, sepse nuk ekziston aspak drejtësi ndërmjet tyre; por ai u ka dhënë njerëzve këtë drejtësi, e mira më e çmueshme. [...] Nuk ka gjë më të lehtë sesa të shkasësh në ves: rruga është e shkurtër dhe ne e kemi pranë; por perënditë e pavdekshme kanë vaditur me djersë rrugën e virtytit: kjo rrugë është e gjatë, e thepisur dhe me shumë pengesa; por kur arrin në majë, ajo bëhet e lehtë, edhe pse gjithmonë e mundimshme.

Dikë: drejtësia njerëzore. Është absurde të kërkohet në mitet greke një teori e qartë dhe koherente e drejtësisë së zbatueshme për njerëzit, kur ndodhemi shekuj para Platonit. Përdorimi i termit "drejtësi" presupozonte ekzistencën e një rendi unik dhe themelor, që strukturonte të gjithë universin, si botën fizike ashtu edhe atë morale, sa shoqërinë hyjnore, aq atë tokësore. Drejtësia herë i referohej vetë rendit, herë ruajtjes ose rivendosjes së tij. Kërkesat e drejtësisë garantonin ekuilibrin kozmik. Një akt ishte i drejtë nëse përputhej me rendin e gjërave. Në varësi të kontekstit, drejtësia mund të nënkuptojë tri gjëra: 1) zakon, mënyrë të qeni ose të vepruari; 2) aktgjykim, pretendim i drejtësisë ose gjykim; 3) dënim ose ndëshkim. Tri kuptimet bëhen burimi i konceptimit tradicional, sipas të cilit akti i drejtësisë konsiston në dhënien çdo personi atë që i takon. Për t'u dhënë të gjithëve atë që u takon, ajo përcaktohet, përndryshe kërkesa mbetet formale. Prandaj duhet të ekzistojë paraprakisht një rend i caktuar normativ. Në *Teogoni*, Zeusi kishte shpërndarë nderet dhe privilegjet midis perëndive në përputhje me atë që ishte në të drejtë të tyre në rendin botëror. Në të njëjtën mënyrë, mbretërit dhe njerëzit duhej të respektonin nderet dhe privilegjet, që u përkisnin individëve dhe grupeve të individëve sipas gradës së tyre shoqërore. Në të dyja rastet, rendi përcaktonte 'masën' që i shkonte çdo personi dhe drejtësia kërkonte respektimin e rregullave që e strukturonin atë dhe pagesën e dëmshpërblimit në rast shkeljeje. Në kontekste të tjera, një *dikë* përcaktonte një gjykim, vendimin e një gjyqtari që përcaktonte se cila nga dy palët, në një mosmarrëveshje, ishte në të drejtën apo edhe "pretendimin" e një pale në mosmarrëveshje, i cili pohonte të drejtat e tij. Ashtu si Zeusi shqiptonte gjykime për rendin kozmik, mbretërit duhej të shqiptonin *dikai* (shumës *dikè*) për komunitetet që ata qeverisnin. Në botën e Hesiodit nuk kishte ligje të shkruara, rendi shoqëror sigurohej me zakon, kurse 'dikë' ose "drejtësia e drejtë" ishte "ajo që pëlqente Zeusi më shumë se çdo tjetër." (HÉSIODE, 2017:61) Kuptimi i dytë përputhet me etimologjinë e emrit 'themis' që vjen nga "ti themi", e cila do të thotë "pozoi", "vendos", sipas fjalorit të E. Benveniste. *Themis* (GRANT & HAZEL. (1975: 340-341) do të përcaktonte "çfarë parashtrohet ose vendoset si urdhëruese", d.m.th. zakonet, përdorimet ose parimet e drejtësisë hyjnore. Nga ana e saj, fjala *dikè* vjen nga *deiknumi*, që do të thotë "tregoj", sipas P. Chantraine. Kështu, *dikè* mund të jetë një "tregues" i kërkesave të *themis*: një gjykim që "tregon" se kush është në të drejtë, duke pasur parasysh si është "pozicionuar". Etimologjia na kujton shprehjen e dëgjuar rëndom: 'vëzhgo ligjin'.

Ndëshkimi ose dënimet. Në kontekste të tjera, *dikè* lidhej me dënimin që pësonin ata që shkelnin rregullat e vendosura. Një person që uzurponte statusin e të tjerëve duke u mohuar atë që u takon (për shembull, jetën e tij, gruan, pasurinë), kjo nënkupton se po i kalon kufijtë e tij. Ai cënonte jo vetëm nderin (*timé*) të viktimës së vet, por edhe nderin (*timé*) e zotave, përfshirë

Zeusin. Duke qenë se autori kishte çekuilibruar rendin e gjërave, *diké* ndërhyri duke kërkuar dëmshpërblim dhe për të rivendosur rendin. Ndëshkimi mund të marrë formën e dëmshpërblimit ose hakmarrjes dhe në të dy rastet, ai bënte të mundur riparimin e gabimit duke i kthyer secilit atë që ishte me të drejtën. Dënimi ishte i merituar, sepse keqbërësit, e shtyrë nga mendjemadhësia, duhej të ktheheshin në “masat e tyre të drejta”, brenda kufijve të tyre. *Diké* si ndëshkim mbronte kështu *diké* si zakon, një mënyrë të qeni ose të vepruari. Ndëshkimi erdhi nga një koncept fetar i ekuilibrit kozmik. Funkzioni i saj kryesor ishte të rivendoste rendin që strukturonte çështjet natyrore dhe njerëzore. Por kishte kufij. Për shembull, nëse autori i një fyerje i ofron viktimës një kompensim të përshtatshëm, ky e fundit duhej ta pranonte atë. Kompensimi u konceptua si një “riparim” i rendit. Ndëshkimi rivendoste harmoninë aty ku rendi ishte destabilizuar; ajo rikonstituo i çmimet që shkonin për secilin person. Por nëse viktima refuzonte dëmshpërblimin, atëherë ai dëmtote nderin e fajtorit, i cili atëherë mund të hakmerrej. Te vepra *Punët dhe ditët*, Hesiodi shkroi:

“Nëse një mik fillon të të ofendojë me fjalët e tij fyese ose me veprimin e tij, mos harro ta ndëshkosh dy herë; por nëse ai kthehet në miqësinë tuaj dhe dëshiron të të ofrojë kënaqësi, pranoje atë, sepse është e trishtueshme të shkosh nga një mik te tjetri.”

Blazar D, Kraft MA. Teacher and Teaching Effects on Students' Attitudes and Behaviors. *Educ Eval Policy Anal*. 2017 Mar;39(1):146-170. doi: 10.3102/0162373716670260. Epub 2016 Oct 8. PMID: 28931959; PMCID: PMC5602565.

Tang Y and Hu J (2022) The impact of teacher attitude and teaching approaches on student demotivation: Disappointment as a mediator. *Front. Psychol.* 13:985859. doi: 10.3389/fpsyg.2022.985859

Choy, S. C., & Troudi, S. (2006). An investigation into the changes in perceptions of and attitudes towards learning English in a Malaysian college. *International Journal of Teaching and Learning in Higher Education*, 2, 120- 130.

Dehbozorgi, E. (2012). Effect of attitude towards language learning and risktaking on EFL students' proficiency. *International Journal of English Linguistics*, 2(2), 41-48.

Kent, A. P. (2008). Attitude is everything. *Medical Education*, 35(11), 1011–1012.

Kara, A. (2009, June 1). The Effect of a 'Learning Theories' Unit on Students' Attitudes Toward Learning. *Australian Journal of Teacher Education*, 34(3).

Colaste, C. R. (2018). The Impact of Students' Attitude Towards the English Language on Academic Achievement. *International Journal of Trend in Scientific Research and Development*, 3(1), 330–359.

Prakash, G. S., Sangeetha, R., Almeida, S. M., & Chellasamy, A. (2022). Examining University Students' Attitude towards e-Learning and Their Academic Achievement. *International Journal of Information and Education Technology*, 12(10), 1056–1064.

Viet, V. V. (2017, December 25). Undergraduate Students' Attitude Towards Learning English: A Case Study at Nong Lam University. *VNU Journal of Science: Education Research*, 33(4).

Mustafa, H. H., Rashid, M. A., Atmowardoyo, H., & Dollah, S. (2015, November 7). Students' Attitudinal Factors in Learning English as a Foreign Language. *Journal of Language Teaching and Research*, 6(6), 1187.

Allen, J., Gregory, A., Mikami, A., Lun, J., Hamre, B., & Pianta, R. (2013). Observations of Effective Teacher–Student Interactions in Secondary School Classrooms: Predicting Student Achievement with the Classroom Assessment Scoring System—Secondary. *School Psychology Review*, 42(1), 76–98.

Pit-ten Cate, I. M., & Glock, S. (2019, November 29). *Teachers' Implicit Attitudes Toward Students From Different Social Groups: A Meta-Analysis*. *Frontiers*. <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2019.02832>

Roberts, C. A., & Wright, T. (1988, September). Roles of Teachers and Learners. *TESOL Quarterly*, 22(3), 493.

The Effects of Teachers' Attitudes on Students' Personality and Performance. (2011). The Effects of Teachers' Attitudes on Students' Personality and Performance - ScienceDirect. <https://doi.org/10.1016/j.sbspro.2011.10.144>

Avramidis, E., Bayliss, P., & Burden, R. (2000, June). A Survey into Mainstream Teachers' Attitudes Towards the Inclusion of Children with Special Educational Needs in Ordinary Schools in One Local Education Authority. *Educational Psychology*, 20(2), 191–211.

Cornoldi, C., Terreni, A., Scruggs, T. E., & Mastropieri, M. A. (1998, November). Teacher Attitudes in Italy After Twenty Years of Inclusion. *Remedial and Special Education*, 19(6), 350–356.

Wang, J. S., Lan, J. Y. C., Khairutdinova, R. R., & Gromova, C. R. (2022). Teachers' attitudes to cultural diversity: Results from a qualitative study in Russia and Taiwan.

Larrivee, B. (1981). Effect of Inservice Training Intensity on Teachers' Attitudes toward Mainstreaming. *Exceptional Children*, 48(1), 34–39.

Larrivee, B. (1982). Factors underlying regular classroom teachers' attitude toward mainstreaming. *Psychology in the Schools*, 19(3), 374–379.

Van Reusen, A. K., Shoho, A. R., & Barker, K. S. (2001). High school teacher attitudes towards inclusion. *The High School Journal*, 84(2), 7–20.

Ahmed, A. (2009). Effect of breastfeeding educational program based on Bandura social cognitive theory on breastfeeding outcomes among mothers of preterm infants. *Poster presented at the ILCA Conference, Orlando, FL*.

Bandura, A. (1977). Self-efficacy: Toward a unifying theory of behavioural change. *Psychological Review*, 84(2), 191- 215.

Heinström, J. *Personality Effects on Learning*. Personality Effects on Learning | SpringerLink. https://doi.org/10.1007/978-1-4419-1428-6_735

L. (2021). *Professional ethics and attitudes of teaching professionals - Library & Information Science Education Network*. Library & Information Science Education Network.

Editors, T. *Teaching about Racism Is Essential for Education*. Scientific American. <https://doi.org/10.1038/scientificamerican0222-10>

[Solved] *The role of a teacher in a classroom should be*. (2023, May 12). Testbook.

What Is Teacher's Attitude | IGI Global. <https://www.igi-global.com/dictionary/teachers-perceptions-towards-technology-integration-into-inclusive-early-childhood->

[education/86991#:~:text=The%20way%20teachers%20perceive%20and,teaching%20practices%20in%20the%20class.](#)

How do the Attitudes of Teachers Affect the Personalities and Performances of Students? - Education Summary. Education Summary.

Skinner, E. A., & Belmont, M. J. (1993). Motivation in the classroom: Reciprocal effects of teacher behaviour and student engagement across the school year. *Journal of Educational Psychology*, 85(4), 571–581.

Babad, E. (1993). Teachers' differential behaviour. *Educational Psychology Review*, 5(4), 347-376.

Baloglu, N. (2009). Negative behaviour of teachers with regard to high school students in classroom settings. *Journal of Instructional Psychology*, 36(1), 69-78.

Brophy, J. E. (1982). How teachers influence what is taught and learned in classrooms. *The Elementary School Journal*, 83(1), 1-13.

Goudas, M., Dermitzaki, I., & Bagiatis, K. (2000). Predictors of students' intrinsic motivation in school physical education. *European Journal of Psychology of Education*, 15(3), 271-280.

Grush, J. E., & Costin, F. (1975). The student is a consumer of the teaching process. *Educational Research Journal*, 12(1), 55-66.

Hallinan, M. T., & Tuma, N. B. (1978). Classroom effects on change in children's friendships. *Sociology of Education*, 51(4), 270-282.

Klein, S. S. (1969). Student influence on teacher behaviour. *American Educational Research Journal*, 8(3), 403-421.

Lareau, A. (1987). Social class differences in family-school relationships: The importance of cultural capital. *Sociology of Education*, 60(2), 73-85.

Leder, G. C. (1987). Teacher-student interaction: A case study. *Educational Studies in Mathematics*, 18(3), 255-271

Muijs, D., & Reynolds, D. (2002). Teachers' beliefs and behaviours: What really matters? *The Journal of Classroom Interaction*, 37(2), 3-15.

Mulryan-Kyne, C. (2004). Teaching and learning in multigrade classrooms: What teachers say. *The Irish Journal of Education / Iris Eireannach an Oideachais*, 35(1), 5-19.

Ramirez, A. R., & Stromquist, N. P. (1979). ESL methodology and student language learning in bilingual elementary schools. *TESOL Quarterly*, 13(2), 145-158.

Sieber, R. T. (1979). Classmates as workmates: Informal peer activity in the elementary school. *Anthropology & Education Quarterly*, 10(4), 207-235.

Smylie, A. M. (1992). Teachers' reports of their interactions with teacher leaders concerning classroom instruction. *The Elementary School Journal*, 93(1), 85-98.

Sutton, E. R., & Wheatley, F. K. (2003). Teachers' emotions and teaching: A review of the literature and directions for future research. *Educational Psychology Review*, 15(4), 327-358.

Thien, L. M., & Razak, N. A. (2013). Academic coping, friendship quality, and student engagement associated with student quality of school life: A partial least square analysis. *Social Indicators Research*, 112(3), 679-708.

Turner, R. (1967). Pupil influence on teacher behaviour. *Classroom Interaction Newsletter*, 3(1), 5-8.

Kristaq BALLI

**Sotir Peci – Patrioti E Publicisti Veteran, Arsimtari E Gjuhëtari, Politikani E
Ministri Vizionar**

Abstract

Sotir Peci published the first Albanian newspaper in America; the first newspaper before the Congress of Manastir and Elbasan, which became the tribune of patriotism, presentation, defense, independence and integrity against ultranationalist passions and tendencies of division and annexation. He debuted again with the newspaper “Bashkimi Kombëtar (National Union)”, whose goal was national awareness. Thanks to his realism, pragmatism, but also foresight, maturity, consistency and correctness, he would create an uninterrupted vector of ascent and full affirmation as a personality in the functions of deputy, minister and regent. In the field of pedagogy, education and science he presented himself as a teacher at the Elbasan Normal School, then director at the Albanian Teacher Training School of Korça, assistant for education in the government of Ismail Qemali, director of Education for Tirana in the government of Durrës and, later, Minister of Education. In 1912 he published “Viti Premtar i Grammatikës (The Promising Year of Grammar)” and planned the publication of 24 other school textbooks. The publisher of the Albanian language, he emerged as a scientific authority, who influenced the presentation of the Albanian language with the Greek alphabet, but also in the unification of the Albanian alphabet. Participant in both Alphabet Congresses, compiler of a grammar, publisher of newspapers, compiler of a voluminous Albanian-Albanian dictionary, member of the Literary Commission and permanent researcher of Albanian linguistic and literary phenomena, lexicologist and lexicographer, he worked for the future of the Albanian language, based on his moderate idea of using both dialects. I would paraphrase the figure of the veteran servant of the Fatherland Sotir Peci, recently in the work dedicated to him, as the representative and outstanding personality of that generation of national vanguard workers, who continued and transformed the Renaissance enlightenment efforts into a new nationwide movement for the formation, integration and affirmation of a modern nation and state.

Keywords: *servant, veteran, publisher, educator, publicist, statesman*



Sotir Peci (1873-1932)

Sotir Peci lindi në Dardhë, qytezë afër qytetit të Korçës, më 1873 nga një familje me gjendje të mirë ekonomike por dhe e arsimuar dhe e qytetëruar mirë për kohën. Familja e gjithë merrej me tregtinë e lëndës drusore, gjë që e detyronte të komunikonte jo vetëm me Korccën e qarkun rreth saj, por edhe më gjerë. Vendlindja nga një anë dhe prejardhja e tij familjare kanë rolin parak në formimin e karakterit të tij rinor, si dhe ndikimin pozitiv që do të ushtronin ato gjatë arsimimit, kulturimit dhe aktivitetit të tij patriotik,

kulturor, publicistik, arsimor e politik.

Në mënyrë panoramike po formuloj kronikën e jetës së tij, për të krijuar sado pak imazhin e punëve, aktivitetit e angazhimeve të tij kryesore, në arenën e zhvillimeve të dendura komplekse shqiptare në dy-tri dekadat e para të shekullit të 20-të.

Studimet e mesme-gjinnazin dhe fakultetin e shkencave në degën për matematikë-fizikë i ka përfunduar në Athinë e, aty, në vitet 1900-1904, falë prirjeve e pasionit të tij kulturor, letrar, iu bind detyrimit patriotik për të marrë përsipër botimin e fjalorit të Kostandin Kristoforidhit. Deri në fund të shekullit të 19-të gjuha shqipe vijonte të shkruhej me dhjetëra alfabetë, por alfabeti grek mund të ndihmonte që edhe të huajt me anë të tij të mësonin për popullin shqiptar, për gjuhën e kulturën e tij.

“Një gjuhë e pashkruar është idiomë e një fisi a e një populli që ende nuk ka arritur të formojë një njësi politiko-gjeografike. Nevoja e grafizimit të gjuhës lind atëherë kur një bashkësi gjuhësore arrin një shkallë të atillë njësimi sa të krijojë një bashkim shpirtëror e politik të ngjashëm me shtetin.” (MEMUSHAJ, 2013: 9)

Etapa e grafizimit të gjuhës shqipe fillon me “Formulën e Pagësimit” (1462) dhe përfundon me “Mesharin” e Buzukut (1555), ku shqipja del për herë të parë e shkruar me alfabet origjinal, veç

me themel latin. Më pas shqipja u shkrua edhe me alfabet grek, fjala vjen “Bleta shqiptare” e Thimi Mitkos, 1878; më 1924 librin u përpoq ta latinizonte Gjergj Pekmezi, sipas tij botimi ka vlerë edhe sepse në original mund ta lexojnë edhe grekët dhe të tjerë që njohin këtë gjuhë.

“Bleta” e Mitkos qe një libër i hapur edhe për trashëgiminë e arbëreshëve, edhe për këngë të shqiptarëve gegë, madje edhe për ndonjë vjershë alamiado (një prej tyre, me autor Hasan Zyko Kamberin – Koloniotin, sepse ishte nga Kolonja, ai e vlerësonte shumë lart). Studiuesi thekson:

“Kësisoj alfabetet pushuan së qeni kufij, dialektet pushuan së qeni kufij, ndarjet krahinore pushuan së qeni kufij, procesi homogjenizues po ecte për së mbari.” (MITKO, 2020: 23)

Me alfabet grek u shkrua *Fjalor i Gjuhës Shqipe* (Leksikon tis alvanikis glosis). Ai u botua më 1904 në Athinë nga Sotir Peci, pasi u dha leja nga qeveria greke. Fjalësi i mbledhur është me rreth 12.000 (11.675) fjalë, është dygjuhësh, shqip e greqisht. Fjalori pasi u ripunua dhe u transkriptua në alfabetin e shqipes së sotme prej A. Xhuvanit, u ribotua më 1961 me titullin *Fjalor Shqip-Greqisht*. Ajo është vepra e parë e leksikografisë shqiptare, përpjekja e parë drejt një fjalori shpjegues të shqipes. Shpjegimi bëhet kryesisht në shqip e greqisht, nganjëherë dhe në latinisht, turqisht e italisht; ai merr vlerë edhe si dëshmi e pasurisë leksikore me një shtrirje mbarëgjuhësore duke kaluar kufijtë e variacioneve gjuhësore të shqipes. Kësisoj fjalori dokumenton kontributin e K. Kristoforidhit edhe në formimin e gjuhës standarde shqipe.

“Si përfundim, do të vinim në dukje se ndihmesa në hedhjen e themeleve të një gjuhe letrare dëshmohej si e përbashkët për të dy këta lëvrues të shquar të shqipes. Njëri ishte nga Elbasani (K. B.: Konstandin Kristoforidhi) e tjetri nga Frashëri (K. B.: Naim Frashëri), por i përkisnin të njëjtit orientim kulturor e kombëtar, që do të përcaktonte në vija të trasha po atë rreth temash, kërkesash e kërkimesh, rrjedhimisht edhe po atë leksik, e më gjerë, po atë frymë gjuhësore.” (LLOSHI, 2001: 179)

Sipas Aleksandër Xhuvanit, *Fjalori* erdhi në ndihmë të mësimin të shqipes për ata intelektualë shqiptarë që dinin greqisht, por nuk dinin të lexonin e shkruanin shqip. Kristoforidhi bëri përpjekje të mëdha për ta botuar *Fjalorin*, por nuk mundi. Pas vdekjes së tij fjalori rrezikoi bjerjen e dorëpasdorshme derisa përfundoi në arkivat e ministrisë së Jashtme të Greqisë. *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, deri atëherë, ishte vepra më madhore e gjuhës shqipe, prandaj, çështja e parë që duhet zgjidhur për shkrimin e një gjuhe, thekson Memushaj, është *grafizimi* i saj, kurse produkti i këtij procesi është alfabeti i asaj gjuhe.

Me alfabet arab të përshtatur për shqipen shkruan disa autorë alamiado (më i madhi syresh Nezim Frakulla apo Nezim Berati me *Divanin* e parë shqip; një kopje tij e transkriptuar me alfabetin grek, ruhet në Arkivin e Shtetit Shqiptar). Për tre deri katër shekuj, shkolla letrare e vjershëtarëve të spikatur, Nezim Berati (shek. 17 -1760), Hasan Zyko Kamberi (shek. 18 - shek. 19) dhe Muhamed Çami (1784-1844), kjo shkollë u bë një shkollë e mirëfilltë letrare ku zbulohet autori, “madje si subjekt i shkrimit,” (HAMITI, 2010: 146). Shqipja vijoi të shkruhej edhe me alfabete origjinale duke nisur me *Ëvetaret* e N. Veqilharxhit e të tjerë më këtej. Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare u përdoren rreth 50 sosh. Një nga më të përdorurit ishte alfabeti i *Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqipe*, apo Alfabeti i Stambollit, siç thirrej zakonisht shkurt alfabeti i vendosur në atë shoqëri më 12 tetor 1879.

Bashkë me njësimin e kërkesave kulturore e kombëtare, u kërkua edhe njësimi i gjuhës sipas një standardi. Një nga prijësit e shoqërisë investoi një veprimtari të gjerë në punë të formimit të gjuhës letrare shqipe:

“Nga një vështrim i përgjithshëm kemi krijuar një mendim e bindje të ngulitur se Naimi – poeti i madh dhe veprimtari i dalluar ndër inteligjencien e kohës së Rilindjes Kombëtare, në punë të formimit të gjuhës letrare shqipe investoi një veprimtari të gjerë, derdhi mund, shkriu energjitë e tij për përsosjen e këtij mjeti të fortë, të pazëvendësueshëm në punë të përparimit e të zhvillimit të kombit – siç thoshte vetë Naimi.” (AJETI, 2001: 119)

Sabri Hamiti shkon më tej në vlerësimin e apostullit të kombit për ngjizjen e gjuhës shqipe kur shkruan:

“Naim Frashëri (1846-1900), njësoj i rëndësishëm si apostull i kombit, si poet e si krijues i gjuhës letrare shqipe, krijoi himnin për vendin me veprën *Bagëti e Bujqësi* (1886), himnin e dashurisë me poemën *Bukurija* (1890) dhe himnin për heroin nacional me epin *Skënderbeu* (1898).” (HAMITI, 2010: 148)


I takon ky përcaktim poetit të madh që jo vetëm e ka njohur vlerën përbashkuese e qytetarizuese të gjuhës, por dhe ka mbështetur lëvrimin e saj. Këtë e ka vënë në dukje albanologu i mirënjohur austriak Norbert Jokli në studimin e vet: “Naim Frashëri e pasunimi i gjuhës shqipe”, punim i përfshirë në librin kushtuar poetit me rastin e 25-vjetorit të vdekjes së tij, botuar në Grac në vitin 1925:

“Kish të drejt i gjori Laipniç, që thosh: m’epni shkronja të mira, t’u ap gjuhë të bukurë; m’epni gjuhë të bukurë, t’u ap qytetëri të mbaruarë.” (FRASHËRI, 1899: 36)

Këtë ndihmesë me ndikim të bshkëkohësit apo krijuesit e mëvonshëm e ka vënë në dukje Shaban Demiraj:

“Gjithsesi, puna themelvënëse e Naimit dhe e bashkëkohësve të tij të shquar, Kristoforidhit, Samiut etj., ka ndihmuar me siguri në qëndrimin, që mbajtën në lëvrimin e gjuhës shqipe një varg shkrimtarësh të tjerë, ndër të cilët duhen veçuar, Faik Konica, Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, Fan Noli, Lasgush Poradeci, etj.” (DEMIRAJ, 2001: 135)

Kjo ishte edhe shtytja e parë e përkushtimit të Sotir Pecit ndaj gjuhës shqipe, si tipari themelor përbashkues i shqiptarëve. Në vitin 1905 ai emigron në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjatë viteve 1906-1908 është botues e drejtor i gazetës së parë e të vetme shqiptare “*Kombi*” në Sh.B.A. Për disa kohë, në këtë gazetë, Fan Noli ka qenë redaktor dhe kryeredaktor i saj.



Më 1908
(14-21
Nëntor)
zgjidhet
e merr
pjesë si
delegat i

shqiptarëve të Sh.B.A-së dhe Kolonisë Shqiptare të Bukureshtit në Kongresin e Manastirit.

Më 1909-1910 emërohet mësues i shkencave të natyrës në Shkollën Normale të Elbasanit. Atje punoi intensivisht për hartimin e programeve dhe botimin e teksteve shkollore. Më 1911-12 e



gjejmë drejtor të Mësonjëtores Shqipe në Korçë.

Në qeverinë e parë të Ismail Qemalit emërohet këshilltar për arsimin i ministrit Luigj Gurakuqi në vitet 1912-13. Më pas do të shfaqet si refugjat në Shkodër, ku bën pjesë në organizatën atdhetare “Krahu Kombëtar”, të kryesuar nga Nikollë Ivanaj. Njëherësh punon anëtar (4 shtator 1916) në “Komisinë Letrare” të Shkodrës, të drejtuar nga Gjergj Pekmezi e Luigj Gurakuqi, e cila synoi futjen e “gjuhës së përbashkët”, pra të gjuhës zyrtare shqipe në administratën shtetërore të kohës. Në qeverinë e Durrësit (të K/ministrit Turhan Pashë Përmeti), më 1919, ai emërohet Drejtor Arsimit për Tiranën.

Më 1920 aktivizohet intensivisht si një prej organizatorëve dhe drejtuesve kryesorë të Kongresit Kombëtar të Lushnjës, duke bashkëpunuar me Ferit Vokopolën, si një prej nënshkruesve të Aktit të Pavarësisë Kombëtare. Së bashku me Vokopolën u bë një prej hartuesve kryesorë të Statutit të Parë Themeltar të shtetit shqiptar, por në kabinetin qeveritar të dalë nga ky Kongres, ai emërohet ministër i Arsimit.



Prej vitit 1921 – 1924 e takojmë deputet, ministër si dhe një prej katër anëtarëve të Këshillit të Lartë (Regjencës).

Është eksponent aktiv e udhëheqës i ngjarjeve që lidhen me të ashtuquajturin Revolucionin Demokratiko-Borgjez të Qershorit më 1924, ndërkohë që vijon detyrën e tij të regjentit. Pas dështimit të këtij revolucioni, i radhitur si kundërshtar politik i Ahmet Zogut, emigron në Itali, ku vijon për disa vjet aktivitetin politik e patriotik si udhëheqës i Shoqërisë “Bashkimi Kombëtar” i emigrantëve shqiptarë në Itali dhe boton gazetën shqipe me të njëjtin titull. Ndërkohë, jo vetëm publicisti por edhe veprimtari i palodhur kombëtar është i dënuar nga qeveria e Zogut me vdekje në mungesë

Në vitin 1928, përfiton prej amnistisë së dytë, të shpallur nga mbreti Zog dhe shkon në Greqi, ku kalon vitet e fundit të jetës, duke punuar intensivisht në fushën e letrave, sidomos në atë të hartimit të një fjalori voluminoz shqip-shqip, me rreth 20.000 fjalë, të cilit nuk arriti t’i kryejë redaktimin

dhe korrektimin e fundit. Gjatë kësaj periudhe janë shfaqur e shtuar hapur debatet, kundërshtitë, divergjencat e tij politike me Fan Nolin, që kish mundur të kalonte në Amerikë.

Sotir Peci ndahet nga jeta në Follorinë të Greqisë në vitin 1932, por varroset në Korçë me nderime të larta zyrtare.



“Gazeta e Korçës” e atyre ditëve shkruan:

“...Populli i Korçës me një ceremoni serioze por tepër imponante përcolli...në banesën e përjetëshme Sotir Pecin..., veteranin e dëgjuar në punimin për atdhe, mësuesin e madh të brezit të sotmë, nacionalistin e patrembur në independencën e Shqipërisë, punëtorin e palodhur të arësimit kombëtar, burrin e shtetit të ndershmë dhe të nderuar prej të gjithë...”

Siç mund të kuptohet, Sotir Peci është personalitet elitar në jetën politike, intelektuale e sociale të Shqipërisë, veçanërisht gjatë viteve 1905-1925. Veprimtaria e tij intensive është shumëdimensionale, por dhe kontributet e tij kanë influencuar në rrjedhën e ngjarjeve kryesore të asaj periudhe. Jeta dhe vepra e Sotir Pecit ishin binomi i harmonisë, por edhe reaksioni i kundërshtisë, që çlironin energji aktive, atdhetarisht panegjirike. Ato synuan udhët e përpjeta, që e çuan në përballjen me problemet madhore të Shqipërisë së asaj kohe. Një përgjithësim i kontributeve të tij do të ishte ambicja për afirmimin, radikalizimin dhe integrimin e çështjes

shqiptare në rrjedhën e historisë moderne europiane. Me këtë vizion, ai paraqitet si një figurë poliedrike, me prurje të spikatura në fushat e atdhetarisë e publicistikës, arsimit e pedagogjisë, filologjisë e gjuhësisë, politikës e shtetarisë.

Shpesh herë, këto attribute janë vështirë të ndahen a të siten nga njëri-tjetri, sepse ato zhvillohen e emetohen si një përjetim i përbashkët organik intelektual, si një veprimtari e përditshme, në të cilën jeta kërkon ballafaqime e angazhime, shpesh, për disa probleme njëheresh, ashtu siç vijnë nga qerthullat e botës prolixse shqiptare e ballkanike. Porse, me dëshirën vetëm sa për të cekur, qoftë edhe përkitazi, do të ofroja dy-tri ngjarje kulmore të veprimtarisë së tij në fushat gjegjëse, në kontekst të ngjarjeve madhore të arenës shqiptare.

1. Gazeta “Kombi” e Sotir Pecit është gazeta e parë shqiptare, githashtu e para gazetë në gjuhën shqipe (pra, para Kongresit të shkronjave shqipe të Manastirit 1908 dhe atij të Elbasanit më 1909) e botuar në Sh.B.A, e cila, për aq kohë sa ekzistoi, u bë tribuna e patriotizmit, atdhetarizmit, prezantimit dhe mbrojtjes së çështjes shqiptare, e independencës dhe integritetit ndaj pasioneve ultranacionaliste dhe tendencave të ndarjes e aneksimit të saj.



Po ashtu, nga fundi i jetës, ai debuton sërish me gazetën “Bashkimi Kombëtar”, synimi i së cilës ishte, po ashtu, ndërgjegjësimi për çështjen kombëtare shqiptare.

2. Si politikan e shtetar, Sotir Peci, falë realizmit, pragmatizmit, por edhe të lagpamësisë, pjekurisë, konsekuencës e korrektësisë do të krijonte një vektor të pandërprerë ngjitjeje e të afirmimit të plotë si personalitet në funksionet e deputetit, ministrit e regjentit, që e la i fundit detyrën e tij, ndonëse i rrezikuar midis dy kundërshtarëve të vet, Ahmet Zogut e Fan Nolit.

3. Në fushën e pedagogjisë, arsimit e shkencës Sotir Peci prezantohet fillimisht si mësues në Normalen e Elbasanit, pastaj drejtor në Mësonjëtorën Shqipe të Korçës, ndihmës për arsimin i Ismail Qemalit, drejtor i Arsimit për Tiranën në qeverinë e Durrësit e, më pas, ministër Arsimi. Këto detyra, natyrisht, janë attribute të aftësive, arsimimit e edukimit, njohurive, përvojës e vlerave pozitive, që ai vuri në shërbim të shqiptarizimit të plotë kombëtar të shkollave, të reformave arsimore e, sidomos, të përpjekjeve për hartimin e teksteve shkollore në gjuhën shqipe.

Më 1912 ai botoi “Viti Premtar i Gramatikës” dhe planifikoi botimin edhe të 24 teksteve të tjerë shkollorë.

4. Si lëvrues e artizan i gjuhës shqipe, Sotir Peci shfaqet një autoritet shkencor, që influencoi jo pak, sidomos në problemin e formimit dhe njësimimit të alfabetit të gjuhës shqipe. Pjesëmarrës në të dy Kongreset e Alfabetit, hartues i një libri gramatikor, botues gazetash, hartues i një fjalori voluminoz shqip-shqip, anëtar i Komisionit Letraro dhe studiues i përhershëm i fenomeneve gjuhësore e të letrave shqipe, leksikolog e leksikograf, ai shprehu opinione adekuate rreth gjendjes dhe të ardhmes të gjuhës shqipe, duke u bazuar në idenë e tij të moderuar të përdorimit të të dy dialekteve “toskërisht” e “gegërisht” dhe se, gjuha letrare do të konsolidonte fizionominë e vet pas eksperiencave të gjata, duke mos u ngutur e duke lënë kohën të bënte punën e vet.

Së fundi, do ta perifrazoja figurën e shërbëtarit veteran të Atdheut Peci, si përfaqësuesin e personalitetin e shquar të atij brezi punonjësish kombëtarë të pararojës, që vazhduan dhe shndërruan përpjekjet iluministe rilindase në një lëvizje të re mbarëkombëtare për formimin, integrimin dhe afirmimin e një kombi e shteti modern.



BIBLIOGRAFI

- ASHSH-IGJL. (2001) *NAIM FRASHËRI DHE KULTURA SHQIPTARE*, Tiranë:
- AJETI, Idriz. *NDIHMESA E NAIM FRASHËRIT PËR FORMIMIN E GJUHËS LETRARE SHQIPTARE*.
- ASHSH-IGJL. (2001) *NAIM FRASHËRI DHE KULTURA SHQIPTARE*, Tiranë:
- DEMIRAJ, Shaban. *NDIHMESA E NAIM FRASHËRIT PËR LËVRIMIN E GJUHËS SHQIPE*.
- DEMIRAJ, Shaban. (2017) *HISTORIA E GJUHËS SË SHKRUAR SHQIPE*. Tiranë.
- DEMIRAJ, Shaban. (2021) *THE ORIGIN OF ALBANIANS* (linguistically investigated). Ribot. Tiranë.
- FRASHËRI, Naim. (1899) *ISTORI E SHQIPËRISË*, Botues ‘Mbrothsia’, Sofje.
- HAMITI, Sabri. (2010) *POETIKA SHQIPE*, Tiranë.
- ASHSH-IGJL. (2001) *NAIM FRASHËRI DHE KULTURA SHQIPTARE*, Tiranë:
- LLOSHI, Xhevat. *NAIM FRASHËRI DHE KRISTOFORIDHI*.
- MEMUSHAJ, Rami. (2013) *GJUHA SHQIPE NË SHTRATIN E PROKRUSTIT*. Tiranë.

REFERENCA

“Gazeta e Korçës”,

Lirie KURTISHAJ-ADEMI¹

Viktimat E Dhunës Seksuale Si Strategji Sociale Dhe Politike Gjatë Luftës Në Kosovë (1998-1999)

Abstract

The phenomenon of rape is not unknown in the history of sociology. In various periods of war, sexual violence has been used not only as an act of individual violence but also as an organized strategy to break the resistance of specific social groups and destabilize their communities. The war in Kosovo (1998-1999) was no exception, where rapes and other forms of sexual violence were systematically used by Serbian forces to terrorize the civilian population and achieve their political and military objectives.

From a sociological perspective, sexual violence in conflicts has deep consequences on the social structure of affected societies. It is not only intended to cause individual harm but also to dismantle collective unity, break community bonds, and destroy the value system of society. In the patriarchal society of Kosovo, where honor and dignity are often closely tied to the body and integrity of women, sexual violence was designed to create trauma that would last beyond the conflict period.

Sexual violence during the war in Kosovo represents a horrific form of violence that affected not only individual victims but also the entire society. This violence was not a spontaneous phenomenon but a well-organized strategy with long-term consequences. Confronting this legacy requires not only support for the victims but also a strong commitment to challenge stigmas, build justice, and recover social structures.

Keywords: *War in Kosovo (1998-1999), Sexual violence, Serbian forces, Violence, Rape, Confronting the legacy, Dignity, Stigmatization, Long-term consequences.*

¹ Lirie KURTISHAJ-ADEMI

Përfundoi studimet “Bach.” për Sociologji dhe studimet “Master” për Marrëdhënie Ndërkombëtare. Vijon ciklin e dytë të studimeve “Master” për Sociologji; aktualisht është në marrëdhënie pune në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”.

Në kontekstin e Kosovës, dhuna seksuale u përdor si një mjet i ndërgjegjshëm për të dëmtuar kohezionin social. Gratë dhe vajzat, si bartëse të traditave dhe kulturës, shpesh u bënë objektiva të kësaj dhune, pasi traumat e tyre ndikuan në të gjithë komunitetin. Në shumë raste, viktimat përballeshin me stigmatizim, izolim dhe refuzim nga familjet, djepi kulturor dhe shoqëria përreth tyre, duke përforcuar efektet shkatërruese të dhunës. Kjo strategji ka krijuar një traumë të dyfishtë: atë të dhunës fizike dhe atë të përjashtimit social.

Sipas teorive sociologjike të funksionalizmit, shoqëritë bazohen në një sistem të mirëkoordinuar vlerash, normash dhe rolesh që mbajnë të lidhura strukturat sociale. Lufta dhe dhuna seksuale minuan këto struktura në Kosovë, duke krijuar boshllëqe në familje dhe komunitete. Përveç traumës individuale, shumë familje humbën kapacitetin e tyre për të funksionuar si njësi mbështetëse dhe ekonomike. Gratë, shpesh të stigmatizuara, u gjendën të privuara nga burimet e mbështetjes dhe të ndihmës që zakonisht ofron familja apo komuniteti.

Në shoqëritë që kalojnë trauma të mëdha, procesi i rikuperimit shoqëror kërkon adresimin e kujtesës kolektive. Në Kosovë, kujtimi i dhunës seksuale gjatë luftës ka qenë një proces kompleks, për shkak të ndjeshmërisë së temës dhe heshtjes shoqërore që e ka rrethuar atë. Megjithatë, mbështetja e organizatave ndërkombëtare dhe nisma të ndryshme për dokumentimin e këtyre krimeve kanë ndihmuar në prishjen e tabuve dhe në sigurimin e drejtësisë për viktimat.

Procesi i drejtësisë për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës nuk është vetëm një çështje juridike, por edhe një domosdoshmëri sociologjike. Ndjekja penale e kriminelëve dhe njohja e vuajtjeve të viktimave janë hapa të domosdoshëm për të rikthyer besimin në institucionet dhe për të rindërtuar strukturat sociale të shkatërruara nga lufta. Për më tepër, rehabilitimi i viktimave nuk është vetëm një akt humanitar, por edhe një proces i rëndësishëm për të rimëkëmbur kohezionin dhe dinamikat komunitare.

Në periudha të ndryshme, veçanërisht gjatë luftërave, dhunimi ka qenë një dukuri e përsëritur që ka prekur thellë ndërgjegjen njerëzore dhe ka lënë gjurmë të pashlyeshme si në nivelin individual ashtu edhe në atë shoqëror. Nga perspektiva sociologjike, dhuna seksuale nuk është vetëm një akt kriminal dhe një shkelje e rëndë e integritetit fizik dhe mendor të viktimave, por edhe një mekanizëm i kontrollit dhe dominimit shoqëror që cenon strukturat themelore të komuniteteve.

Në kontekstin e së drejtës ndërkombëtare, dhunimi dhe format e tjera të dhunës seksuale kategorizohen si krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe krime të gjenocidit. (MAHMUTI, 2019: 63)

Këto veprime synojnë të shkatërrojnë jo vetëm trupin e individit, por edhe kohezionin dhe stabilitetin sociologjik të grupeve dhe komuniteteve. Termi “gjenocid” u përdor për herë të

parë nga Rafa Lemkin (1900-1959), një studiues juridik hebre, në vitin 1943. Fjalët “genos” (familje, fis ose racë në gjuhën greke) dhe “cid” (vrasje në gjuhën latine) formojnë këtë term, i cili u formalizua në Rezolutën 96 (1) të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 11 dhjetor 1946. (OSMANI, 2012: 25-26)

Konventa për Ndalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, e miratuar nga Asambleja më 9 dhjetor 1948 dhe e futur në fuqi më 12 janar 1951, ofron një përkufizim të qartë të gjenocidit, i cili përfshin veprimet e kryera me qëllim të shkatërrimit total ose të pjesëshëm të një grupi kombëtar, etnik, racor ose fetar. (OSMANI, 2012: 26-27) Nga perspektiva sociologjike, ky përkufizim nënvizon pasojat kolektive dhe ndikimin e thellë në ristrukturimin e marrëdhënieve brenda grupeve të prekura.

Sipas nenit 6 (paragrafi b) të Statusit të Romës, shkaktimi i dëmeve të rënda trupore ose mendore anëtarëve të grupit, me qëllim që të shkatërrojë, në tërësi ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial apo fetar përbën akt të gjenocidit”. (MAHMUTI, 2019: 64)

Sipas Protokollit Ndërkombëtar për Dokumentimin dhe Hetimin e Dhunës Seksuale në Konflikte, “dhuna seksuale është një formë e urryer e dhunës që përfshin përdhunimin dhe sulme të tjera të natyrës seksuale kundër grave, vajzave, burrave dhe djemve”. Pasojat e këtyre akteve përfshijnë trauma fizike dhe psikologjike, destabilizim shoqëror dhe një ndikim afatgjatë në ndërtimin e identiteteve komunitare dhe kolektive.

Konventa e Gjenevës për Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Luftë (neni 27) shpreh qartë të drejtën e grave për t’u mbrojtur kundër çdo akti fytes apo dhunues. Megjithatë, gjatë luftës në Kosovë, forcat ushtarake serbe përdorën dhunën seksuale si mjet lufte, duke e kthyer atë në një strategji sistematike për të shkatërruar strukturat sociologjike dhe shpirtrat e komuniteteve shqiptare. Ky veprim përbën një shkelje të hapur të nenit 27 të Konventës së Gjenevës dhe nenit 7 të Statutit të Romës, ku dhuna seksuale cilësohet si krim kundër njerëzimit kur përdoret si pjesë e një sulmi sistematik ndaj popullsisë civile. (MAHMUTI, 2019: 64)

Nga pikëpamja sociologjike, këto akte nuk janë vetëm sulme ndaj individëve, por edhe mjete për të dëmtuar dhe shkatërruar strukturat shoqërore dhe ndërveprimet komunitare, duke krijuar një gjendje frike dhe izolimi të përhershëm. Këto veprime ndikojnë në mënyrë të pashlyeshme në identitetin dhe rezistencën e komuniteteve të prekura, duke lënë pasojat të thella për brezat e ardhshëm.

Krimet e planifikuara dhe dhuna seksuale si strategji gjenocidale në Kosovë

Që nga projekti i Ilia Garashaninit, i pasqyruar në “Naçertania” (1844), politika serbe ka ndjekur një strategji të mirëfilltë për shkatërrimin fizik dhe shpërnguljen e shqiptarëve nga

Kosova. Kjo vijë e veprimit kulmoi me planin famëkeq “Patkoi”² në vitin 1999. (UKSHINI, 2004: 309-315); (FISCHER, 2008: 167-198)²; (SCHARPING, 1999: 239-240)

Të gjitha këto projekte, të mbështetura nga qarqet më të larta shtetërore, kishin një qëllim të përbashkët: shkatërrimin dhe spastrimin etnik të shqiptarëve.

Në gjysmën e parë të viteve '90, shqiptarët organizuan një rezistencë paqësore të gjërë, por kjo qasje nuk prodhoi rezultatet e pritura. Ndërkohë, regjimi i Beogradit intensifikoi dhunën dhe terrorin, duke përfshirë akte gjenocidale gjatë periudhës 1998-1999. Bazuar në hulumtimet, mbi 11,738 shqiptarë, përfshirë gra, fëmijë dhe të moshuar, u vranë, ndërsa mijëra të tjerë u plagosën. (OSMANI, 2010: 43; 63)

Një nga format më çnjerëzore të dhunës ishte përdhunimi sistematik i mbi 20, 000 grave shqiptare. (KMDLNI, 2004: Raport për të vrarët në Kosovë gjatë luftës 1998.1.-1999.6.; 11. 03. 2004)

Ky akt u përdor si një mjet për të terrorizuar popullsinë, për të shkatërruar lidhjet sociale dhe për të kryer spastrim etnik. Studiuesi Bardhyl Mahmuti, duke u bazuar në të dhënat e organizatave si Amnesty International, Human Rights Watch dhe Kombeve të Bashkuara, dëshmon përmasat tronditëse të këtij krimi. (ÇITAKU, 2004: 111)

Përdhunimet masive gjatë luftës nuk ishin akte të izoluar, por një strategji e mirëplanifikuar shtetërore. Ky fenomen, i njohur në sociologji si "dhunë e instrumentalizuar", kishte për qëllim: Thyerjen e rezistencës sociale: Shkatërrimi i lidhjeve familjare dhe komunitare. Stigmatizimin e viktimave: Në shoqëritë patriarkale si ajo shqiptare, përdhunimet krijojnë trauma të

²Sipas ministrit të Jashtëm gjerman Joschka Fischer, ai ishte informuar nga ministrija e Jashtme e Bullgarisë, Nadezhda Mihailowa, për ekzistencën dhe zbatimin e planit famëkeq të quajtur “Operacioni Patkoi.” Ky plan ishte zbuluar nga shërbimet sekrete bullgare dhe kishte ekzistuar prej disa kohësh. Për më tepër, Fischer thekson se ky informacion erdhi si pjesë e një rrjeti të koordinuar informacionesh mes aleatëve të NATO-s dhe vendeve të rajonit. Detaje më të gjera mbi këtë informacion mund të gjenden në veprën e tij: (FISCHER, 2008: 167-198)

Plani “Patkovica” ose i njohur gjerësisht si “Patkoi” ishte hartuar nga kancelaria e regjimit diktatorial serb, nën drejtimin e Slobodan Millosheviqit. Ky plan kishte për qëllim realizimin e spastrimit etnik dhe shkatërrimin e strukturave shoqërore dhe ekonomike të Kosovës. Ekzistenca e këtij plani u zbulua dhe u bë publike më 7 shkurt 1999 nga ministri gjerman i Mbrojtjes, Rudolf Scharping. Sipas Scharping, “Patkoi” ishte një strategji e mirëmenduar për të përzënë shqiptarët nga Kosova përmes terrorit sistematik, duke përfshirë masakrat, dhunën seksuale dhe shkatërrimin e pronave. Për më shumë detaje, shih: (SCHARPING, 1999: 239-240)

Plani “Patkoi” ka qenë objekt studimi dhe analize edhe nga studiues të tjerë, përfshirë Jusuf Osmanin, i cili ka dokumentuar pasojat e tij katastrofike në Kosovë gjatë periudhës 1998-1999. Sipas tij, ky plan nuk ishte vetëm një veprim ushtarak, por një akt i paramenduar gjenocidal që synonte të eliminonte shqiptarët si popull nga Kosova. Ai vëren se zbatimi i këtij plani u karakterizua nga krime sistematike kundër njerëzimit, të cilat përfshinin: masakra masive, përdhunime, djegie të fshatrave dhe dëbime masive të civilëve shqiptarë. Referenca kryesore mund të gjendet në veprën e tij: (OSMANI, 2012: 22)

Ky plan jo vetëm që demonstroi brutalitetin e regjimit serb, por gjithashtu nxori në pah dështimin e komunitetit ndërkombëtar për të parandaluar një katastrofë humanitare të përmasave kaq të mëdha. Ekzistenca dhe zbatimi i planit “Patkoi” u bë një pikë kthese në ndërgjegjësimin ndërkombëtar për nevojën e ndërhyrjes humanitare në Kosovë.

shumëfishta psikologjike dhe sociale. Ndryshimin demografik: Përmes shtatzënive të detyruara, regjimi synonte të ndryshonte përbërjen etnike. (OSMANI, 2010: 63)

Format e dhunës seksuale sipas analizave të OSBE-së, dhunimet kryeshin në mënyra të ndryshme: Dhunime në shtëpitë e viktimave ose vende publike; Kidnapime dhe mbajtje si skllave seksuale; Dhunime grupore dhe para familjarëve; Dhunime të kombinuara me tortura dhe shantazh financiar.

Mosha e viktimave varionte nga 12-13 vjeç deri në 45 vjeç. Fatkeqësisht, shumë gra dhe vajza u masakruan ose u zhdukën pas përdhunimit, duke lënë pas plagë të pashërueshme për familjet dhe shoqërinë. (MANÇESTENA-SHERIFI, 2003: 184)

Të gjitha krimet e kryera në Kosovë kanë qenë plotësisht nën kontrollin e strukturave politike, ushtarake dhe policore serbe, që synonin shkatërrimin e shqiptarëve si të tillë dhe ndryshimin e strukturës së popullsisë së Kosovës. (MAHMUTI, 2015: 291) Pra, ushtria dhe policia serbe e ushtruan ndaj popullsisë shqiptare në vitet e luftës ishte edhe dhunimi seksual i femrave shqiptare. Në terë territroin e Kosovës kan pasur dhunime. (BEGAJ, 2020: Intervistë: 12 nëntor, ora 14:00-16:00.)

Andaj, në raste kur dhuna seksuale ndodhe në gjatë një lufte në përkufizimin e në së drejtës humanitare ndërkombëtare, kemi shkelje të drejtave themelore të njeriut, të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe të protokolleve shtesë I dhe II të vitit 1977. (MAHMUTI, 2019: 63)

Dhuna seksuale mund të ketë pasoja fizike dhe psikologjike afatgjata, të cilat ndikojnë thellësisht në mirëqenien dhe funksionimin e individit. Nga pikëpamja psikologjike, ajo shpesh shkakton trauma të thella, të cilat mund të shfaqen në formën e çrregullimeve të stresit post-traumatik, depresionit të rëndë, ankthit të vazhdueshëm, dhe në disa raste, në formën e ndjenjave të fajit dhe turpit të pashpjegueshëm. Viktimat shpesh ndihen të izoluara dhe të larguara nga shoqëria, duke pasur frikë nga stigmatizimi dhe gjykimi i të tjerëve.

Në disa raste, ngarkesa emocionale e shkaktuar nga dhuna seksuale mund të jetë aq e madhe saqë viktimat, por edhe dëshmitarët e këtyre ngjarjeve, humbasin aftësinë për të gjykuar dhe për të përballuar realitetin. Kjo mund të çojë në kriza të thella psikologjike, si humbja e dëshirës për jetë, ndjenja e pafuqisë, dhe, në raste ekstreme, mendime apo veprime vetëvrasëse. Për më tepër, dhuna seksuale lë pasoja të dukshme edhe në marrëdhëniet ndërpersonale të viktimave, duke përfshirë vështirësi në krijimin e lidhjeve emocionale dhe intimitetit, frikë nga besimi te të tjerët dhe shmangie sociale.

Në këtë kontekst, roli i institucioneve relevante është jetik për të siguruar që viktimat të marrin ndihmën dhe mbështetjen që u nevojitet. Kjo ndihmë duhet të përfshijë trajtime mjekësore,

mbështetje psikologjike profesionale dhe qasje në programe rehabilitimi që ndihmojnë viktimat të rikuperojnë fuqinë personale dhe vetëvlerësimin e tyre. Përtej kësaj, trajtimi i viktimave pa paragjykime janë elemente kyçe për të krijuar një mjedis të sigurt dhe mbështetës për të mbijetuarit.

Të kuptuarit drejt dhe i plotë i pasojave të dhunës seksuale nuk është vetëm një hap drejt trajtimit të duhur, por edhe një bazë për ndërtimin e një shoqërie më të ndjeshme dhe të përgjegjshme. Kjo përfshin krijimin e mekanizmave institucionalë që ofrojnë ndihmë adekuate dhe që adresojnë faktorët që çojnë në këto akte të dhunës, përfshirë normat sociale që mund të inkurajojnë ose tolerojnë dhunën. Ndiurma adekuate dhe qasja proaktive ndaj rehabilitimit të viktimave janë mënyra për të rikthyer shpresën dhe dinjitetin në jetën e tyre. (QRK, 2017: nr.06/143)

Gratë e dhunuara në Kosovë, janë viktimizuar nga pushtuesi, dhe fatkeqësisht vazhdojnë të jenë viktima të mendësisë patriarkale në Kosovë, këtë më së miri e dëshmon fakti nga 20 mijë femra të dhunuara kemi vetëm këtë shifër të atyre që shfrytëzuan të drejtën e tyre nga ajo që e përjetuan. Puna e Komisionit* në shifra, komisioni ka filluar punën me 05.02.2018, deri më tani (nëntor 2020), Sekretaria e Komisionit ka pranuar 1,361 aplikacione, nga të cilat 88.4% janë trajtuar, 5.7% janë në proces të trajtimit dhe 158 raste janë në pritje për tu trajtuar. Në mesin e 88.4% rasteve të trajtuara, 74.3% janë të aprovuara ndërsa 20.0 % janë raste të refuzuara.

Tabela 1: Statistikat lidhur me trajtimin e rasteve

	Numri i rasteve	Në %
Aplikacione të pranuar	1361	/
Të trajtuara	1,203	88.4%
Të aprovuara	894	74.4%
Të refuzuara	241	20.0%

* Statusi i viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, konstatohet nga Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Rregulloren (QRK) Nr. 22/2015 dhe Rregullores 10/2016, për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës. Sipas Ligjit, Komisioni përbehet nga nëntë anëtarët si vijon: një përfaqësues i Zyrës së Kryeministrit; një përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë; një përfaqësues nga Instituti për Krime Luftë; një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë; një psikolog klinik; një psikiatër; një jurist dhe një përfaqësues nga shoqëria civile me përvojë në veprimtarinë e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës seksuale. Anëtarët e Komisionit (kryetari, nënkryetari dhe anëtarët) janë të emëruar me mandat pesë (5)-vjeçar. (BEGAJ, 2020: Intervistë: 12 nëntor, ora 14:00-16:00, Prishtinë.)

Në Proces	86	5.7%
Në pritje për trajnim	158	/

Komisioni Qeveritar bazuar në kompleksitetin dhe ndjeshmërinë e procesit, si dhe me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të ligjshëm të aplikacioneve, secilit rast i ka kushtuar kohën e nevojshme. Komisioni qeveritar zhvillon punën e tij në bazë të legjislacionit në fuqi dhe me profesionalizëm ka ndërtuar praktika të mira dhe duke vënë standarde profesionale me anë të të cilave të drejtat e të mbijetuarve garantohen, të cilat praktika mund ti shërbejnë edhe proceseve të ngjashme në vende të tjera të botës. Komisioni zhvillon një proces i cili në qendër të saj ka nevojat e të mbijetuarve, i trajton lendet me konfidencialitet për t'ju ofruar atyre privatësinë e plotë si dhe bashkëpunon me 4 organizatat* e licencuara për lehtësimin e këtij procesi.

Krimet seksuale kanë lënë një trashëgimi traumatike, e cila kërkon një qasje gjithëpërfshirëse për të trajtuar dëmet psikologjike dhe sociale. Dokumentimi i këtyre krimeve është thelbësor për drejtësinë tranzicionale dhe për të ndaluar mohimin e këtyre akteve çnjerëzore. Për më tepër, shoqëria shqiptare duhet të angazhohet në një proces të gjatë rehabilitimi për viktimat dhe rindërtimi të strukturave sociale të dëmtuara.

* Organizatat Jo Qeveritare (OJQ) të autorizuara për pranimin e aplikacioneve dhe kryerjen e detyrave tjera të përcaktuara me Rregullore, janë Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës/QKRMT, Medica Gjakova/MGJ, Medica Kosova/MK dhe Qendra për promovimin e të drejtave të grave /QPDG në Drenas. Sipas Rregullores, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka nënshkruar marrëveshje me këto 4 OJQ për të ndihmuar në procesin e aplikimit për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimës. OJQ-të e autorizuara mbajnë përgjegjësi që dokumentet përkatëse të ruhen dhe trajtohen sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Zyrtarët e autorizuar të OJQ-ve pranojnë formularët dhe dokumentacionin tjetër përkatës dhe ndihmojnë palët në plotësimin e formularëve, nëse një gjë e tillë kërkohet. Aplikacionet e mbyllura në pliko/zarf i dorëzojnë në Sekretariat. Zyrtarët e autorizuar të OJQ-ve nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit për ruajtjen e të dhënave personale të aplikuesve. (BEGAJ, 2020: *Raporti i punës*, 12 nëntor 2020, ora 14:00-16:00.)

Përfundim

Krimet e kryera nga regjimi shtetëror serb gjatë luftës në Kosovë (1998-1999) ishin të planifikuara, sistematike dhe të drejtuara drejt shkatërrimit të identitetit kombëtar dhe fizik të popullit shqiptar në Kosovë. Duke u mbështetur në dokumentet e shumta kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe dëshmitë e të mbijetuarve, është e qartë se dhuna ishte një strategji e qëllimshme e shtetit serb, e mbështetur nga qarqe politike, ushtarake dhe fetare, për të realizuar synimin e spastrimit etnik dhe ndryshimit të strukturës demografike të Kosovës.

Pjesë integrale e kësaj dhune ishte përdorimi i dhunës seksuale si armë lufte, një fenomen që la pasoja të rënda jo vetëm për viktimat direkte, por edhe për strukturën shoqërore të Kosovës. Përdhunimet masive të grave dhe dhuna seksuale ndaj burrave përbënin një formë të torturës së institucionalizuar dhe ishin të shoqëruara me shkelje të Konventave Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut dhe të Ligjit Humanitar Ndërkombëtar.

Pasojat e këtyre krimeve janë të shumëfishta dhe përfshijnë dëme fizike, psikologjike dhe sociale afatgjata për viktimat dhe komunitetet e tyre. Trauma e shkaktuar nga këto veprime çnjerëzore ka krijuar një nevojë emergjente për trajtim adekuat nga institucionet relevante. Për më tepër, adresimi i dhunës seksuale si një problem social dhe psikologjik është i domosdoshëm për të rindërtuar jetën e të mbijetuarve dhe për të riparuar plagët shoqërore.

Shteti serb, që nga periudha e Naçertanisë e deri te plani famëkeq "Patkoi", ka përdorur të gjitha mjetet në dispozicion për të shkatërruar shqiptarët dhe për të imponuar një realitet të ri politik dhe demografik në Kosovë. Megjithatë, përballë kësaj dhune ekstreme, populli shqiptar në Kosovë demonstroi qëndresë dhe unitet, fillimisht përmes rezistencës paqësore dhe më pas përmes luftës së armatosur, që rezultoi në çlirimin e vendit edhe me ndërhyrjen ndërkombëtare. Për të mbyllur këtë kapitull të errët të historisë, është thelbësore që drejtësia të vihet në vend, krimet e luftës të dënohen, dhe viktimat të marrin njohjen dhe mbështetjen që meritojnë. Për më tepër, dokumentimi dhe analiza e këtyre ngjarjeve mbeten detyrë e shoqërisë shqiptare dhe institucioneve për të siguruar që këto krime të mos përsëriten kurrë më dhe që e vërteta historike të ruhet në kujtesën kolektive për brezat e ardhshëm.

BIBLIOGRAFI

- BEGAJ, Minire. (2020) *Intervistë*: 12 nëntor, ora 14:00-16:00.
- BEGAJ, Minire. (2020) *Raporti i punës*: 12 nëntor 2020, ora 14:00-16:00.
- ÇITAKU, Ibrahim. (2004) *Drenica 1991-1999*, Prishtinë: Europrint, fq. 182-190;
- FISCHER, Joschka. (2008) *Koha*, Prishtinë, fq. 167-198.
- KMDLNJ (2004) Raport për të vrarët në Kosovë gjatë luftës 1998.1.-1999.6.; 11. 03. 2004.
- MAHMUTI, Bardhyl. (2019) *Kurthet terminologjike në fokusin të mohimit të gjenocidit në Kosovë*, Prishtinë: Copyringht, fq. 63; 64; 64.
- MAHMUTI, Bardhyl. (2015) *Mashtrimi i madh*, Tetovë: 291.
- MANÇESTENA–SHERIFI, Naime. (2003) *Dhunimet seksuale të forcave serbe në Kosovë-akti më poshtëruar i shkeljes së të drejtave të njeriut*, Buletini, V. IX, Nr.11-12, mars-shtator 1999; Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut, fq. 184;
- OSMANI, Jusuf. (2012) *Krimet serbe në Kosovë 1998-1999*, I, Prishtinë: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, fq. 25-26; 26-27; 111;
- OSMANI, Jusuf. (2010) *Krimet e Luftës në Kosovë 1998-1999*, Monografi I, Prishtinë: Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) fq. 43; 63;
- (QRK) Qeveria e Republikës së Kosovës e udhëhequr nga Isa Mustafa, me nr. të protokollit 06/143 të datës 28 prill 2017, ka marrë vendim për themelimin e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës. Mandati i këtij komisioni është 5 (pesë)-vjeçar.
- SELIMI, Luljeta. (2003) *Rrëfime tronditëse*, Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, fq. 91.
- SCHARPING, Rudolf. (1999) *Wir dürfen nicht wegsehen. Der Kosovo-Krieg und Europa*. Berlin, fq. 239-240
- UKSHINI, Sylë. (2004) *Plani "Patkoi" i forcave serbe, në gjenocidin serb kundër shqiptarëve gjatë shekullit XIX-XX*, Prishtinë: Instituti i Historisë "Ali Hadri", Prishtinë, fq. 309-315.

Rahim OMBASHI¹

Gjuha Shqipe Është Një E Mirë Kombëtare

Abstract

